



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 15 PRILL 2010**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
15. APRILA 2010. GODINE**

**PRILL – APRIL
2010**

Seancën e kryesoi Jakup KRASNIQI, Kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi **Naim MALOKU**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatohet në sallë janë të pranishëm 65 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për të filluar punën.

Ju njoftoj se në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me shefat e grupeve parlamentare ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Para se të fillojë seanca, dy deputetë janë lajmëruar, kanë deklarime. Fjalën e ka deputeti Adem Hajdaraj.

ADEM HAJDARAJ: Zotëri kryetar,
Kryeministër, zëvendëskryeministër, Qeveri e tërë dhe deputetë,
Unë qesh i shtrënguar nga presioni që kam nga profesorët e universitetit, ta praqes një brengë të tyre, veçanërisht të atyre që e kanë kaluar moshën 65 vjeçare dhe se një vendim i Qeverisë i vitit 2008, ka qenë që profesorëve të universitetit, të cilët kanë thirrje mësimore – profesorë ordinarë dhe inordinarë, t'u shtyhet mosha, t'u shtyhet domethënë koha e punës, nëse janë të aftë, u mor vesh, nëse janë shëndosh. Disa herë ky vendim është përsëritur nga pyetjet e deputetëve, më kujtohet profesor Riza, Kaqusha e të tjerë që kanë bërë pyetje. Disa herë ministri ka dalë dhe ka thënë, e ka pranuar këtë se do të bëhet, po e presin një udhëzim administrativ, të cilin e kam parë në dy variante, në dy versione, vetëm po thuaj se pritet ta nënshkruajë kryeministri i Qeverisë.

Dhe, tash ka ardhur gjendja të paraqiten probleme, tash po thonë se do të dalin dhe madje, madje do të jenë të shtrënguar të punojnë, që t'u hiqet paga për atë kohë sa e kanë marrë pasi i kanë mbushur vitet, çka asnjë nuk pranon ashtu.

E dyta, nëse e shikojmë situatën, nuk do të ishte kjo shkelje e ligjit, pasi edhe Ministria ka vendosur njëherë, për arsye se nëse shikojmë në rajon dhe më gjerë...

KRYETARI: Faleminderit, deputet!
Edhe deputetja Gjylnaze Sylja është lajmëruar, sipas Rregullores.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryetar!
I nderuar kryeministër,
Të nderuar anëtarë të Qeverisë,
Deputetë të nderuar,
Më lejoni të shpreh shqetësimin për çështjen e mbrojtjes ligjore të qytetarëve të Kosovës dhe mungesën e ligjeve bazike, siç është Ligji i punës, Ligji për sigurimet shëndetësore dhe Ligji për pensionet. Me qenë se deri më tani vazhdimisht ka ekzistuar justifikimi nga Qeveria se është kostoja e madhe e këtyre ligjeve, ne kemi mësuar se Ligji për punën kushton 1.8 milionë euro, kosto kjo të cilën mund ta përballojë buxheti, unë ju ftoj që urgjentisht të kërkonin nga Qeveria që ligjet bazike të cilat i përmenda, të procedohen sa më shpejt në Kuvend.

Të nderuar deputetë,
Pavarësisht a jeni pozitë a opozitë, këto janë ligje të cilat rregullojnë jetën tonë, të qytetarëve të Kosovës, punën dhe shëndetin e tyre. Në të kundërtën, Qeveria duhet të japë dorëheqje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Ju lutem, sipas rregullores duhet të lajmëroheni, nëse e kërkon fjalën, dhe arsyen pse. Lexoni rregulloren, unë e respektoj pastaj rendin e ditës. Paraprakisht s'jeni lajmëruar.

Ju njoftoj se Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike ka njoftuar seancën se prej sot shef i Grupit Parlamentar ose kryetar i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike do të jetë deputeti Ismet Beqiri.

(Duartrokitje)

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 1 prill 2010

Të nderuar deputetë,
Pyes, nëse keni vërejtje në procesverbal? Konstatoj se Kuvendi miratoi Procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 1 prill 2010.

Pika e radhës është:

2. Koha për pyetje parlamentare

Në pajtim me Rregullën 26.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit, koha për pyetje të deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta.

Vazhdojmë me pyetjet parlamentare.

Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin Ahmet Shala.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryetar,
I nderuar ministër Shala,

Rëndësia e auditimit të brendshëm në funksion të vendosjes së efikasitetit operacional, disiplinës buxhetore, fiskale dhe të përfilljes së rregullave nga subjektet buxhetore është përcaktuar edhe me akt ligjor. Ndërkaq, nga burime të caktuara, veçanërisht nga publikimet mediale rezulton se nga arbitrarizmat tekno-burokratike në raste jo të rralla, roli dhe funksioni i auditimeve të brendshme kryesisht formalizohet, madje herë – herë vihet në funksion të mbulimeve të spekulimeve financiare të caktuara.

Zotëri ministër Shala,

Sipas të dhënave zyrtare të MEF-it, gjatë auditimeve të brendshme sa përfillet, përkatësisht nuk përfillet ligjshmëria, integriteti, objektiviteti, besueshmëria, kompetenca dhe pavarësia – parime legale të përcaktuara me nenin 4 të Ligjit për auditimin e brendshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar zoti kryetar,
I nderuar zoti kryeministër,
Të nderuar zëvendëskryeministra,
Të nderuar ministra,
Të nderuar deputetë,
I nderuari deputet Smaka,

Bazuar në raportet e auditorëve të brendshëm dhe vlerësimet e këtyre raporteve nga komitetet e auditimeve, Njësia Qendrore e Harmonizimit të auditimit të brendshëm dhe vlerësimet nga organizatat e jashtme, si për shembull nga FIDOM-i, ZAP-i, pra Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, del se raportet e auditimit të brendshëm janë në harmoni me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, pa pretenduar se ne kemi arritur shkallën në të lartë në këtë fushë, duke pasur parasysh kompleksitetin dhe fazën e zhvillimit të shoqërisë kosovare.

Për ngritjen e kapaciteteve profesionale të auditimit të brendshëm kemi mbështetje nga ekspertë të Komisionit Evropian, të Njesisë Qendrore Harmonizuese dhe auditorët e brendshëm nëpër secilën organizatë buxhetore. Në bazë të raportit të punës dhe të gjeturave dhe rekomandimeve të dhëna, konstatojnë se auditorët gjatë ushtrimit të aktivitetit të auditimit të brendshëm kanë zbatuar parimet e auditimit të brendshëm.

Për informimin tuaj, auditorët e brendshëm para fillimit të auditimit nënshkruajnë deklaratën e pavarësisë, e cila është një dëshmi se auditori aktivitetin e tij do ta kryejë duke u bazuar në parimet e auditimit dhe pa ndikime nga jashtë. Nga raporti për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm për vitin 2009, shihet se janë kryer 360 dhe janë dhënë 2207 rekomandime, të cilat do të ndihmojnë menaxhimin dhe performimin e funksionimit të sistemit të kontrollit.

Nga 2207 rekomandime, mbi 55% janë të implementuara, 23,74% janë në proces dhe 21,21% janë të paimplementuara. Sa iu përket rekomandimeve të paimplementuara, del se disa prej tyre janë dhënë në tremujorin e katërt dhe përcjellja e zbatimit të tyre është planifikuar në fazën pasuese të vitit paraprak.

Të gjitha njësitë e auditimit të brendshëm dhe auditorët e brendshëm duhet të bëjnë auditimet e brendshme sipas parimeve në vijim:

Ligjshmërisë, - secila njësi e auditimit të brendshëm dhe secili auditor i brendshëm duhet të ushtrojë auditimin në pajtim të plotë me ligjin, rregullat, standardet dhe praktikat e zbatueshme, pa u kufizuar në ato të nenit 9.8 të këtij ligji.

Po ashtu – Integriteti - Njësia e auditimit të brendshëm dhe secili auditor i brendshëm duhet t'i ushtrojë auditimet në mënyrën profesionale dhe sipas të gjitha kushteve të zbatueshme ligjore.

Paanësia, - po ashtu secili auditorë i brendshëm dhe secili auditorë tjetër duhet të veprojë në nivelin më të lartë të profesionalizmit gjatë mbledhjes, vlerësimit dhe transmetimit të të dhënave mbi aktivitetin ose procesin që është ...

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Deputet, a ke pyetje shtesë?

RIZA SMAKA: ...profesionale edhe korrekte të ministrit Shala, porse do ta kisha pyet vetëm sa i përket 21%, se ajo është në përqindje është një proporcion po thuaj se i pranueshëm, mirëpo në aspektin kuantitativ financiar – çfarë dimensionit ka, se mund të jetë 1%, që nuk u përfill, po e zëmë, mirëpo në aspektin financiar mund të del, po e zëmë, shumë relevante. Në qoftë se e keni këtë të dhënë, tek e fundit, ju falënderohem!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: Të gjitha raportet e efekteve financiare do të botohen me përfundimin e auditimit të përgjithshëm, pra të auditorëve të jashtëm. Sipas rregullit dhe ligjit, auditori i jashtëm është ai i cili vlerëson efektet eventuale të ndikimit financiar dhe ato do të jenë në Web sajtin e auditorit të përgjithshëm, si dhe përfundimin e zbatimit do të jenë edhe në raportin, që ne do ta prezantojmë pas pak kohe këtu në Parlament. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Abdyl Ymeri, pyetje për ministrin Mahir Yagcilar.

ABDYL YMERY: I nderuar kryetar,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në të gjitha vendet e zhvilluara dhe në zhvillim i kushtohet një kujdes i veçantë mbrojtjes së mjedisit, me të vetmin qëllim – përmirësimin e cilësisë së jetës së njerëzve. Është e kuptueshme se pa një zhvillim ekonomik të lartë dhe të qëndrueshëm, nuk mund të ketë përkujdesje të duhur ndaj mjedisit. Kjo nuk duhet të na dekurajojë, përkundrazi duhet punuar maksimalisht në arritjen e objektivit për një mjedis të pastër.

Në kuadër të kësaj kam pyetje: - A është duke u bërë monitorimi dhe matja e shkallës së ndotjes së ambientit në zonën e Ferronikelit, në Drenas dhe në fshatrat përreth, kur dihet se në atë zonë kemi ndotjen e ajrit në shkallë të lartë, e cila paraqet rrezik për shëndetin e popullatës të kësaj ane. Sa herë është më i ndotur ajri se masa e lejuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë ...

KRYETARI: faleminderit!

Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuari deputet Abdyl Ymeri,

Unë kam lexuar pyetjen, sepse janë faktikisht tri pyetje përbrenda një pyetje, kështu që do të mundohem t'ju përgjigjem.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka bërë monitorimin e aero- sedimentit në zonën industriale të Ferronikelit, tri pika monitoruese brenda zonës së Ferronikelit dhe në dy fshatrat – Çikatovë e Vjetër dhe Gllabash, jashtë zonës së Ferronikelit, përreth fabrikës.

Sipas trëndafilut të erës, erërat dominuese janë nga veriu dhe verilindja mbi 80%. Prandaj, shkalla e ndotjes godit pjesën jugperëndimore, por edhe nga njëherë edhe pjesën lindore

të territorit të Drenasit. Rezultatet e ftuara gjatë monitorimit tregojnë se ka tejkalime të vlerave maksimale të lejuara sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë me pluhur total të depozituar dhe metale të rënda në zonën industriale, zona brenda Ferronikelit, ndërsa në fshatrat e monitoruara nuk ka tejkalime të vlerave maksimale të lejuara.

Vlera maksimale mujore e regjistruar me pluhur total të depozituar është arritur deri në 600 miligram për metër katror gjatë 30 ditëve ose gjatë muajit. Ndërsa vlera maksimale mujore e lejuar sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë është 300 miligramë për metër katror. Me qenë se aero sendimenti nuk është ... aq reprezentativ sa për të ngritur padinë ndaj ndotësit, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka ngritur rrjetin e ri të monitorimit në Drenas me sistemin automatik të monitorimit. Sipas standardeve dhe normativave të Bashkësisë Evropiane në këtë stacion monitorohen ndotësit e ajrit, si dioksidi i azotit, dioksidi i sulfurit, monoksidi i karbonit, ozoni, si dhe grimcat me diametër aero-dinamik deri 10 mikronë, të suspenduara në ajër dhe metale të rënda në këto grimca.

Lokacioni i vendosjes të këtij stacioni është në oborrin e Kuvendit Komunal të Drenasit, ku deri në fund të këtij muaji do të jetë në testim nga një kompani e Austrisë.

Kuvendi Komunal i Drenasit do të ketë informacione ditore nga Ministria e Mjedisit për shkallën e ndotjes së ajrit, në mënyrë që mekanizmat përgjegjës të kësaj problematike në shkallë qendrore dhe lokale të veprojnë në përmbushjen e obligimeve ligjore sipas ligjeve në fuqi

KRYETARI: Faleminderit!
Deputet, a ke pyetje shtesë?

ABDYL YMERI: Po. Më intereson kompania e cila shfrytëzon dhe menaxhon me Ferronikelin, a është duke iu përmbajtur afateve të përcaktuara për vendosjen e filtrave. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër,

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Tash është faktikisht pyetje e tretë nga pyetja. Sipas raporteve nga mbikëqyrjet inspektive të vazhdueshme të kryera nga Inspektorati për mbrojtjen e mjedisit, ndaj aktivitetit të operatorit në Drenas mund të konstatohet se: Operatori industrial “Njufko”, Feronikeli në bazë të kushteve dhe të detyrimeve që janë përcaktuar nga pëlqimi mjedisor, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit për vendosjen e sistemit për pastrimin e gazrave që dalin nga furrat elektrike ose sistemi ventu, instalimin e tyre e ka filluar nga viti 2007, dhe për shkak të kompleksitetit të instalimit të pajisjeve, efekteve ekonomike globale, pengesave teknike, ky sistem është instaluar dhe ka përfunduar në muajin shkurt të viti 2010, dhe nga ky muaj është në funksion. Vënia në funksion e këtij sistemi do të ndikojë pozitivisht në gjendjen mjedisore në komunën e Drenasit dhe do të jetë nën monitorimin e vazhdueshëm të Ministrisë së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Deputeti Nait Hasani, pyetje për kryeministrin, zotin Hashim Thaçi.

NAIT HASANI: Përshëndetje, kryetar!
Përshëndetje kryeministër, ministra!

Pyetjen ia kam bërë kryeministrit, po edhe ministrit të Financave edhe ministrit të Punëve të Brendshme, por po na mungon ministri. Çështja është: Duke ditur pozicionin e guvernatorit të Bankës Qendrore, zotit Hashim Rexhepi, dobësitë e tij të menaxhimit financiar të Bankës, keqpërdorimit të materialit, keqpërdorimit të moralit të tij dhe të familjes së tij, pyetja është: Pse deri më tash nuk është bërë shkarkimi i tij dhe a ka moral ky njeri dhe kush e mbron këtë? Dy, a fshihet ky pas transaksioneve të dyshimta bankare, krimit të organizuar, fondit të privatizimit, shpëlarjes së parave, sistemit piramidial të kompanive të sigurimit e tjera. Cila është përgjegjësia e tij në këtë çështje?

KRYETARI: Faleminderit!

Zoti kryeministër, pyetja ishte për ju apo për Ahmetin, pra për ministrin për Ekonomi dhe Financave. Zoti ministër, urdhëro!

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar deputet Hasani,

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është institucioni i pavarur, i cili i përgjigjet Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Bazuar në Ligjin për Bankën Qendrore, organi më i lartë i bankës është Bordi Drejtues, i cili përbëhet nga pesë anëtarë, ku pjesë e bordit është edhe guvernatori i Bankës Qendrore. Procedura e emërimit të anëtarëve të Bordit Drejtues është po ashtu sipas ligjit. Bordi nominon kandidatët bazuar në procedurën ligjore dhe pastaj i paraqet për miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Pas miratimit nga Kuvendi, nominimet dërgohen për emërim te presidenti i Republikës së Kosovës dhe deri në fund të mbikëqyrjes ndërkombëtare të statusit të Kosovës, për emërimin e guvernatorit nevojitet edhe pëlqimi i përfaqësuesit civil ndërkombëtar.

Po ashtu, bazuar në Ligjin për Bankën qendrore të Republikës së Kosovës, shkarkimi i anëtarëve të Bordit dhe i guvernatorit bëhet nga Bordi në qoftë se eventualisht ka vendim mbi aktivitetin, gjykimin për ndonjë vepër penale dhe mbi mospërformancën, apo nga Kuvendi i Republikës së Kosovës kur këtë nuk e bën bordi dhe, natyrisht, me aprovim të presidentit të Republikës së Kosovës.

Duke u mbështetur në punën e Agjencisë së Pavarur të Shtetit, dua të theksoj se rritja e efikasitetit dhe performancës së tyre nuk mund të mbetet peng i asnjë individi. Të gjithë duhet të përgjigjen për punën ose mospunën, i takon organeve përkatëse që t'i analizojnë rezultatet e punës të të emëruarve të tyre, pra edhe i këtij Kuvendi, dhe t'i sjellin vendimet meritore të bazuara në ligj dhe vetëm në ligj dhe në funksion të përmirësimit të qeverisjes së mirë dhe të shërbimeve për qytetarët e Kosovës.

Unë, si ministër i Ekonomisë dhe Financave, jam i përkushtuar të bashkëpunojmë me të gjitha aktorët për përmirësimin dhe mirëfunksionimin e Bankës Qendrore të Kosovës, pasi që ky është institucion shumë i rëndësishëm për stabilitetin fiskal. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputet, ke pyetje shtesë?

NAIT HASANI: E falënderoj ministrin për këtë, por mua më intereson cila është përgjegjësia e guvernatorit të Bankës në këto çështje që unë i theksova? Ju ma elaboruat ligjin, si bëhet zgjedhja, përzgjedhja, shkarkimi, ngarkimi, por nuk ma treguat përgjegjësinë që Ministria e Financave ka, edhe Ministria e Punëve të Brendshme, a kanë hetim këto ndaj këtyre përgjegjësive?

KRYETARI: Ministër! Ministrin e rendit s'e kemi këtu, Nait.

MINISTRI AHMET SHALA: Përgjegjësia e secilit institucion ndaj këtij institucioni të pavarur është e përcaktuar me ligj. Ky është organ i Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe i përgjigjet Kuvendit të Republikës së Kosovës. Çdo kush që ka ndonjë çështje, janë institucionet përkatëse që duhet të ngrihen dhe procedurat janë të përcaktuara saktë me ligj. Ministria e ekonomisë dhe Financave karshi institucioneve të pavarura, po ashtu, i ka kompetencat e caktuara, të limituara, të përkufizuara me Ligjin mbi financat publike dhe, po ashtu, me Ligjin e Bankës Qendrore. Ne konsiderojmë që karshi kësaj, si Ministri e Ekonomisë dhe Financa jemi absolutisht në konform me ligjin.

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Drita Maliqi, pyetje për ministrin Nenad Rashiq.

DRITA MALIQI: Faleminderit!

Punëtorëve kosovarë, sidomos atyre që punojnë në sektorin privat, u shkelen të drejtat në mënyrë drastike, madje ata as nuk i njohin procedurat e kërimit të të drejtave në rast se ato u mohohen. Të gjitha këto vinë si pasojë e mungesës së Ligjit të punës, i cili rregullon marrëdhëniet punëdhënës – punëmarrës. E dimë këtë se Ligji i punës është përgatitur nga viti 2004, dhe ai ligj është instrument për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve.

Zoti ministër,

Kur do të na sillet për miratim Ligji i punës, sepse është ligj substancial për punëtorët dhe të drejtat e tyre? Ju faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Poštovani premijeru,

Poštovani zamenici premijera,

Kolege ministri,

Dame i gospodo, narodni poslanici,

Zadnjih dana se puno priča o Zakonu o radu i mi smo intenzivirali napore da do tog zakona dođemo što pre. Ja sam i na Parlamentarnoj komisiji pre dva dana obrazložio u možda dužem izlaganju u vezi samog zakona. Mi jesmo stigli do možda tehničkog jednog stvarno dobrog zakona i tehnički taj zakon neće koštati toliko. Naravno, ostao nam je taj finalni deo da kroz Ministarstvo ekonomije, u saradnji sa Međunarodnim monetarnom fondom odobrimo zakon, odnosno da u saglasnošću sa njima nađemo metod kako ćemo zakon u buduće implementirati. I mi smo juče još jednom iskoristili priliku da naglasimo koliko je bitan taj zakon, koliko je potreban za sve sfere društva, jer ne samo kao on sam, nego se vezuje i sa mnogim drugim zakonima koji bi trebali biti tek utvrđeni. Mogu da kažem da ima mesta za optimizam, juče smo dobili jedno obećanje da će učiniti sve što je u njihovoj moći da posle 20. aprila mi tačno znamo šta će se desiti sa ovim zakonom. Još jednom ponavljam, znam da je zakon vezan, znam da puno pričamo o ovom zakonu i jeste bitan. Verujte mi da ja kao ministar i ostale moje kolege, i premijer, i zamenik premijera radimo puno na tome i mislim da ćemo uspeti da do kraja meseca imamo stvarno neke ohrabrujuće vesti koje mogu da budu vrlo pozitivne za sve naše radnike na Kosovu. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputete, ke pyetje shitesë? Jo, faleminderit!
Deputetja Qamile Morina, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj.

QAMILE MORINA: Faleminderit, zoti kryetar!

Kjo pyetje është bërë muaj më parë, por në mungesë të ministrit nuk kam arritur të marrë përgjigje.

Në Mitrovicën andej lumit Ibër, që pas lufte fëmijët e lagjes “Kodra e minatorëve” ndjekin mësimin në kontejner. Një pjesë tjetër në paralele të ndara të shkollën “Aziz Sylejmani” dhe pjesa më e madhe udhëtojnë në pjesën jugore të qytetit për të ndjekur mësimin. E drejta e këtyre fëmijëve dhe nevoja e ndërtimit të shkollës në veri, e në veçanti në “Kodrën e minatorëve” është e pakontestueshme ngase edhe pas 10 vjetësh në liri ata ndjekin mësimin në kontejner. Projekti dhe ndarja e buxhetit në vlerë prej 80 mijë eurove është bërë për ndërtimin e kësaj shkolle, por nuk është realizuar. Ndjekja e mësimin për këta fëmijë në Mitrovicë ende mbetet tejet e rëndë.

Zoti ministër, sa e konsideroni dështim të Ministrisë së arsimit mosrealizimin e këtij projekti vital për fëmijët e Mitrovicës....

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI ENVER HOXHAI: I nderuar zoti kryetar,

I nderuari zoti kryeministër, zëvendëskryeministër,

Të nderuar kolegë ministra,

Shumë të respektuar deputetë,

Shumë e respektuar zonja deputete,

Në vitin 2008, unë kam vizituar këtë objekt shkollor. Jam i vetëdijshëm për gjendjen e cila është në këtë shkollë. Atë kohë, ne si Qeveri e Kosovës kemi vendosur që ta ndërtojmë një objekt shkollor në “Kodrën e minatorëve”, por për arsye të natyrës politike, ka qenë po thuaj se e pamundur me gjithë sugjerim të Komunës së Mitrovicës që të nisë ndërtimi i objektit shkollor në “Kodrën e minatorëve”. Të njëjtën kohë dua t’ju informoj që Qeveria e Republikës së Kosovës, konkretisht Ministria e Arsimit, është duke ndërtuar në vend të kësaj shkolle, shkollën në lagjen e “Doktorëve” me kodin buxhetor të emëruar si Kroi i Vitakut. Është objekt shkollor i cili ka 5 dhoma mësimi dhe së shpejti do të jetë në dispozicion të këtyre nxënësve. Arsytet e mosndërtimit të kësaj shkolle kanë qenë të natyrës politike dhe pas konsultimit me komunën e Mitrovicës dhe me bashkësinë ndërkombëtare ka qenë e pamundur që të nisë ndërtimi i këtij objekti shkollor.

KRYETARI: Faleminderit! Ke pyetje shitesë, deputete?

DRITA MALIQI: Zoti ministër, e kam shumë të qartë që ekzistojnë pengesat politike në atë pjesë të Kosovës dhe zakonisht strukturat lokale nuk mund të arrijnë qëllimin dhe nevojitet angazhimi i strukturave qendrore dhe pyetja është në atë drejtim që, thjeshtë, juve t’ju nxis që të ndihmoni në ndërtimin e kësaj shkolle. Ju sot po na thoni që ju nuk keni fare fuqi politike edhe si strukturë qendrore mbi territorin ose integritetin tonë sovran. Ajo që unë do të doja t’ju rikujtoj, kryeministri ka premtuar në këtë Kuvend që do ta ndërtojë Kosovën cep më cep dhe unë besoj që edhe kjo pjesë, ky cep i Kosovës është pjesë e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, ke përgjigje?

MINISTRI ENVER HOXHAI: Zonja deputete,

Ekziston një përkushtim i fuqishëm i Qeverisë së Republikës së Kosovës që për qytetin e Mitrovicës, si tërësi, po në të njëjtën kohë për veriun e Kosovës të ketë mbështetje të fuqishme nga pushteti qendror. Asnjëherë qyteti i Mitrovicës në këto 8 vitet e fundit nuk ka pasur mbështetje më të fuqishme. Unë përmenda faktin që në lagjen e “Doktorëve”, në Kroin e Vitakut është në përfundim e sipër objekti i ri shkollor. Ndërsa pas konsultimeve detaje me komunën e qytetit të Mitrovicës, shpresoj që së shpejti do të fillojë ndërtimi i këtij objekti shkollor, që do të jetë punë e komunës, meqë komuna e Mitrovicës e ka marrë një përgjegjësi të tillë që edhe kjo të ndodhë.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputeti Enis Kervan, pyetje për ministren Editë Tahiri.

Fjalën deputetit Enis Kervan, me kartelën e deputetit Sadik Idriz.

ENIS KERVAN: Faleminderit, zoti kryetar!

Kosova Cumhuriyeti Resmi Bayramlar Yasasının 5. maddesine göre, Kosova Cumhuriyetinde bayram ve anma günleri tüm toplulukları yansıtacak şekilde kutlanmaktadır. Yasanın 5.1, 5.2 ve 5.3 maddesine göre, Kosova Cumhuriyeti Hükümetinin oluşturduğu Cumhuriyet Bayramlar Komisyonu resmi bayramlar ve anma günlerinin kutlanmasıyla ilgili kural ve yöntemleri belirler. Bu çerçevede 5.maddenin 5.4. fıkrasına göre topluluklar kendi günlerini de kutlamaktadırlar. Buna göre 23 Nisan Türklerin Günü olarak yasayla belirlenmiştir. Ancak o günü topluğumuzun bir bütün olarak kendi gününü kutlamasını sağlamamız açısından başta devlet kurumlarında olmak üzere, topluluğumuza ait tüm çalışan bireylere, okullardaki öğretmen ile öğrencilere o gün resmi olarak gününbirlik tatil izni verilmelidir. Ancak böyle bir olanak sağlanırsa topluluğun her kademesi kendi gününü kutlayabilecektir.

Dolayısıyla bakanlığınız Cumhuriyet Bayramlar Komisyonuyla birlikte, toplulukların yasayla var olan bu bayramlarını o gün kendi milli günleri olarak kutlamaları için, devlet kurumlarında kutlamayı yapan o topluluğa mensup çalışanların ve özellikle öğretmen ile öğrencilerin yasa takvimine göre o gün izinli sayılmalarını düzenleyen herhangi bir çalışma veya yönetmenlik hazırladı mı?

KRYETARI: Faleminderit! Ministre, e ke fjalën!

MINISTRJA EDITA TAHIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryeministër, zëvendëskryeministër, Qeveri e nderuar,

Deputetë të nderuar,

I nderuar deputeti Kervan,

Lidhur me pyetjen tuaj, nëse Ministria e Administratës Publike dhe Komisioni Republikan i festave ka përgatitur ndonjë rregullore në lidhje me kremtimin e ditëve përkujtimore të komuniteteve, si ditë jo pune për të gjithë punëtorët të cilët punojnë në institucione shtetërore, sidomos për arsimtarët dhe nxënësit nëpër shkolla, ju njoftoj me sa vijon:

Në bazë të nenit 5, pika 5.2, Komisioni Republikan i Festave është përgjegjës për përgatitjen e rregullave dhe të mënyrave të festimit të festave zyrtare, si dhe të ditëve memoriale. Qeveria e Kosovës ka formuar Komisionin Republikan të Festave dhe Ministria e Administratës Publike ka një anëtar në këtë komision. Andaj, në bazë të kësaj, kompetent për t’i dhënë përgjigje pyetjes suaj është Komisioni Republikan, pra, për rregullimin e çështjes së festave. Dhe, më lejoni me këtë rast që t’ju uroj festën e

komunitetit turk, pra më 23 prill dhe më lejoni ta bëjë edhe në gjuhën turke – Tüm Türk milletine bayramlarınızı kutluyorum. Teşekkür ederim!

KRYETARI: Faleminderit, ministre!

Deputet, ke pyetje shtesë? Faleminderit, deputet!

Deputeti Bujar Dugolli, pyetje për ministrin Lutfi Zharku.

BUJAR DUGOLLI: Kam menduar që s'do të vjen në rend hiq kjo pyetje, se moti e kam bërë.

Zoti ministër,

Një çështje që po dua ta ngrejë unë është se që nga mesi i vitit 2007 është iniciuar procedura e anëtarësimit të Kosovës në Organizatën Botërore të Tregtisë dhe në pranidorëzimin e detyrës unë të kam bërë me dije procedurën se ku ka mbërri. Nga kjo kohë, deri më tash, edhe pse Kosova është bërë e pavarur dhe sipas pakos gjithëpërfshirëse i lejohet anëtarësimi në Organizatën Botërore të Tregtisë, nuk ka ndodhur asgjë. Pyetja konkrete është: - Çka keni ndërmarrë ju që Kosova të jetë anëtare e barabartë e Organizatës Botërore të Tregtisë, ku dihet mirë që të qenit anëtarë i kësaj organizate prestigjioze do t'i sjellë vendit tonë përfitime të shumta ekonomike. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: i nderuar kryetar!

Kryeministër, zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

I nderuar deputet,

Desha së pari të bëj një sqarim. Mua nuk më keni dorëzuar një dokument që Kosova ka aplikuar në Organizatën Botërore të Tregtisë. Do me thënë, nuk ka pas inicim të procedurës zyrtare.

Tash po filloj përgjigjen, kryesorja ajo ishte veç për sqarim. Edhe pse vetëdijshëm se anëtarësimi në OBT është një proces kompleks dhe me kërkesa të shumta, Qeveria e Kosovës anëtarësimin në këtë organizatë e ka një ndër qëllimet kryesore. Kjo qartë është e shprehur edhe në dokumentin – Politika tregtare e Kosovës, i miratuar nga Qeveria në gusht të vitit të kaluar. Anëtarësimi në OBT është i vështirë për dy arsye: Së pari, ky proces kërkon përkushtim të madh të vendit i cili aplikon për t'i implementuar politikat që janë të lidhura me procesin e anëtarësimit dhe, së dyti, është kompleksiteti i çështjeve të cilat mund të shtrohen nga anëtarët e OBT-së gjatë procesit të negocimit, i cili e komplikon tërë procesin.

Ne jemi duke i bërë të gjitha përgatitjet e duhura për të qenë anëtarë të OBT-së, e që kanë të bëjnë me ngritjen e infrastrukturës së nevojshme ligjore në fushën e cilësisë, standardizimit, mbrojtjes së pronësisë industriale, mbrojtjes së investimeve, respektimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, liberalizimin e tregut, si dhe ngritjen e kapaciteteve në kuadër të Departamentit të Tregtisë. Përveç kësaj, përkushtimin tonë për këtë proces e kemi dëshmuar edhe në vizitën tonë në selinë e OBT-së dhe në takime me zyrtarë të lartë të saj, me të cilët edhe ju jeni takuar, si dhe takimet me ambasadorë në OBT të shteteve të ndryshme, siç janë SHBA-të, Britania e Madhe, Gjermania, Franca, Çekia, Norvegjia, Komisioni Evropian.

Përkundër përkrahjes pa rezervë të të gjitha këtyre shteteve për anëtarësimin e vendit tonë në OBT, procedurat e anëtarësimit janë ato që na kushtëzojnë të jemi të maturë për kohën

e aplikimit tonë. Ashtu siç e dini, OBT kanë në përbërje të vetë 153 vende anëtare, që paraqesin afër 97% të tregtisë botërore. Aplikimi i çdo vendi për anëtarësim pasohet me formimin e grupit punues për shqyrtimin e aplikacionit. Grupi punues në parim përbëhet nga shtetet anëtare në OBT, si dhe shtetet që drejtpërdrejt kanë marrëdhënie tregtare me vendin aplikues. Por, grupi punues është i hapur për çdo shtet anëtarë të OBT-së që shpreh interesim për të marrë pjesë. Kjo paraqet sfidë për anëtarësimin tonë, duke marrë parasysh qëndrimin jopërkrahës të disa shteteve ndaj vendit tonë, pasi që grupi punues merr vendime, gjegjësisht rekomandime ekskluzivisht me konsensus, që do të thotë me pajtueshmëri të plotë të të gjithë anëtarëve të grupit punues. Rekomandimi i grupit punues në fund i dërgohet Asamblesë së Përgjithshme, gjegjësisht Konferencës Ministrore, e cila miraton anëtarësimin me 2/3 e votave, gjegjësisht me votat e së paku 102 shteteve. E gjithë kjo dëshmon se ne duhet të jemi shumë të kujdesshëm për kohën e aplikimit tonë në OBT. Natyrisht që ne jemi të vendosur që në OBT të anëtarësohemi si shtet i pavarur, e jo si territor doganorë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Deputet, ke pyetje shtesë?

BUJAR DUGOLLI: Faleminderit, por përgjigja nuk ka qenë aspak e qartë. Unë nuk kërkoj sqarime, sepse procedurat i di, se e kam përfunduar një mandat në këtë detyrë dhe i di shumë mirë. Por, ajo çka po dua të kërkoj nga ju dhe Qeverisa është që anëtarësimi në OBT është në dobi të Kosovës në fushën politike dhe ekonomike. Problemet që i ka vendi me Cëftën, po të ishim anëtarë të OBT-së, nuk do t'i kishim. Ju po shihet që s'keni ndërmarrë asgjë, ju lus që të ndërmerri, sepse në këtë organizatë nuk janë dy shtete që e pengojnë anëtarësimin e Kosovës, siç është Rusia dhe Serbia dhe neve na është kërkuar që atëherë të aplikojmë si territor doganor, por pasi që Kosova pritej të shpallte pavarësinë sa më shpejtë, ne aplikacioni thamë që të bëhet pas shpalljes së pavarësisë. Unë ju lus që ta bëni aplikacionin, se mund të anëtarësohet Kosova në këtë mekanizëm shumë shpejtë dhe të mos pritni më, siç keni pritur. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Myrvete Pantina, pyetje për ministrin, Ahmet Shala.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti kryetar!
I nderuar ministër,

Sipas të dhënave të Administratës Tatimore të Kosovës, aktualisht në regjistrin e Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve janë të regjistruara 100 mijë biznese, prej të cilave vetëm 43 mijë biznese janë tatimpaguese, që do të thotë më pak se 50%, kurse 20 mijë biznese nuk janë funksionale, për të cilat Administrata Tatimore e Kosovës nuk ka informata të sakta për shkaqet e mbylljes së tyre.

Zoti ministër, çka do të ndërmerri për të zvogëluar këtë shkallë të lartë të informalitetit të bizneset kosovare, që ndërmarrjet e regjistruara të kryejnë obligimet tatimore ndaj shtetit?

KRYETARI: Faleminderit! Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, kryetar!

E nderuar deputete Pantina,

Është e vërtetë se në Agjencionin për Regjistrimin e Biznesit në Kosovë ekziston një numër shumë më i madh i bizneseve se sa që janë aktive. Në këtë drejtim, Administrata Tatimore e Kosovës me instruksione të qarta nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave,

gjatë vitit 2009 konsideroj që ka bërë një punë të shkëlqyer në regjistrimin e 43.650 bizneseve të regjistruara me numër fiskal. Dhe në këtë aktivitet do ta vazhdojmë edhe gjatë vitit 2010 dhe deri në përfundim të formalizimit të të gjitha kompanive që janë të regjistruara dhe që duhet të jenë aktive.

Gjatë vitit të kaluar ne kemi thënë që kemi për të filluar me zbatimin e arkave fiskale. Në vitin e kaluar janë bërë sprovë duku rreth.... kompani në mënyrë vullnetare. Tani ka filluar edhe procesi real i aplikimit të arkave fiskale dhe nga muaji maj fillon procesi obligativ i instalimit të arkave fiskale. Këto janë faza të cilat konsideroj që do të ndikojnë dukshëm në ruajtjen e stabilitetit, nëse mund të them financiar të Kosovës në mbushjen e arkës fiskale dhe në eliminimin e informaliteteve. Po ashtu, Qeveria e Republikës së Kosovës ka rimobilizuar një task-forcë në të cilën marrin pjesë edhe Ministria e Punëve të Brendshme, edhe Administrata Tatimore, edhe Doganat, edhe Ministria e Drejtësisë, edhe EULEX-i, në të cilën ka një plan angazhimi mujor për secilin dikaster, në mënyrë që edhe institucionet gjyqësore dhe të tjera zbatuese të ligjit të mobilizohen për të tejkaluar këtë dukuri që është prezente edhe në regjion.

Nëse dëshironi, mund të jap disa shifra të tjera për të ushqyer më shumë informacione. Gjatë vitit 2009 janë bërë 2457 kontrole, janë mbledhur rreth 51.662.533 euro më shumë se sa që janë deklaruar. Po ashtu, numri total i gjobave është 4337 gjoba, të cilat janë zbatuar nga Administrata Tatimore dhe inspektorët e kësaj administrate, të cilat besoj që duhet të realizohen pa dhunë. Në anën tjetër, jemi mobilizuar që të organizojmë bordin e ankesave, ku 10 anëtarë janë dërguar këtu dhe besoj që Kuvendi, sa di unë, në seancën e 29 prillit është në agjendë për të emëruar edhe 10, 9 në fakt anëtarë të rinj, të cilët do t'i bashkëngjiten pjesës së ankesave në mënyrë që të zbatohet konform të drejtave të njeriut dhe harmonizimi me ankesa si shkallë e parë e

KRYETARI: faleminderit!
Deputete, ke pyetje shtesë?

MYRVETE PANTINA: Zoti ministër,
Në kuadër të këtyre 20 mijë bizneseve, që nuk janë funksionale, për të cilat informata nuk ka Administrata Tatimore, domethënë, për shkaqe të mbylljes së tyre, a mendoni se në mesin e tyre ka ndërmarrje të cilat e kanë lëshuar veprimtarinë vetëm për t'iu shmangur tatimeve. Për ta eliminuar një dukuri të tillë, çka do të ndërmerrni? Po më duket se nuk është në rregull që Administrata Tatimore të mos ketë informata për shkaqet e mbylljes së firmave.

KRYETARI: Ministër,

MINISTRI AHMET SHALA: Janë dy institucione të cilat merren me evidentimin e bizneseve. Është Agjencioni për Regjistrimin e Biznesit, ku thashë se kanë ekzistuar mbi 90 mijë biznese të regjistruara, të cilat janë pasive ose të shuara dhe ne nuk kemi pasur informacion se vërtet sa biznese janë aktive. Gjatë 6 muajve të vitit të kaluar dhe vazhdojmë këta 3 muaj, janë regjistruar, janë konfirmuar se aktive janë, e thashë shifrën - 43.615 biznese. Ne do të vazhdojmë për të vërtetuar se çka ndodh me 40 – 50 mijë të tjera që janë të regjistruara gjatë 10 viteve të kaluara dhe nuk do të ngarendim duke ecur përpara për regjistrimin dhe evidentimin e çdo biznesi, qoftë ai individual, qoftë korporatë, për të bërë të mundshëm që secili biznes që është i regjistruar, nëse është aktiv, duhet të paguaj taksat sipas ligjit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Vazhdojmë. Deputeti Heset Cakolli, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi.

HESET CAKOLLI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të respektuar kolegë deputetë,

Çështja: Bazuar në Ligjin nr. 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme, Qeveria e Republikës së Kosovës, me datë 8 tetor 2009, ka marrë vendimin nr. 02/86 me të cilin është miratuar kërkesa për shpronësimin në pjesën e ngastrave kadastrale të pronave të paluajtshme për 13 zona kadastrale të segmentit Vermicë – Prizren, nëpër të cilën do të ndërtohet autostrada Vermicë – Merdare.

Pyetja: Zoti kryeministër, a është funksionalizuar organi për shpronësim dhe nëse po deri, ku ka mbërritur procesi i shpronësimit të atyre pronave të paluajtshme?

KRYETARI: Faleminderit!

Kryeministër apo zëvendëskryeministër, cili po përgjigjeni?

Fjalën e ka kryeministri.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Cakolli,

Organi për shpronësim është formuar dhe organi apo agjencia kryesohet nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe përbëhet nga Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit dhe komunat përkatëse nëpër të cilat do të kalojë autostrada.

Agjencia tashmë ka filluar procesin e shpronësimit të 13 zonave kadastrale në segmentin Vermicë – Prizren edhe me bashkëpunim me autoritet komunale. Deri tani agjencia ka bërë vlerësimin rreth 35% të pronave të paluajtshme. Ndërsa të gjitha vlerësimet e pronave do të dorëzohen më së largu deri më datën 15 maj.

Qeveria e Republikës së Kosovës, pra, do të përfundojë këtë proces me dinamikën e duhur përmes punës dhe përkushtimit të Agjencisë për Shpronësim dhe kontakt të vazhdueshëm me pronarët e këtyre tokave, në bashkëpunim me të gjitha komunat nëpër të cilat do të kalojë autostrada. Qeveria do të punojë për kapërcimin e çdo pengese në realizimin e autostradës. Siç edhe e dini, do të thotë, në këtë vikend makineria do të futet në Kosovë, ndërsa me datën 25 prill, ora 13,00, ne të gjithë jemi në ceremoninë e fillimit të punimeve të autostradës Vermicë – Prizren – Therandë – Prishtinë – Merdare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, kryeministër!

Zoti deputet, ke pyetje shtesë?

HESET CAKOLLI: Jo nuk kam pyetje shtesë, por dëshiroj që organi për shpronësim të realizojë sa më parë detyrën që e ka dhe dëshiroj që ky projekt madhor për vendin të realizohet më parë se sa që ne e parashohim me planin e dinamikës së punës së realizimit. Punë të mbarë!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Deputeti Arsim Rexhepi, pyetje për ministrin Ahmet Shala.

ARSIM REXHEPI: I nderuar zoti ministër,

Para nja dy vjetësh, në fillim të këtij mandati ju keni marrë një vendim që firmave të ndryshme, të cilat për këtë ose atë shkak nuk kanë qenë në mundësi t'i paguajnë tatimet ose kanë pasur një identifikim të to të shmangies nga tatimi, t'ua falni dënimet. Pyetja ime ka është: çka është bërë në këtë drejtim dhe sa keni arritur ta përmirësoni gjendjen në këtë fushë?

KRYETARI: Zoti ministër!

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar deputet Rexhepi,

Ashtu siç e theksuat ju, Qeveria e Republikës së Kosovës me datën 10 shtator të vitit 2008, ka nxjerrë vendimin për pezullim të ndëshkimeve për bizneset të cilat e paguajnë bazën obligative të tatimit dhe të interesit. Pra, nuk ka qenë falje, ka qenë pezullim për ato që hyjnë në marrëveshje me Administratën Tatimore për programimin e borxhit. Si rezultat i këtij vendimi, Administrata Tatimore e Kosovës ka lidhur marrëveshje për pagesë të borxhit me gjithsej 2514 biznese, për të përmbushur pagesën e gjithsej 40.700.000 euro. Nga periudha 10 shtatorit 2008, kur është marrë vendimi, deri më 31 dhjetor të vitit 2009, kur është mbyllur afati i pagesës së borxhit, Administrata Tatimore ka inkasuar shumën prej 34.100.000 euro. Pra, ka mbetur një diferencë e vogël e papaguar, të cilët tani ato biznese që s'e kanë paguar, kthehet faktikisht hiqet pezullimi dhe ato do të jenë të obliguara të paguajnë borxhin, pra kryegjënë, penaltitë dhe kamatën, përkatësisht interesin e akumuluar për këtë. Unë, sinqerisht konsideroj që ky vendim ka qenë mjaft dobiprurës. Ne do të bashkëpunojmë me biznesin, në mënyrë që të mos ketë qëllim ligji penalizmin, por çlirimin e biznesit, në të njëjtin kohë disiplinimin e biznesit. Dhe besoj që reformat që janë bërë në Administratën Tatimore, posaçërisht në politikat fiskale, kanë bërë një atmosferë të mirë që bizneset mos të kenë ndonjë nxitje për të ikur ose anashkaluar pagesat e tatimit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputet, ke pyetje shtesë?

Atëherë, i dhe mundësinë deputetit Naim Rustemi që të bëjë pyetje për ministrin Bujar Bukoshi.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit!

Qeveria e Republikës së Kosovës, me vendim nr. 0870, të datës 25 qershor 2009, shfuqizoi vendimin paraprak për mos lejimin e vazhdimin të punimeve të spitalit privat në hapësira të ngritura në Qendrën Klinike Universitare – QKU dhe lejoi ndërtime private brenda hapësirës së QKUK-së. Sipas Udhëzimit administrativ 08-2007 për shërbimin spitalor në Kosovë, neni 4.1(f), objektet private spitalore duhet të jenë në largësi së paku 1.5 kilometra nga spitalet publike. Pyetja: Cilat janë arsyet që Qeveria e Republikës së Kosovës i shfuqizon vendimet e veta dhe lejon precedent për spitalet private në Kosovë dhe çka do të ndodhë me spitalet publike ...

KRYETARI: Besoj që ministri e ka dëgjuar deri në fund pyetjen.
Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI BUJAR BUKOSHI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,
Zoti kryeministër, zëvendëskryeministër,
Kolegë të Kabinetit qeveritar,
I nderuar zoti Rustemi,

Këto 6 ditë, prej se e kam marrë detyrën, në mes të punëve të tjera dhe kam kërkuar nga ushtruesi i detyrës të sekretarit të përhershëm që të mbledh një faktografi rreth kësaj çështje dhe pyetjes suaj.

Në mes gjithë atyre shkresurave, unë me veti e kam marrë një dokument të fort, është vendimi i asaj Qeverie të cilën ju e përmendni, dhe me drejtë kjo qëndron se Qeveria më herët e ka marrë një vendim për t'i shfuqizuar vendimet paraprake me numra, mos t'i numëroj, është i datës 3 tetor 2007, 31 tetor 2007 dhe 12. 6. 2008, që kanë të bëjnë me ndërtimet private brenda hapësirës së Qendrës Klinike Universitare të Kosovës. Ajo ka përkrahur aktvendimin e Kuvendit Komunal të Prishtinës, të Departamentit për Ndërtim, të datës 3 shtator 2007. Ministria e Shëndetësisë respekton vendimet e Qeverisë në krijimin e kushteve për ofrimin e shërbimeve të mira dhe gjithnjë më të mira shëndetësore si në sektorin publik, ashtu edhe në sektorin privat.

Po ashtu, dua të theksoj se Ministria që e udhëheq unë, edhe në të ardhmen do të angazhohet që licencimi i institucioneve private shëndetësore të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Sa i përket pyetjes suaj lidhur me distancën, ajo ka të bëjë me Udhëzimin administrativ për shërbimin spitalor në Kosovë dhe neni të cilit ju i referoheni për atë distancë ka të bëjë me shqyrtimin e dokumentacionit të institucionit përkatës privat gjatë licencimit, pra ka të bëjë me atë fazën pas aplikimit të institucionit që po e përmendim. Prandaj, rasti të cilit ju i referoheni, ende nuk ka aplikuar për licencim në Ministrinë e Shëndetësisë, pra nuk është në fazën që ka të bëjë me nenin të cilit ju i referoheni.

Në fund, do të thosha se ndoshta ajo që mbizotëron, pyetja – shfuqizimi i vendimeve paraprake, unë mendoj se edhe shfuqizimi i vendimit të Qeverisë bëhet gjithmonë në sensin ose në intencat e saj që me vendime që fuqizohen, që do të ishin më të mira në interes të mbarëvajtjes në këtë sektor të shëndetësisë. Faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër. Deputet, a ke pyetje shtesë?

NAIM RRUSTEMI: Pyetja shtesë, normalisht. Unë jam kurioz ta dijë kush do t'ia paguajë dëmshpërblimin kur t'ia ndaloni atij punën? Pse është lejuar deri tash të punojë, kur po e dimë që është antiligjore, veprimi është antiligjor, edhe pyetja e dytë shtesë do të ishte- A ka mundësi që bizneset private ta diktojnë ndërrimin e legjislacionit në sektorin e shëndetësisë dhe a do t'ia jepni licencën këtij spitali në oborrin e QKUK-së?

KRYETARI: Urdhëro, ministër!

BUJAR BUKOSHI: Raporti në sektorin e shëndetësisë, në mes të sektorit privat dhe atij publik, do të jetë, natyrisht njëra prej atyre sfidave të famshme me të cilën ne do të konfrontohemi si shoqëri. Dhe, unë jam shumë i interesuar që të bëhet një harmonizim ose një sinkronizim në mes këtyre dy aspekteve, vetëm e vetëm në funksion të shërbimeve të mira shëndetësore, pra trajtimi i barabartë. Këto do të jenë natyrisht përpjekjet, unë e di se është lehtë të jepen deklaratat kështu që janë parimore, por ne do të punojmë në atë drejtim.

Sa i përket, si thoni ju shkeljes së legjislacionit, unë nuk jam ithtar që të shkelen ligjet dhe aty do të jemi, për fat, të monitoruar në çdo moment dhe ne jemi të gatshëm që, eventualisht të marrim konsekuenca për shkeljen e ligjit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Do të thotë, koha për pyetje parlamentare është harxhuar, do të thotë kemi 53 minuta të kaluar.

Pyetjet e deputetëve që nuk marrin përgjigje, në dy seanca plenare, do të publikohen në revistën e Kuvendit, do të thotë, përgjigjet botohen aty. Ju faleminderit.

Pika e tretë e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës

Në bazë të Rregullës 25, pika 1, të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim, në parim të këtij projektligji.

Komisioni funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, ka shqyrtuar në parim Projektligjin dhe i ka rekomanduar Kuvendit që të ë mos e miratojë në shqyrtimin e parë.

Mos u ankoni kot, se edhe ata që monitorojnë nganjëherë, monitorojnë kot, kështu që mos u bë fort merak.

Ftoj ministren e Administratës Publike, zonjën Edita Tahiri, që në emër të Qeverisë, para deputetëve të Kuvendit, të prezantojë Projektligjin.

EDITA TAHIRI: I nderuar, zoti kryetar i Kuvendit,

Qeveri e nderuar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Projektligji për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, ka për qëllim përcaktimin e kornizës ligjore për strukturën administrative, funksionimin dhe menaxhimin e organeve të administratës shtetërore, të cilat ushtrojnë kompetenca ekzekutive në Republikën e Kosovës.

Në të njëjtën kohë, një projektligj i tillë ofron mundësinë e modernizimit të administratës publike, pra të reformës së administratës publike, si dhe inkorporon një parim shumë të rëndësishëm demokratik, parimin e subsidiaritetit, gjegjësisht delegimit të kompetencave në rast nevojë në nivelet më të ulëta.

Me këto fakte, praktikisht arsyeton nevojën që para jush të shtrojmë për aprovim Projektligjin për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës. Ky projektligj përcakton dhe përkufizon parimet që kanë të bëjnë me strukturën organizative të organeve të administratës shtetërore, njëherësh projektligji rregullon saktësisht organizimin e brendshëm të të gjitha organeve të administratës shtetërore, pozitën e tyre, përbërjen dhe strukturën organizative.

Ky projektligj është aprovuar nga Qeveria, në mbledhjen e mbajtur me 23.12.2009, vendimi nr. 06-100 dhe sipas procedurës së përcaktohet kur i parashtrohet Kuvendit të Kosovës për miratim. Projektligji ka 7 kapituj, me gjithsej 59 nene. Pjesa e parë e projektligjit përmban 5 nene, ku përfshihen dispozitat e përgjithshme, në të cilat është shpjeguar qëllimi i hartimit të këtij projektligji, si dhe përkufizimet që sqarojnë termit e përdorura në projektligj. Pjesa e dytë e këtij projektligji, përfshinë pjesën e cila

përcakton strukturën organizative të institucioneve të administratës, pjesa e tretë përfshinë 3 nene, ku hyjnë dispozitat lidhur me themelimin dhe shpërndarjen e organeve të administratës shtetërore, pjesa e katërt përbëhet prej 22 neneve që përfshinë dispozitat e organizimit të brendshëm të organeve të administratës shtetërore.

Neni 17, në veçanti i këtij projektligji, parasheh miratimin e Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës për secilin organ të administratës. Gjithashtu, në këtë pjesë përcaktohet edhe përmbajtja e kësaj rregulloreje, si dhe procedurat e miratimit të kësaj rregulloreje.

Neni 22, po ashtu i rëndësishëm të theksohet këtu i këtij propozim ligji përcakton edhe strukturën organizative të ministrive. Me këtë propozim ligj, përcaktohet dhe struktura organizative e organeve qendrore të administratës shtetërore, siç janë: drejtoria e përgjithshme, drejtoratet dhe sektorët. Me këtë projektligj, po ashtu parashihet edhe krijimi i strukturave të veçanta në organin e administratës shtetërore. Përveç përcaktimit të organeve të sipërpërmendura, me këtë projektligj përcaktohen edhe organet e ulëta të administratës shtetërore.

Pjesa e pestë përbëhet nga 7 nene, që përfshinë dispozitat lidhur me procedurat e organeve administrative shtetërore në këtë pjesë, përcaktohen: metodat, mënyrat e komunikimit, koordinimi, ndihma administrative, konflikti i kompetencave, si dhe dispozitat që kanë të bëjnë me komisionin koordinues konsultativ.

Pjesa e gjashtë, përmban 8 nene, që përfshin dispozitat lidhur me mbikëqyrjen e veprimtarisë së organeve administratës shtetërore: përgjegjësinë lidhur me mbikëqyrjen, instrumentet e mbikëqyrjes, mbikëqyrjen e komunave, mbikëqyrjen e bartësit privat të kompetencave publike e të tjera çështje të rëndësishme në sferën që adreson ky projektligj.

Pjesa e shtatë e këtij propozim ligji, përmban dispozitat kalimtare dhe përfundimtare, në të cilat dispozita rregullohet transformimi i organeve ekzistuese të administratës shtetërore, harmonizimi i rregulloreve për organizimin e brendshëm dhe sistematizimi i vendeve të punës. Gjithashtu, në dispozitat kalimtare të këtij propozim ligji, parashihet edhe nxjerrja e akteve për implementimin e këtij ligji.

Projektligji është hartuar në përputhje me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Kosovës, numër 1/2007. Në hartimin e tij kanë marrë pjesë zyrtarë nga institucionet e rëndësishme, të përcaktuara me nenin 32 të kësaj rregulloreje.

Projektligji ka formën dhe strukturën standarde, në pajtim me Udhëzimin administrativ nr. 14/2008, për hartimin e projektligjeve dhe të akteve nënligjore. Gjithë puna e hartimit të projektligjit është bërë nga një frymë e transparencës së madhe, projektligji u është dërguar, përveç institucioneve vendore dhe shumë institucione ndërkombëtare, me qëllim të marrjes së sugjerimeve të tyre.

Projektligji për administratën shtetërore të Republikës të Kosovës, është në pajtim me Kushtetutën dhe me Deklaratën e pajtueshmërisë, si dhe me dispozitat e detyrueshme të asqui communautaire. Aprovimi i këtij projektligji, paraqet një mundësi në drejtim të rrumbullaksimit të legjislacionit në sferën e rregullativës që ka të bëjë me strukturën organizative dhe të organeve të administratës shtetërore, si dhe për funksionimin e tyre institucional dhe efikas.

Prandaj, të nderuar deputetë, ju propozoj që pas debatit që do ta zhvilloni, ta aprovoni pra në parim këtë projektligj dhe ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministre.

Të nderuar deputetë,

Para se të fillojmë pjesën tjetër, edhe në emrin tuaj i falënderoj pjesëmarrjen në punimin e kësaj seance të kryetarëve, nënkryetarëve dhe të asamblistëve të komunave: Shtërpçë, Graçanicë, Ranillugë dhe Killokot.

Ju e kini parë, propozimi i Komisionit është mjaft i paqartë, pastaj ky ligj, është në pakon e ligjeve të shërbyesve civilë dhe Ligjit për paga për shërbyesve civilë. Edhe ky projektligj për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, është në pako dhe parashihet edhe në Raportin e progresit dhe unë kërkoj dhe duhet ta sqaroj edhe krejt Kuvendin se Komisioni në fjalë, i ka vonuar shumë dy projektligjet e tjera, ka kërkuar nga Parlamenti dhe i është vazhduar për 15 ditë afati. Megjithatë, Komisioni ka kapërcyer edhe këtë afat edhe më shumë se dy muaj, dhe unë kisha kërkuar nga grupet parlamentare që ta shqyrtojnë punën e deputetëve në këtë komision dhe unë mendoj që ky Komision meriton rifreskim se nuk i ka kryer punët e veta, konform Rregullores së Punës së Kuvendit.

Sipas radhës, Komisioni nuk është këtu, është në Slloveni dhe ai do të duhej ta harmonizonte vizitën me punën e seancës së Kuvendit dhe kjo vërejtje mendoj duhet të shkojë edhe për komisionet tjera.

Sipas radhës, në emër të grupit parlamentar, kush e do fjalën?

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputeti Bahri Hyseni e ka fjalën.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për të cilin sapo e dha ekspozenë ministrja, ka një rëndësi të veçantë për institucionet, sepse është paraparë edhe në planin e progresit dhe ne, si grup parlamentar, konsiderojmë që është e rrugës që projektligji të aprovohet në parim, pavarësisht, rekomandimeve që vijnë nga Komisioni Funksional për Administratë Publike, të cilat rekomandime konsideroj, tash në mungesë të kryetarit të Komisionit dhe anëtarëve, e kemi vështirë, ndoshta edhe për t'i sqaruar. Pra, konsideroj që janë të mangëta dhe nuk na bëjnë kështu shumë të fuqishëm që edhe ne të mos e përkrahim në parim. Natyrisht që Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, gjatë shqyrtimit i ka dilemat për projektligjin në fjalë dhe këto do të mundohemi kështu, në seancë plenare t'i sqarojmë. Dilema e parë është çka do të bëhet me administratat tjera dhe a konsiderohet që vetëm administrata e ekzekutivit apo e Qeverisë, është administratë shtetërore dhe këtu është dilemë, por nuk konsideroj që është dilemë për të mos e aprovuar në parim ligjin, sepse ne mund ta ndryshojmë dhe ta modifikojmë titullin e projektligjit, por gjithsesi mendoj që administrata shtetërore është më e gjerë se administrata e ekzekutivit apo e Qeverisë, se përndryshe do të sillnim dilema tjera si do të quhej mandej administrata e Kuvendit të Kosovës, si do të quhej administrata e Presidentit, si do të quhej administrata e institucioneve tjera dhe a është kjo administratë shtetërore, gjithsesi po? Kjo është dilema e parë dhe konsideroj që Komisioni Funksional, por edhe komisionet tjera duhet ta modifikojnë.

Dilemë tjetër është, ne jemi në përfundim të Ligjit për shërbimin civil dhe gjithsesi ky projektligj ka qenë dashur të harmonizohet edhe me titujt edhe me organizimin që e ka Ligji i shërbimit civil, sepse Ligji i shërbimit civil, do të lexohet në leximin e dytë, është në përfundim dhe nga ajo që kemi parë, domethënë, është një mosharmonizim edhe i titujve edhe ndoshta i vetë organizimit. Ka edhe disa dilema tjera të cilat duhet t'i bëjnë në komisionet parlamentare, çështja e organizimit. Është paraparë një organizim në kuadër të Ministrisë, domethënë, Drejtoria e përgjithshme e drejtoratit dhe të divizionet dhe nuk e kuptojmë si do të funksionojë ministria përderisa nuk i ka sektorët, njësitë, sepse për të ardhur deri te një divizion ashtu si po quhet, na ka mbetur në praktikë, duhet të jenë edhe njësitë edhe sektorët.

Njësitë dhe sektorët janë paraparë tash në një formë tjetër të organizimit brenda administratës qendrore, mirëpo, konsideroj që nuk është paraparë mirë, sepse struktura më e lartë e administratës dhe organizimit të organeve të administratës qendrore, do të jetë në kuadër të ministrive. Prandaj, mund të parashohim njësi, sektorë tjerë edhe në agjencionet e tjera të cilat i krijon ministria, por struktura qendrore është brenda kësaj administrate.

Ne edhe një herë si grup parlamentar e përkrahim në parim, konsiderojmë që duhet me Qeverinë e Kosovës, Komisioni funksional dhe komisionet tjera parlamentare, të ulën, të kenë dëgjim publik, për të riformuluar, për ta ndryshuar titullin, sepse ndoshta pengesa më e madhe është kjo te titulli dhe kjo e ka vendosur në dilemë Komisionin për Administratë Publike dhe bashkërisht mendoj se mund ta modifikojmë, kurrësi nuk duhet që ne të bëhemi faktor të mos e lexojmë, është hera e dytë që po e kthejmë ligjin dhe kjo po ndikon negativisht edhe në vlerësimin e Raportit të progresit për Kosovën. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emrin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Ju faleminderit, zotëri kryetar!

Në asnjë mënyrë, duke mos e kontestuar nevojën dhe rëndësinë e këtij projektligji, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, e ka shqyrtuar dhe rrinë pranë qëndrimit që edhe nga tërheqja e mëhershme që është bërë nga vetë Qeveria, asnjë ndryshim pothuaj se nuk është bërë dhe këto të meta që i tha edhe zoti Hyseni, dhe ajo që ka thënë Komisioni, për Grupin Parlamentar të LDK-së, janë të mjaftueshme që ta përkrahim rekomandimin e Komisionit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputetja Gjylnaze Syla, e ka fjalën.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Këtë projektligj do t'ia filloj me vendimin tuaj, zoti kryetar, të seancës së Kuvendit të 11 shkurtit 2010, kur ju në mënyrë arbitrare tërhoqët nga rendi i ditës për 3 muaj dhe kur deputetët ju duartrokitën. Janë bërë, zoti kryetar, vetëm dy muaj, kështu që pres nga ju që ta mbani fjalën, mos ta votoni këtë ligj, meqë vetë keni kërkuar që të shtyhet për 3 muaj, ashtu që Qeveria të mbushet mend.

Sa i përket Projektligjit për administratën shtetërore, një shtet modern dhe funksional nuk mund të funksionojë në atë mënyrë po që se nuk ka një administratë efikase

shtetërore. Mirëpo, për ta sjellë projektligjin, paraprakisht Qeveria e Kosovës është dashur të bëjë strategjinë për reformën e administratës shtetërore, dokument i cili duhet t'i identifikojë të metat bazike të sistemit aktual të administratës dhe të caktojë drejtimin e reformave të administratës, por natyrisht që këto reforma mos të jenë në hijen e riformatizimit të Qeverisë.

Tjetra është se duhet ta kemi Ligjin për Qeverinë, meqenëse dispozitat e caktuara të këtij projektligji, sidomos ato të cilat kanë të bëjnë me themelimin dhe shpërbërjen e organeve të larta të administratës shtetërore, duhet të bazohen në Ligjin për Qeverinë. Po ashtu, mangësi është sigurisht edhe vetë ligji për nëpunësit civilë dhe pagat e nëpunësve civilë, do të thotë, nuk janë krijuar as parakushtet për procedimin e këtij projektligji në Kuvendin e Kosovës.

Tjetra është se qëllimin të cilin e synon ky projektligj, nuk e arrin, sepse qëllimi i projektligjit duhet të ishte një administratë efikase ose një sistem administrativ efikas përmes racionalizimit, duke e përfshirë edhe atë financiar, duke marrë parasysh se sa është pjesa e buxhetit ose shumën e buxhetit e cila ndahet për administratën. Prandaj, për të arritur këtë koncept, duhet një koncept i ri i funksionimit të administratës shtetërore. Qëllimi tjetër që duhet të arrihet është integrimi në Bashkësinë Evropiane. Kështu siç është projektligji, nuk mund të arrihet gjithashtu qëllimi, pasi që Bashkësia Evropiane kërkon krijimin e një administrate të qëndrueshme, të besueshme, e cila është e nevojshme për sundimin e ligjit, zbatimin efektiv të politikave dhe të zhvillimit ekonomik.

Mangësia tjetër e këtij projektligji është se është projektligj selektiv, do të thotë, përfshin vetëm administratën e ekzekutivit, por jo edhe të Presidencës, të Kuvendit e tjerë, do të thotë, thjesht është një projektligj për kryeministrin dhe ministrat.

Sa i përket vërejtjeve tjera të përgjithshme, është se ligji është i paqartë, qoftë në aspektin e themelimit dhe funksionimit të pjesëve të veçanta administrative, ashtu edhe të organizimit të brendshëm dhe sistematizimit të vendeve të punës dhe formimit të trupave apo të mekanizmave mbikëqyrës. Kam edhe vërejtje të veçanta. Duke marrë parasysh vetë përmbajtjen e ligjit, titulli i projektligjit duhet të ishte – Projektligji për strukturën e administratës shtetërore dhe kjo është vërejtja e parë e veçantë.

E dyta, është se ofrimi i shërbimeve të administratës publike duhet të sigurohet për të gjithë njerëzit, prandaj te dispozitat e përgjithshme duhet të shtohet neni se administrata është unike, që do të thotë se administrata shtetërore duhet të organizohet në një sistem të vetëm hierarkik. Pra, asnjë institucion ose zyrtar administrativ nuk duhet të ngelë jashtë këtij sistemi.

E treta, është se duhet siguruar që vendimet të jenë transparente, meqenëse edhe vetë Bashkësia Evropiane dhe Komisioni Evropian, në Raportin e vet të progresit të vitit 2009, ka thënë se nevojiten përpjekje substanciale për të siguruar transparencë për emërimet publike.

E katërta, te neni 4, përkufizimet, duhet të shtohet definicioni për zyrtarin administrativ dhe vendimin administrativ

Sa i përket përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së, kjo nuk është e rregulluar me ndonjë akt normativ të veçantë, por më tepër bazohet në kriteret e Madridit, sipas të

cilave shtetet kandidate duhet të krijojnë struktura administrative dhe gjyqësore, në mënyrë që asquis communitaire të zbatohet në mënyrë efektive. Sa i përket buxhetit, gjithashtu ekziston një paqartësi dhe ka efekte buxhetore, në radhë të parë në vetë Ministrinë e Administratës Publike, por edhe në pjesët tjera të ekzekutivit. Kostoja e projektligjit është e paqartë, pasi që do të varet nga zbatimi i Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës për çdo njësi të administratës shtetërore. Megjithëse reformat administrative, janë shumë teknike, kanë pasoja të rëndësishme politike dhe për ta lehtësuar procesin janë të domosdoshme vullneti i duhur politik, fonde të mjaftueshme, koha e nevojshme dhe strategjia e përshtatshme, të gjitha këto që i munguan këtij projektligji. Për shkak të metave të cilat i përmenda, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës nuk e përkrah dhe kërkon që ky projektligj të tërhiqet. Ju faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr zoti Naim Maloku, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zonja deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, ftoj deputetin Riza Smaka ta marrë fjalën.

RIZA SMAKA: I nderuar, zotëri kryesues,

Të nderuar ministra,

Deputetë të respektuar,

Unë relativisht mirë jam i familjarizuar me tematikën e administratës edhe kam qenë pothuaj se në rrjedha nga fillimi i përgatitjes së këtij dokumenti. Unë kam dëshirë në emër edhe të Grupit edhe timin, ta përkrahim zotëri ish-ministrin, tani deputetin doktor Bajramin që ka qenë titullar i përgatitjes së këtij dokumenti. Bile, bile, unë konsideroj që ishte dashur në të ardhmen ky model të merret si mostër për nomo-teknikën e ato janë kërkesa të rëndësishme për përgatitjen e akteve ligjore. Edhe administrata jonë ka nevojë të madhe për këtë ligj, natyrisht se nuk është i përkryer, se s' ka asgjë të përkryer dhe as që do të ketë, mirëpo është i përgatitur mirë. Disa, po e zëmë, sugjestione, po e zëmë çështja administrata shtetërore, administrata publike, po e zëmë, ose disa shtete në Unionin Evropian, këtë tematikë e rregullojnë me një ligj edhe Ligji për administratën që e përfshinë edhe Qeverinë, apo jo, po gjithsesi ishte dashur edhe Administrata Publike të definohej apo, apo t'i jepet njëfarë tretmani. Ndoshta duhet të meditojmë në proces të amendimit që t'i inkludojmë edhe dispozita ndëshkimore, sepse janë shumë të nevojshme, shumë të domosdoshme në funksion të implementimit të këtij dokumenti.

Unë konsideroj që ky është një dokument i mirë edhe aq më parë kur është shumë i nevojshëm për administratën se ne e kemi administratën në ndërtim e sipër. Ju faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Ftoj që në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputetin dhe shefin e Grupit Parlamentar, Lulzim Zeneli ta merr fjalën.

LULZIM ZENELI: Ju faleminderit, zotëri kryesues!

Grupi parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e mbështet qëndrimin e Komisionit, duke vlerësuar se ky projektligj nuk adreson materien nga e cila pretendohet përmes titullit të këtij projektligji, për vetë faktin e ka përjashtuar nga tërësia e saj një pjesë të aparatit të administratës shtetërore, u tha nga parafolësit. Ajo çka do të shtoja në kuadër të kësaj, se ky projektligj nuk ka rregulluar si mangësi shtesë, nuk ka rregulluar procedurat e themelimit të administratës shtetërore. Ky projektligj parasheh instrumente

juridike të panjohura nga legjislacioni i njohur i Republikës së Kosovës, dhe respektivisht, me nenin 49, dhe ajo çka është esenciale të theksohet se ky projektligj, siç theksohet i paraprin hartimit të një strategjie të Qeverisë për politikën dhe zhvillimin e administratës shtetërore dhe nga ajo e cila do të duhej të ishte si vizion dhe udhërrëfyes i këtij koncepti, të këtij projektligji, mirëpo ajo çka shihet nga ky projektligj, atëherë jemi, biem në përfundim se kemi shpërputhje dhe punë ad-hoc të cilat nuk i merr për bazë nga ajo çka është deklaruar më herët.

Prandaj, për të mos e zgjatur më shumë, edhe në vlerësojmë se ky projektligj duhet t'i kthehet, për vetë faktin se nuk ka pësuar ndryshime dhe nuk mbetet shumë, tjetër vetëm të përsëritet qëndrimi që e kemi dhënë edhe shumë kohë më parë në seancat e kaluara. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar "7+", ftoj deputetin Enis Kervan ta marrë fjalën. Ju faleminderit!

Po ju jeni sigurisht me kartel tjetër, deputeti Sadik Idriz, regjia, por regjia Enis Kervan, e keni fjalën.

ENIS KERVAN: Teşekkür ederim

Sayın Başkan, Sayın Bakanlar, Değerli Milletvekilleri

Kosova Cumhuriyetinin Devlet Yönetimine ait Yasa Tasarısının amacı, yönetim organlarının örgütlenmesi, işbirliğin yapılması ve yönetilmesiyle ilgili yasal çerçevenin kurulmasıdır. Devlet yönetimi organının örgütlenme strüktürü, eğer özel yasalarla diğer bir şekilde saptanmadıysa, bu Yasa Tasarısıyla uyumlu olarak düzenlenmiştir.

Bu Yasa Tasarısının, Kosova Meclisi, Başkan, Anayasa Mahkemesi, yargıtay ile savcılık, bağımsız enstitüler, yüksek eğitimin kamu enstitüleri, özel ve genişletilmiş yetkilere ait belediye kurumları ve kamu şirketlerin yönetimiyle hiçbir bağlantısı yoktur.

Devletin yönetim organları, uygun denetim organları ve kamu yönetime ait belirli bakanlık tarafından gözetlenmektedir. Denetim, devlet yönetiminin belirli organlarının yönetilmesine ve iç örgütlenme, finanslerin yönetilmesi ve zaman ile insan kaynaklarının yönetilmesini de ilave ederek, devlet yönetiminin uygun organlarının iç yönetimine yapılmaktadır.

7+ Parlamenter grubu olarak bu Yasa Tasarısının birinci okunuşunu destekliyoruz, gereken öneri ve uyarılarımızı Fonksiyonel Komisyonuna sunmuş olacağız.

Teşekkür ederim

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar, SLS, ftoj deputetin Petar Miletiq ta marrë fjalën.

PETAR MILETIĆ: Poštovani predsjedavajući,

Kolege poslanici,

I Samostalna liberalna stranka je razmatrala ovaj Nacrt zakona i čini mi se da kao što je već neko rekao, ima nekih delova koji su u suprotnosti sa Zakonom o javnim službama. Takođe mi se čini da sam u nekoliko mesta našao da se ova dva zakona i poklapaju, da se odredbe Zakona o državnoj administraciji, Zakona o javnim službama poklapaju. Posebno ćemo kroz komisije, a posebno kroz Komisiju za interes i prava zajednica, obratiti pažnju o delu koji govori o unutrašnjem organizovanju i o sistematizaciji radnih mesta, gde ćemo tražiti da sve zajednice na Kosovu budu ravnopravno zastupljene u ovom segmentu. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Nga Grupi Parlamentar për Integrim nuk shoh të lajmëruar. Vladimir Todoroviq u lajmërua, tani e ka fjalën.

VLADIMIR TODOROVIC: Hvala, gospodine predsedavajući!

Ovaj zakon, ka što su prethodni diskutanti rekli, ima dosta nedostataka, no mi ćemo sigurno u hodu pismenim putem dati da se takvi zakoni izmene, i dati svoj doprinos. Znači, naš Poslanički klub za integraciju u načelu prihvata ovaj zakon. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Shkojmë të deputetët sipas radhës. Fjalën e ka deputeti Naim Rrustemi, përgatitet deputeti Driton Tali.

NAIM RRUSTEMI: Ju faleminderit, kryesues!

Sigurisht që shumë prej përfaqësuesve të grupeve parlamentare e shtruan nevojën e definimit më të saktë të administratës shtetërore, administratës publike, ndoshta edhe administratës lokale, ndoshta është edhe vetëm çështje terminologjie, por sido që të jetë, unë do të fokusohem në projektligjin që na është dërguar si deputetë, do të bëjë komente rreth këtij projektligji.

Mendoj, e a nuk pat edhe ndonjë pikë tjetër më të rëndësishme për t'u thirrur në Kushtetutë, apo veç në atë se Kuvendi ka të drejtë të nxjerrë ligje.

Të nderuar, veç thirrja mbi bazën e çkafit thirret ky ligj, është paksa i pakuptimtë. Nxjerr, Qeveria nxjerr këtë ligj duke u mbështetur në nenin e caktuar, ku ai nen thotë që Qeveria ka të drejtë të nxjerrë ligje. Kjo tregon që nuk ka pasur qasje serioze ndaj përpilimit të këtij ligji. Nuk kanë gjetur diku pak më mirë për t'u thirrur pse ka nevojë, për të dhënë një arsyeshmëri, për ta dhënë një qëllim. Kjo tregon edhe sa rëndësi i kanë kushtuar ligjit, që të vetmen rëndësi kanë tentuar t'i atribuojnë përmes emrit shtetëror, pak më patriot, shtetëror, Kosova është shtet. Normalisht, është edhe pritshme prej kompozicionit të Qeverisë, se kompozicioni është shumë patriotik dhe shumë shtetëror.

Sipas nenit 4 të Kushtetutës së Kosovës, pushteti ekzekutiv i nënshtrohet kontrollit parlamentar dhe është e domosdoshme që të vendoset ndonjë nen në këtë projektligj, me të cilin do të sigurohet kushtetutshmëria dhe mbikëqyrja parlamentare e administratës shtetërore. Mund të jetë edhe formalisht ndoshta e shkruar, e nderuara ministre, ndoshta vetëm formalisht shkruhet, por të sigurohet që përmes kontrollit parlamentar, që t'i bëhet kontrolli parlamentar Qeverisë, ndoshta për këto mandate mund të tingëllojë si përrallë, por të ardhmes kurrë s' i dihet.

Sipas Kushtetutës, Qeveria ushtron pushtet ekzekutiv dhe është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve dhe politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar. Këto janë nene në Kushtetutën e Kosovës. Në këtë projektligj, askund nuk përmendet kontrolli parlamentar. Totalisht roli i kontrollit parlamentar ndaj Qeverisë është minimal, apo hiq, zero i nullifikuar, kurse me nenin e Kushtetutës 92 dhe nenin 4, tekstualisht është i përcaktuar kontrolli parlamentar ndaj punës së ekzekutivit.

Sipas nenit 92 të Kushtetutës, Qeverinë e Kosovës e përbënë kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat dhe, duke mos e specifikuar pozitën e zëvendësministrave dhe duke pasur parasysh se administrata shtetërore do të kuptohet si tërësi e specifikuar me këtë ligj, apo sipas këtij projektligji, atëherë do të na vijë një pozicion jo shumë i përshtatshëm i pozitës së zëvendësministrave, sepse

zëvendësministrat me këtë projektligj, nuk fillojnë të cekën deri diku kah mesi i ligjit, a po flasim për strukturat organizative, kryesisht është organizimi struktural i administratës shtetërore.

Nëse administratën shtetërore e përbëjnë Qeveria dhe organet e tjera administrative dhe, nëse në Kushtetutë, Qeveri nuk kuptohet pozicioni i zëvendësministrave dhe as me këtë ligj nuk parashikohen si pozicione, atëherë vetvetiu do të lindë pyetja: Po çka po na nevojiten zëvendësministrat? Pyetja është paksa e komplikuar.

Në nenin 18, kemi rastin kur përmenden zëvendësministrat, nuk janë në strukturë, nuk dihet roli i tyre, dhe pra nuk janë Qeveri, dhe ministres po ia përkujtoj se kjo nuk është në harmoni me ato teoritë villsoniane, apo të Lleonard Vajtit për minimalizimin edhe maksimalizimin e resurseve njerëzore dhe financiare që të bëhet implementimi i politikave publike. Domethënë, me sa më pak para të shpenzuara, për t'i kryer punët. Por, ky ligj kërkon që të specifikohen detyrat e punës së kompetencave të autoriteteve të larta të administratës shtetërore, pra ministrit. Realiteti e tregon se ministrat nuk i zgjedhin zëvendësit e vet, dhe logjikisht kemi rastet kur zëvendësministrat janë sa për ta marrë një rrogë. 90%, unë disa prej tyre as që ua di emrat, ta marrin një rrogë, të marrin kerr, asistent, shofer, derivate, për të mos harruar edhe dritat jeshile që i përdorin për me ua lëshuar kur ka komunikacion, kur është komunikacioni i dendur. Gjithashtu, edhe ajfonat, ju faleminderit! Edhe ajfonat që kanë nevojë të bëhen.

Gjithashtu, duke pas parasysh tendencat moderne të zhvillimeve, me tendencë të tkurrjes së numrit të ministrave, krejt Evropa, krejt bota ka tendencë t' i tkurrë ministrat dhe njerëzve qeveritarë që të mos jetojnë në kurriz të popullit se janë në shërbim të qytetarëve, me fjalë të tjera sa më të vogël të jetë Qeveria, sa ma e vogël të kushtoj më lehtë se nuk e kemi për tjetër, veç të kushtojë më pak se nuk janë, për të mos i bërë shpenzimet kot se normalisht këto para nuk janë para që pikon nga qielli apo nga Kozmosi, na e kemi tendencën e kundërt, të rritet numri i ministrave, të rritet numri i zëvendësministrave në një vend 2 milionë banorë, në një vend me varfëri të skajshme. Vendet ma të zhvilluara kanë më pak ministri. Por, unë po propozoj një propozim konkret, që me e qitë këtë ligj që numri i zëvendësministrave të jetë i lëvizshëm dhe sa të na duhet t'i vendosim. Le ta lëmë të lirë "Libero" Nevojitet për t'i plotësuar dikujt ndonjë kërkesë të panegociushme gjatë krijimit të koalicionit, që nuk lëshon dikush pe, i bën dy zëvendësministra, tre, katër, pesë, pesë me, pa protokoll, krijon edhe një tjetër i bën 25 ministri me 75....mirëpo edhe se vendi shumë i madh e nuk po mundemi ta menaxhojmë administratën e shtetit, nuk po mundemi t'i menaxhojmë resurset njerëzore dhe pasurinë e paskajshme të Kosovës për t'i kryer politikën, këtu publike edhe s' ka nevojë të lodhemi apo të mërzitemi, se tek e fundit nuk janë këto para që na i ka lënë baba. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti Driton Tali, le të përgatitet deputetja Teuta Hadri.

DRITON TALI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

T'ju them të drejtën, unë e kam lexuar këtë ligj disa herë dhe këtu u prekën shumë çështje të cilat mendoj se injorojnë ligjin dhe injorojnë kohën. Mendoj se ky ligj është ekuivalent për kohën në të cilën ne veprojmë. Shumë mirë neni 2 e shpjegon fushëveprimin e ligjit, në realitet nenin edhe qëllimin e ligjit, domethënë, thotë se po e lexoj, po e lexoj për opinionin, thotë: struktura organizative e organeve të administratës shtetërore rregullohet në përputhje me këtë ligj, përveç se është, nëse është përcaktuar ndryshe në ligje të

veçanta”. Dhe pika 2 e qartëson edhe më mirë, thotë se ky ligj nuk zbatohet për administratën e Kuvendit, shumë bukur, për administratën e Presidentit e tjera e tjera dhe vjen te koncepti i sotëm, që ne po përjetojmë se çka është shteti dhe normalisht shteti është Qeveria. Ne e kemi një Qeveri aq të fuqishme që na i imponon rregullat dhe unë s’ di pse tentojnë ta ndajnë apo ta fusim në këtë ligj për administrimin shtetëror edhe disa autoritete të dorës së dytë, tretë, si për shembull Kuvendi.

Çka kishim bërë ne pa Qeverinë, shtrohet pyetja? Unë mendoj se sinqerisht pika 1, pika 2, pastaj edhe pika 3 e nenit 2, e qartëson edhe më mirë. Merre me mend ti tash decentralizimin, ne e dimë që e kemi bërë për çështje politike e jo për ta decentralizuar, sepse ky këtu në pikën 3 shpjegon, domethënë, që ky ligj, domethënë, nuk vlen edhe për komunat për shkak se Ligji për vetëqeverisjen lokale e rregullon çështjen e nivelit komunal të administratës komunale.

Po them, ajo thënia e Lui XIV, “L’etat c’est moi”, ne sot e kemi “L’etat premier ministër” dhe ashtu është, është njeriu më i votuari, njeriu të cilit i shkon fjala më së shumti dhe ky ligj për këtë legjislacion, i përputhet mënyrës se si jemi, shiko kemi Agjencionin për veterinë te Zyra e Kryeministrit, kund në botë s’ është ajo, kund hiq në botë s’ është ajo. Unë të paktën për aq sa e njoh legjislacionin apo sa jam munduar ta gjejë. Ke pastaj ministri, kesi zyre, zyre, e zyre për të drejtat gjinore e tjera, e tjera, domethënë, veç e kemi një Qeveri e cila është shtet dhe ky ligj është në përputhje me realitetin, të paktën me këtë legjislacion, e tash nëse na vjen në legjislacionin tjetër ndonjë ministër i një partie, një kryeministër i ndonjë partie minoritare, të vogël, atëherë mund ta ndërrojmë këtë ligj, ta bëjmë për administratën shtetërore çfarë duhet të jetë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputetja Teuta Hadri e ka fjalën. Të përgatitet deputeti Arsim Bajrami.

TEUTA HADRI: Zoti kryesues,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Projektligji për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, është një projektligj i një rëndësie të veçantë se korniza e këtij projektligji dhe zbatimi i këtij projektligji, rregullon një bazë të funksionimit të mirë të administratës shtetërore. Unë nuk dua të diskutoj më tepër rreth këtij projektligji, pasi zonja ministre e prezantoi mjaft qartë dhe mirë dhe shumë deputetë e qartësuan funksionimin e këtij projektligji, unë do të ndalem te vërejtjet e mia që i kam te tri nenet e këtij projektligji.

Edhe pse te përkufizimet, është qartësuar shumë mirë pozita e autoritetit të lartë shtetëror, organeve të larta shtetërore të administratës, pastaj organet qendrore dhe ato të ulëta, mendoj se përkufizimi për administratën nuk është bërë këtu, çka duhet të kuptohen se edhe ecuria e të gjitha këtyre neneve, do të lidhet dhe bazën do ta ketë aty.

Unë do të ndalem te neni 8, kur neni 8, 9 dhe 10, edhe pse janë tri nene që lidhen, kanë çrregullim dhe përzierje kompetencave njëra te tjetra. Te neni 8, thotë: “Organet e larta të administratës shtetërore, ushtrojnë detyrat tjera administrative në bazë të ligjit ose nëse ushtrimi i këtyre detyrave nga një organ i lartë i administratës shtetërore, është më efikas dhe efektiv”, atëherë lindë pyetja: cilat detyra, çfarë detyra, çfarë kompetenca, kush i cakton këtu kompetenca, dhe si do të punojnë këto organe të larta?

Te neni 9, kemi: “Organet qendrore të administratës shtetërore, ushtrojnë kompetenca të cilat shtrihen në tërë territorin e Kosovës, ato janë vartëse të një ministrie të caktuar ose te rastet e veçanta të Zyrës së Kryeministrit” Domethënë edhe këtu kemi përzierje në mes së Zyrës së Kryeministrit dhe vetë Ministrisë dhe do të ketë një avari apo një parregullsi se kompetencë e kujt është, siç dihet se në disa vende të punës, ka dy-tre veta i kryejnë dhe asnjëri nuk e merr përgjegjësinë, prandaj, edhe këtu duhet të qartësohet.

Te neni 10, organet e ulëta të administratës shtetërore, janë paraparë 4 paragrafë, janë shumë të zgjeruar, humb koncepti, ka një konfuzion në këtë nen dhe prandaj duhet të përmblidhet dhe të jetë më i shkurtër. Unë besoj se edhe shumë deputetë nuk do ta kuptojnë këtë te paragrafi 1. Organet e ulëta të administratës shtetërore, janë organe të dekoncentruar, fjala koncentrim, ne të gjithë e dimë çka domethënë, ndoshta ka pasur kuptimin e decentralizuar, prandaj të qartësohet se dekoncentrim është shpërndarja apo shkapërderdhja, do të del jashtë funksionit të organeve shtetërore të Kosovës, jashtë kufijve të saj apo si. Këtu mendoj se duhet të qartësohet dhe e kam një propozim që ky nen të përmblidhet në një formulim më të shkurtër që këto organe të ulëta të administratës shtetërore, janë organe rajonale të administratës shtetërore, ku kompetencat e këtyre organeve korrespondojnë me një territor, me territorin e një ose më shumë komunave, e që këto kompetenca përcaktohen me një rregullore nga Qeveria.

Propozoj që Komisioni përkatës ta formulojë më mirë dhe, nëse ka nevojë do t’ia bashkëngjis edhe si amendament. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputeti Arsim Bajrami e ka fjalën, përgatitet deputetja Zylfije Hundozi.

ARSIM BAJRAMI: I nderuar kryesues,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni t’i sqaroj disa çështje parimore të cilat, si duket kanë qenë dilemë edhe në Komision, por po shoh po shfaqen edhe në diskutimet e disa deputetëve. Fillimisht nuk do mend se ky ligj, është një ligj organik, një ligj bazik për administratën shtetërore dhe është pjesë e pakos së ligjeve që janë në shqyrtim e sipër në Kuvend, Ligji për Qeverinë, Ligji për shërbimin civil dhe Ligji për pagat e shërbyesve civilë dhe t’ju siguroj që gjatë hartimit, është parë, është marrë parasysh që këto ligje të jenë koherente dhe të kenë një kompozicion logjik dhe të ndërtohet një koncept unik i administratës publike.

Dilema kryesore që po shtrohet këtu, është se ky ligj a është ligj që i përfshinë tërë administratën shtetërore, pse nuk e ka rregulluar tërë administratën shtetërore dhe a duhet përfshirë edhe administratën publike? Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ne kemi përcaktuar parimin e ndarjes së pushteteve, ku pushteti legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor janë të ndarë dhe dihet se kush është bartës i secilit pushtet. Pushteti ekzekutiv është pak i gjerë dhe ai përfshin Qeverinë, përfshinë edhe administratën shtetërore. Administrata shtetërore, për nga ndarja e pushteteve, është pjesë e ekzekutivit, dhe ky ligj nuk ka pasur për synim t’i rregullojë të gjitha segmentet e administratës shtetërore për shkak se ato edhe nuk janë unike edhe me Ligjin e shërbimit civil, i cili është në pritje të miratimit, është përcaktuar specifika e shërbyesve civilë në sektorët e ndryshëm të administratës. Por, pretendimi i këtij ligji është të rregullojë kryesisht funksionimin e administratës, që konsiderohet pjesë e ekzekutivit dhe ligji ka qenë shumë korrekt, sepse në fillim, ka saktësuar se nuk

rregullon pozitën e administratës shtetërore të Kuvendit të Kosovës, të Presidentit, jo pse kjo pjesë nuk është shtetërore, por kjo pjesë nuk është pjesë e ekzekutivit dhe siç e keni parë, ligji referohet se me aktet e brendshme të Kuvendit, siç është Rregullorja e Punës së Kuvendit, rregullohet pozita e administratës së Kuvendit, sepse pozita e administratës së Kuvendit, nuk është e njëjtë me pozitën e administratës në ekzekutiv. Këtu nuk kemi drejtori, nuk kemi sektorë, nuk kemi divizione, ka një diversitet të rregullimit.

Pastaj, administrata shtetërore që punon te Presidenti i Republikës, është krejt specifike dhe nuk duhet pasur pretendim që të rregullohet në mënyrë unike me këtë ligj, sepse Presidenti i Kosovës, miraton akte nënligjore, rregullore të organizmit të Presidencës, ku rregullon edhe funksionimin e administratës shtetërore. Për këtë arsye, ambiciet e këtij ligji janë shumë të qarta. Ligji është hartuar me shumë kujdes, me asistencë të institucioneve të fuqishme ndërkombëtare dhe është plotësisht koherent me këtë që ne po e quajmë reformë të administratës publike për të cilën ekziston strategjia që 4 vjet. Tani ka filluar procesi i përgjegjësisimit apo i aktualizimit të kësaj strategjie, dhe përpos strategjisë bazë, janë miratuar edhe një 5 strategji, duke përfshirë edhe strategjinë e qeverisjes elektronike, e cila ka filluar të implementohet.

Pra, qëllimi i këtij ligji është shumë i qartë, rregullimi i administratës shtetërore në degën e ekzekutivit e cila përcakton parime unike të funksionimit të kësaj administrate, por nuk hynë në detale, sepse pas hyrjes në fuqi të ligjit për Qeverinë, do të bihet një rregullore unike e organizimit të brendshëm të Qeverisë, ku do të rregullohen segmentet detale të funksionimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ndërkaq, termi administratë publike është shumë më i gjerë dhe përfshinë edhe administratën e institucioneve të cilat nuk janë shtetërore, administratën e ndërmarrjeve publike, ndërmarrjeve private dhe natyrisht, ky ligj nuk pretendon ta rregullojë pozitën e administratës publike për shkak se ekziston Ligji për shërbimin civil, i cili e rregullon pozitën e punëtorëve që punojnë në administratën publike në tërësi, kështu që t'ju siguroj që nuk ka kurrfarë kundërshtie. Ambiciet e ligjit janë shumë konkrete, janë brenda ligjit të saktësuar dhe ky ligj, len hapësirë të nevojshme që administrata shtetërore të ndërtohet në mënyrë, sipas parimit të diversitetit, duke krijuar vetëm modele unike të ndërtimit të administratës në nivel të ekzekutivit, sepse duhet ta pranojmë, këtë e ka konstatuar edhe procesi i rishikimit funksional se brenda ministrive, kemi pasur organizime të ndryshme. Ka pasur, ndoshta edhe mbingarkesa, mbingarkesat e administratës, qëllimi i këtij ligji është të caktojë një bazë ligjore të organizimit unik të ministrive, të agjencioneve ekzekutive që janë pjesë e ekzekutivit, pa hyrë në administratën shtetërore të dy degëve tjera të pushtetit.

Ambicia e këtij ligji për të rregulluar administratën shtetërore të Kuvendit, është jokushtetuese, sepse është një ndërhyrje në parimin e ndarjes së pushtetit dhe ligji është shumë korrekt, sepse definon në fillim që pretendimet e tij, janë vetëm rregullimi i administratës që është pjesë e ekzekutivit. Për nga natyra kushtetuese, administrata shtetërore është pjesë e ekzekutivit, bën pjesë në degën e ekzekutivit, për këtë arsye ligji është i strukturuar konceptualisht shumë mirë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, natyrisht ka hapësirë për të bërë përmirësime të caktuara. Do të ishte mirë që ky ligj të diskutohet pas Ligjit për Qeverinë, ku ne do të kishim organizimin e pjesës politike të Qeverisë dhe do të ishte shumë më i kapshëm edhe për konceptin e ndërtimit të administratës së plotë në pjesën teknike. Kështu që, unë mendoj se Ligji është i mirë, ligji është punuar shumë me kujdes, ligji është shumë i nevojshëm për ta përmbyllur procesin e hartimit të bazës legale për reformën e administratës publike, plotësisht me

standardet evropiane, sepse të gjitha institucionet relevante të administratës publike në nivel evropian kanë qenë pjesë e hartimit të këtij ligji dhe kanë dhënë kontribute konkrete duke i akceptuar standardet që bëjnë të mundshëm, që Kosova në një të ardhshme të afërt, të përfshihet në hapësirën evropiane administrative.

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputetja Zylfije Hundozi, përgatitet deputeti Armend Zemaj.

ZYLFIJE HUNDOZI: Ju faleminderit, zotëri kryesues!

Kolegë deputetë,

Qëllimi i këtij projektligji, është që të sigurojë një kornizë legale për organizimin, bashkëpunimin dhe menaxhimin e trupave që kanë pushtet ekzekutiv.

Legjislacioni i detyrueshëm i Unionit Evropian nuk e rregullon këtë çështje dhe kjo fushë është nën kontroll të vendimmarrjes nacionale, pra atë çka tha zotëri Arsim Bajrami, që po thirret në rregullat e Bashkimit Evropian, nuk është e vërtetë. Por, megjithatë, sikurse ky ligj të ishte konceptuar si duhet, me siguri se do t'i ndihmojë procesit të integritimeve evropiane të Kosovës.

Gjithashtu vlen të theksohet se çdo shtet kandidat që e ka për qëllim anëtarësimin në Bashkimin Evropian, duhet të krijojë administratë efikase, që në mënyrë sa më të mirë të bëjë implementimin e asquis communautaire të Unionit Evropian. Ky proces është i njohur si kriter i Madridit për anëtarësim dhe është vendosur në vitin 1995. Prandaj, po të ishte konceptuar dhe hartuar si duhet, miratimi i sotshëm i këtij ligji do të ishte një përgjigje në vërejtjet e Raportit të progresit të fundit të 14 tetorit të vitit 2009, në të cilin thuhet se nuk është miratuar ende legjislacioni i nevojshëm për reformimin e administratës publike, gjegjësisht pakoja legjislative që u përmend edhe më herët. Pra këto projektligje të pakos të Administratës Publike, janë esenciale për sigurimin e pavarësisë së administratës civile.

Është e nevojshme të bëhet dallim i duhur në mes të shërbyesit civil dhe atij politik. Pra, këto janë citimet e Raportit të progresit. Duke siguruar që shërbimet publike për të gjithë qytetarët e Kosovës, dhe duke vendosur administratë publike profesionale, llogaridhënëse, reprezentative, e lirë nga ndikimet politike, do të sigurojmë një prioritet në partneritetin evropian, po normal kjo vlen për një ligj të hartuar mirë, e jo për këtë që është ofruar sot. Prandaj, edhe unë si grupi im parlamentar, nuk e përkrah miratimin e këtij projektligji në parim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputeti Armend Zemaj e ka fjalën. Përgatitet deputeti Naser Rugova.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, zotëri kryesues!

Qe se edhe unë po e përmend profesorin...

KRYESUESI: Zoti profesor, e keni shtypur pullën dhe e keni tërhequr. E tash, po. Replikë, deputeti Arsim Bajrami, më fal Armend. E keni shtypur, por pastaj e keni tërhequr, kjo është arsyeja.

ARSIM BAJRAMI: Kërkoj falje për këtë lëshim teknik. Atëherë, dëshiroj të qartësoj se a është ky ligj me standarde evropiane? Është e vërtetë se hapësira evropiane administrative është në ndërtim e sipër dhe ende vendimmarrja në lëmin e administratës

publike, është nacionale. Megjithatë, janë përcaktuar disa parime, disa standarde evropiane të cilat vlejnë për ndërtimin e një administrate të paanshme dhe profesionale. Dhe, ato janë cekur qartë edhe në dokumentet e Bashkimit Evropian dhe besoj që edhe në dokumentin e Raportit të progresit, ku në mënyrë të qartë janë caktuar kërkesat e Komisionit Evropian në raport me ndërtimin e një administrate publike. Tërheqja e vijës së qartë midis asaj që quhet administratë profesionale dhe asaj që quhet staf politik në administratën publike dhe pikërisht ky legjislacion, jo vetëm ky ligj, por edhe ligjet që do të vijnë, e përcjellin atë frymë të raportit të progresit dhe i kanë plotësuar ato kërkesa, duke krijuar një administratë publike profesionale, e cila është plotësisht, politikisht neutrale.

Kështu që, mendoj që me amendamentimin e këtij ligji dhe ligjeve tjera, ne japim edhe një kontribut këtij procesi. Nuk duhet të pretendojmë që ligji të jetë ideal. Po të ishte ligji ideal, nuk do të kishte nevojë as për lexim të dytë në Kuvend, me leximin e parë do t'i votonim ligjet, por detyra e deputetëve nuk është pikërisht t'i rinovojnë ligjet, sepse autoritet ligjdhënës, sipas Kushtetutës është Kuvendi i Kosovës. Fuqia e Qeverisë është vetëm nisma legjislative dhe propozimi i ligjeve, për këtë arsye, në radhë të parë kryetarja e Komisionit për Integritet Evropian, ka mundësi që në Komisionin e saj, por edhe vetë si deputete, të bëjë amendamente dhe të kërkojë rritjen e standardeve që do t'i mundësojnë integritet tona në hapësirën evropiane administrative, për shkak se të gjithë e dimë që, në raportin e progresit, Administrata publike është kërkesa e parë në kuptimin e demokratizimit të pjesës politike, është interes vital i vendit tonë që si shtet i ri, sa më...

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj, përgatitet deputeti Naser Rugova.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, zotëri kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Absolutisht do të pajtohesha me kolegët e mi edhe me këtë mendim, diverzitet mendimesh, po të ishte ky shpjegim që nga fillimi, tani nga profesori, ish- ministri Bajrami, sepse ky shpjegim nuk është as në memorandum shpjegues që e përcakton ky ligj.

E dyta, është po të ishte për Qeverinë pra këtij, sigurisht që ne nuk do të ishim në dilema ndoshta as komisione për ndryshimin e Projektligjit që tha kryetari i Komisionit për Legjislacion, titullit, se nuk flitet më me ndryshime të titullit, por do të flitet për përmbajtjen e projektligjit. Prandaj, këto dilema tash janë edhe më konfuze për mua personalisht, duke dëgjuar ministrin, ish- ministrin dhe kolegët e tjerë të nderuar deputetë, dhe ligjet të cilat kanë qenë ose është dashur të jenë përcjellëse nga Qeveria para se të vijë ky projektligj. Andaj, nuk është, në këtë rast ndoshta nuk do ta fajësoja edhe Komisionin i cili prapëseprapë nuk është fare i qartë, por në këtë rast i bie barra Qeverisë se është dashur këtë pako legjislative për reformën në administratën shtetërore, ta bie përnjëherësh e jo kështu tek a tek dhe ne sot t'i ngjallim këto dilema, sepse ekziston edhe Rregullorja. Ne jemi deputetë, komisionet e kanë kompetencën për ndryshimin e ligjeve, por jo gjithnjë duke ndryshuar 70% të ligjeve, se, nëse ligji po ndryshohet 70%, atëherë është ligj i ri sipas Rregullores së Punës së Kuvendit. Dhe, kjo po na ndodhë me ligjet e sjella nga Qeveria dhe ndodhë me ato ligje të cilat një herë thuhet që do të vijnë në paketë, në formë pakete dhe të cilat vijnë një nga një. Nuk është dhënë arsyeja as herën e parë dhe as sot nuk është arsyeja e plotë për miratimin e

këtij ligji. Unë po e them tash, e kemi ne opinionin edhe të ish- ministrit, i cili është shumë më plotësues se sa memorandumit shpjegues për reformën në administratën shtetërore. Prandaj, kjo, jo vetëm që do ta zgjidhë këtë çështje, por edhe do t'i thellojë dilemat nëse nuk vjen Ligji për Qeverinë dhe ligjet tjera përcjellëse që duhet të jenë, ndarjen e këtyre pushteteve, në mënyrë ligjore. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti Naser Rugova, le të përgatitet deputetja Donika Kadaj – Bujupi.

NASER RUGOVA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Vërtet nganjëherë Kuvendi i Republikës së Kosovës, po bie në sprova aspak të lakmueshme dhe për mua është e paqartë ky komunikim brenda trupave të Kuvendit, kur në njërin anë Komisioni Funkcional sjell një rekomandim, ku janë prezentë të gjitha grupet politike aty, dhe rekomandon që ky ligj të kthehet prapa për rishqyrtim, ripunim tek sponsorizuesi.

Nën dy, është hera e dytë që po ndodhë e njëjta gjë dhe unë konsideroj që vendimet e Kuvendit, në seanca të tilla plenare, janë vendime valide, janë të plotfuqishme dhe Qeveria, njëherë e përgjithmonë duhet ta ketë të qartë mos ta vejë në sprovë Kuvendin, sepse ne jemi Republikë parlamentare dhe Kuvendi është institucioni më i lartë i Republikës së Kosovës. Po i njëjti ligj, po i njëjti tekst, ta merrni transkriptin kur është kthyer prapa ky ligj, nuk do të vëreni asnjë ndryshim. Pse të krijohen konfuzitete të tilla të panevojshme? Dhe te e fundit, shumica dërmuese e grupeve parlamentare, ishin që ky ligj të kthehet mbrapa. Personalisht, si deputet kam shumë konfuzion dhe dilema sa i takon substancës së këtij ligji.

Si do ta rregullojmë reformën dhe trendin e organizimit të konceptit modern të administratës publike për administratat e tjera që nuk janë përfshirë në këtë ligj? Pastaj, reforma administratës publike, ka qenë edhe një nga sfidat e rëndësishme të raporteve të fundit, dy-tri vjetëve të fundit të progresit të Komisionit Evropian. Pse nuk vjen një pako ligjore e cila ka qenë e paraparë?

Çështja tjetër, ne jemi dakorduar dhe kemi marrë vendime në këtë Kuvend, të nderuar, që pakot ligjore të bëhen sipas një marrëveshje. Ne nuk kemi ligj për Qeverinë dhe këtu ka dilema dhe konfuzitet. Nuk ka kaluar Ligji për shërbyesit civilë, që gjithashtu interferon me këtë ligj, pastaj ky ligj interferon edhe në kompetencat e rregullimit të njësive, sektorëve të administratës publike edhe me Ligjin për vetëqeverisjen lokale, dhe çka është ma e keqja, ne si deputetë, njerëz të zgjedhur jemi pas dakorduar që bashkë me Ligjin për Qeverinë dhe Ligjin për shërbyes civilë, të vijë edhe Ligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetëve. Paramendoni, ne jemi ligjdhënësit dhe nuk kemi ligj për vetveten. Mos harroni se me 2/3 e këtij Kuvendi, vendimet janë të plotfuqishme. Asnjë qeveri, asnjë president, asnjë ministër nuk mund t'i thyejë ato vendime. Për Ligjin për të drejtat e deputetëve, kemi nënshkruar, të nderuar kolegë dhe ju përfaqësues të Kabinetit qeveritar 86 deputetë dhe pse po lajthitemi kështu. Çfarë pune e punës së menaxhimit të konceptimit dhe e procedimit të kalendarit legjislativ që e kemi për këtë vit. Nëse vazhdojmë që një ligj ta kthejmë tri ose katër herë, për çfarë reforme legjislative po flasim, për çfarë cilësie të hartimit të ligjeve dhe cila është cilësi edhe përgjegjësia neve si deputetë. Por kjo le të jetë një vërejtje substanciale për ekzekutivin e vendit, që komisionet funksionale, pa marrë parasysh nuk bien në sprovë, kur kthehet një ligj dhe

vihet prapë teksti i njëjtë dhe ju lus për një përgjegjësi, për një korrektësi dhe për një qasje më konstruktive.

Nëse vërtet këtu pjesa dërmuese e grupeve parlamentare, e tha mendimin e vet, atëherë do të ishte shumë korrekte zonja ministër, që ju vetë si deputete, si një deputete aktive dhe shumë parimore, të propozoni që ta ktheni këtë ligj mbrapa dhe pastaj të ulen trupat e nevojshme punuese bashkë me Komisionin Funkcional, ta gjejnë në zgjidhje adekuate, bile, bile tani si ministre, keni përgjegjësi që Ligjin për Qeverinë, Ligjin për shërbyes civilë, ligjin tani të përmirësuar dhe më konkret të administratës shtetërore, të vijnë si pako, por bashkë me këtë, kemi marrë vendim si seancë plenare, të vijë edhe Ligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetëve.

Ky ligj nuk përkon me trendët e reformës së administratës publike. Ne nuk kemi akses në resta dhe i lihet legjislacioneve nacionale që të harmonizojë, të riorganizojë ta transformojë dhe në njëfarë forme ta profilizojë një administratë që korrespondon me nevojat e administratës publike shtetërore apo të quajmë një administratë që përkon me interesat e qytetarëve dhe institucioneve nacionale, por edhe atyre lokale të shtetit tonë. Andaj, unë propozoj zonja ministre, që ky ligj të tërhiqet brenda një afati ma të shkurtër kohor, të harmonizohet së pari me Komisionin funksional, me grupin punues të hartimit të këtij projektligji dhe në procedurën më të shpejtë të mundshme, të vjen një pako ligjore e dakorduar, e debatuar mirë dhe e harmonizuar me qëndrime edhe profesionale pse jo edhe politike. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputetja Donika Kadaj – Bujupi dhe i fundit përgatitet deputeti Berim Ramosaj. Uroj të jetë ashtu.

DONIKA KADAJ – BUJUPI: Ju faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Pas gjithë asaj çka u tha, unë me të vërtet konsideroj që ky, dhe jam e bindur që ky ligj do të rikthehet edhe pse dikush, ndoshta do të duhej të japë llogari për atë, që pse është sjellë për herë të dytë pa asnjë përmirësim, por unë do të ndalesha tek neni 5 i këtij ligji dhe kam një pyetje për zonjën ministre ose sponzorizuesin e ligjit më herët, sepse po shihet që ligji nuk ka asnjë ndryshim, asnjë përmirësim.

Neni 5 i këtij ligjit, thotë modernizimi, dhe unë bëj pyetje- Modernizimi është nocion, nuk është kategori, si mund të silllet në Parlamentin e Kosovës një ligj, ku neni 5 i këtij ligji thotë: “Modernizimi”, çka është modernizimi? Është nocion, nuk është kategori, modernizimi është term relativ, çka keni nënkuptuar me modernizim? Dhe, neni 5, thotë përcakton modernizimin

Neni 28, thirret në përputhshmërinë e Ligjit për shërbyes civilë, ndërkaq Kosova ende nuk e ka Ligjin për shërbyes civilë. Kisha dashur që të merrni shënime dhe, do të thotë, në seancën e radhës ose herën tjetër kur të arrimë ta sjellim këtë ligj, t’i kemi të definuara dhe të qarta ose të përmirësuara të paktën nenet për të cilat po flasim dhe të cilat u thirrën edhe më herët nga kolegët deputetë. Edhe, nëse kjo Qeveri s’ ka kapacitete për ta hartuar një projektligj, ju lutem kërkonin ndihmë profesionale dhe mos i risjellni nga 5-6 herë, sepse është humbje kohe, është humbje, është jo seriozitet, nuk është në rregull nëse seanca merr një vendim dhe ju nuk jeni në gjendje, të paktën 2-3 amendamente t’i përfillni nga ana e deputetëve dhe nuk keni kapacitete profesionale, atëherë leni krejt këtë punë dhe i harton ligjet dikush tjetër. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Deputeti Berim Ramosaj e ka fjalën.

BERIM RAMOSAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Unë, vërtet e shoh se Projektligji i administratës shtetërore është një ndër ligjet që i duhet Kosovës, mirëpo unë mendoj se derisa Kosova nuk e ka Ligjin e shërbyesve civilë, frikohem se një ligj parcial i rregullimit të çështjes vetëm të të punësuarave të administratës shtetërore, pa e ditur saktë kategorinë e shërbyesve civilë, nuk i bën mirë, nuk është për një administratë të shëndetshme. Faktikisht, në qoftë se nisemi nga kriteri të ndërtojmë një administratë të qëndrueshme në Kosovë, që është kriteri themelor për organizimin shtetëror të një vendi, atëherë ndikimet politike dhe kapacitetet joprofesionale, Kosovën në përgjithësi po e përcjellin në kuptimin e asaj se ndikimet politike janë shumë të mëdha në administratë e në të njëjtën kohë, kapacitetet profesionale të administratës në përgjithësi nuk janë të mjaftueshme. Unë e kuptoj që jemi administratë e re, por t'i identifikojmë nëpunësit shtetëror nga nëpunësit civilë, duhet të jetë një kriter. Për shembull, shembulli i Francës, mund ta marrim si shembull të mirë për Kosovën. Ata shërbyes civilë në nivel qendror dihet cilët i kanë, administratën komplete të Qeverisë. Në shërbyes civilë kanë edhe administratën e shëndetësisë, në shërbyes civilë i kanë edhe kategorinë e administratës së pushtetit lokal. Mirëpo te ne në Kosovë, ndarja parciale sipas niveleve për administratë shtetërore ose sipas sektorëve në administratë shtetërore, nuk i bën nder, nuk mund ta reformojmë administratën në kuptimin e ndërtimit të një administrate të qëndrueshme. Andaj, ligji bazik për shërbyesit civilë, sigurisht do t'i largojë shumë dilema se dilemat që kanë dalë kohëve të fundit, shërbyesit civilë në Universitet kërkojnë mos të konsiderohen shërbyes civilë profesorët, shërbyesit civilë në shëndetësi kërkojnë të gjithë mjekët të mos jenë në kategorinë e shërbyesve civilë. Pse bëhet kjo, me qëllim të mos hyrjes në kategorinë e njëjtë të pagave, andaj në qoftë se i kemi të gjitha këto dilema unë uroj që ky ligj, vërtet të merret në konsideratë nga ekspertët dhe të rishqyrtohen këto fenomene, por unë nuk jam i pajtimit apo nuk mendoj edhe pse e respektoj idenë, mendimet e të gjithë deputetëve, por në fakt duhet të jemi pak më profesional në marrjen me këtë çështje, mos të kalojmë nga një fushë në fushën tjetër. Në qoftë se e kemi ambicie, aspirojmë për të hyrë në Evropë, nuk mund të aspirojmë me administratë apo shërbyes të llojeve të ndryshëm. Duhet të kategorizohen qartë, sepse kategorizimi në shërbyes civilë, shërbyes administrativë apo shërbyes të agjencive tjera, që ka dallime shumë të mëdha të pagave, ne i shohim sot, përvoja në Kosovë na e tregon këtë. Ne kemi shërbyes civilë të agjencioneve të cilat thirren si agjencione të pavarura, që sot marrin pesëfishin e rrogës së një shërbyesi civil të administratës shtetërore apo të shërbyesit civil të administratës lokale në nivel komune. Andaj, harmonizimi i këtyre çështjeve nuk besoj që mund të realizohet vetëm përmes këtij ligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Dhe, në fund, ftoj ministren ta marrë fjalën.

MINISTRJA EDITA TAHIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Deputetë të nderuar, ju falënderoj për kontributin që e dhatë në funksion, pra të shqyrtimit dhe të dhënies së ideve, rekomandimeve dhe sugjerimeve të ndryshme të cilat janë në funksion të avancimit të këtij propozim-ligji i cili pra ka parasysh edhe do të jetë një instrument ligjor i cili vetëm sa do ta mbështetë zhvillimin më të shpejtë të administratës shtetërore të Kosovës.

Unë i dëgjova me vëmendje debatet, qoftë ato teorike që dolën nga teoria e administratës publike, qoftë këto tjerat që dolën nga përvojat e ndryshme që deputetët kanë dhe

njohuritë deputetët që kanë për praktikat e administratave të ndryshme në botë, pastaj, dëgjova edhe pyetje për koncepte të ndryshme teorike, edhe ato i dëgjova dhe kam parasysh që si propozim-ligj, natyrisht se siç e tha më duket dikush këtu – po të ishte i përkryer hiq s’kishte ardhur këtu. Nuk është as hera e parë, besoj nuk do të jetë as e fundit që do të kemi situata kur do të dalë një propozim, do të pasurohet me idetë tuaja, do të shkojë në fazën shumë të rëndësishme të shqyrtimit nëpër komisione, përfshirë edhe debatin publik dhe më pas, pra të vijmë deri te një rezultat i cili do të nxjerrë një ligj që do të jetë në gjendje t’i japë përgjigje sfidave të kësaj fushe. Edhe atëherë kur do ta nxjerrim, jo vetëm këtë ligj, por edhe të tjerët, ky është një proces dinamik, sepse rrethanat ndryshojnë, do të vijnë situatat që ligji i miratuar të bëhet objekt i ndryshimeve, varësisht nga zhvillimet.

Unë mendoj se ne kemi obligime që sa më shpejt të plotësojmë kornizën ligjore shtetit tonë të ri. Në kuadër të kësaj, me urgjencë kemi obligim të merremi me gjithë legjislacionin që ka të bëjë me shërbimin publik, pra administratën publike, përfshirë edhe çështjen e Ligjit të pagave si shumë i rëndësishëm e të tjera, s’po i përmend, por në anën tjetër kemi edhe obligime që të japim testin tonë para obligimeve që i kemi përballë standardeve evropiane, por edhe Raportit të progresit të vitit 2009 dhe të mos ngecim prapa në raport me Raportin e progresit 2010.

Nuk hyra të jap përgjigje teorike dhe s’po e çoj tutje, veç desha të them se përveç Wilsonit, edhe Weberi edhe sistemi i promovimit të shërbyesve civilë do të implementohet dhe e dyta dikush këtu tha sikur nuk ka strategji të reformës. Ju lutem, strategjia ekziston, e punuar seriozisht, e punuar me refleksione gjithëpërfshirëse, gjithmonë në proces mund të vijë parasysh përditësimi, natyrisht gjithmonë sipas rrethanave. Unë ju falënderoj dhe ju ftoj që në parim t’i jepni mbështetje. Kosova ka nevojë të ecë përpara. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Debati mori fund, sipas Rregullores së Punës të Kuvendit. Në sallë janë 62 deputetë. Ftoj regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë, në parim projektligjin, tash:

Ju faleminderit! Kush është pa kartelë “për”? 1.

Konstatohet se me 30 vota “për”, 28 “kundër” dhe 7 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës.

Në bazë të Rregullores së Punës, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, si komision funksional;
- Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi;
- Komisionin për Buxhet e Financa,
- Komisionin për Komunitete, dhe
- Komisionin për Integritet Evropian,

që brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë Kuvendit t’i paraqesin raporte me rekomandime. Ju faleminderit!

Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për**

ujitjen e tokave bujqësore

Konstatimet hyrëse. Në bazë të Rregullës 35 pika 1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, zotëri Blerand Stavileci, që në emër të Qeverisë para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin. Ministër, e keni fjalën.

MINISTRI BLERAND STAVILECI: I nderuar kryesues,
Të nderuar dhe të çmuar deputetë,
Të nderuar kolegë të Kabinetit qeveritar,
Unë sot para jush do ta bëj prezantimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ujitjen e tokave bujqësore.

Ligji për ujitjen e tokave bujqësore numër 02/L-9, për shkak të mangësive nuk ka gjetur implementim të plotë, prandaj ka lindur nevoja e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit në fuqi, në mënyrë që të krijohet një infrastrukturë e përshtatshme ligjore për ujitjen e tokave bujqësore në nivel sa më të avancuar, si në aspektin profesional, ashtu edhe në atë praktik në përputhshmëri me legjislacionin e BE-së dhe standardet e njohura ndërkombëtare.

Qëllimi i këtij projektligji është të rregullojë çështjet të cilat janë të rëndësishme dhe me prioritet për ujitjen e tokës bujqësore për të siguruar koherencë me legjislacionin në fuqi, si dhe duke pasur parasysh rëndësinë e zhvillimit ekonomik, avancimin, ujitjen dhe mbrojtjen nga ujërat e tepërta si resurse me interes të përgjithshëm.

Projektligji për ndryshim-plotësimin e Ligjit për ujitjen e tokës bujqësore ka një strukturë komplete, gjithëpërfshirëse dhe përmbajtësore, të shtjelluar në 31 nene dhe është hartuar sipas teknikës juridike bashkëkohore, në harmoni me standardet dhe direktivat e BE-së.

Ky projektligj është hartuar nga ekspertët vendorë të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, duke i shfrytëzuar përvojat e shteteve perëndimore nga Sllovenia, Gjermania, Italia dhe Austria. Versioni final është hartuar nga Grupi punues ndërmintor, i përbërë nga këto institucione: Ministria e Bujqësisë, Zyra e Kryeministrit, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Fakulteti i Bujqësisë dhe nga Kompania “Ibër-Lepenci”.

Ky projektligj – pra Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ujitjen e tokave bujqësore përcakton krijimin e infrastrukturës ligjore për themelimin e subjekteve që ofrojnë shërbime për ujitjen e tokës bujqësore në Kosovë, si dhe ndarjen e përgjegjësisë në mes të Ministrisë së Bujqësisë, ndërmarrjeve të ujitjes, federatave dhe shoqatave të ujitjes. Me anë të këtij projektligji, Ministria është përgjegjëse të mbajë regjistrin e ndërmarrjeve, shoqatave dhe federatave. Ministria, gjithashtu autorizohet që të bëjë monitorimin e infrastrukturës së ujitjes dhe me anë të këtij projektligji obligohen ndërmarrjet, shoqatat dhe federatat që ta njoftojnë Ministrinë lidhur me gjendjen teknike të sistemeve të ujitjes para çdo sezone.

Është e rëndësishme të theksohet dhe e dorës së parë që gjatë hartimit të këtij projektligji janë marrë parasysh edhe modifikimet e nevojshme të përcaktuara nga Agjencia e

Koordinimit për Integritet Evropian lidhur me rekomandimet e bëra në Deklaratën e përputhshmërisë me asqin *communaire*. Po ashtu duhet theksuar se zbatimi i këtij projektligji nuk ka implikime financiare që do ta ngarkonin buxhetin e Kosovës, sepse organet e parapara që të themelohen për implementimin e tij janë themeluar me ligjet në fuqi, prandaj aprovimi i këtij projektligji për ndryshim-plotësim të Ligjit për ujëtin e tokave bujqësore është plotësisht i arsyeshëm.

Ju faleminderit për vëmendjen!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër! Hap debatin për diskutim në parim. Kryetar, në emër të Komisionit funksional nuk kemi të paraqitur, të komisioneve tjera jo, në emër të grupeve parlamentare, po.

Ftoj deputeten Elheme Hetemi, që në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së ta marrë fjalën.

ELHEME HETEMI: Faleminderit, nderuar kryesues!

Të nderuar përfaqësues të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ndryshim-plotësimi i Projektligjit për ujëtin e tokave bujqësore, përveç arsyeshmërisë që e potencoi ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, është bërë me qëllim të harmonizimit të këtij ligji me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet tjera në fuqi, asqin *communaire* dhe standardet ndërkombëtare.

Projektligjin e përkrahim në parim si Grup Parlamentar. Disa vërejtje të evidentuara në nene të caktuara, Komisioni funksional, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, gjegjësisht sponzoruesit e këtij projektligji, do t'i korrigjojnë si dhe në bashkëpunim me ekspertë të kësaj fashe. Unë mendoj se ky projektligj e ka një rëndësi të veçantë për rregullimin e një fushe që në të ardhmen do të jetë në shërbim të zhvillimit ekonomik në kuadër të agrobiznesit dhe bujqësisë në përgjithësi, prandaj ju ftoj të gjithëve, kolegë deputetë, që ta përkrahim në parim këtë projektligj, në mënyrë që t'i japim rrugë zhvillimit të bujqësisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputetja Myrvete Pantina e ka fjalën.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zotëri kryesues!

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit numër 02/L-9 për ujëtin e tokave bujqësore është një projektligj i një rëndësie të veçantë, pasi që Kosovës i mungon legjislacioni i përshtatshëm që ka të bëjë me politikat bujqësore për një zhvillim të qëndrueshëm të ujëtit të tokave bujqësore.

Domosdoshmëria për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji është edhe nevoja, domethënë edhe ndryshimi i rrethanave politike dhe ekonomike në Kosovë, që nënkupton kalimin nga ekonomia e planifikuar, në ekonominë e tregut edhe është pra nevoja për t'i rregullimin me ligj të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ujëtin e tokave bujqësore në rrethana të reja.

Qëllimi i këtij projektligji është krijimi i infrastrukturës ligjore për themelimin e subjekteve që ofrojnë shërbime për ujëtin e tokës bujqësore në Kosovë dhe mbrojtjen e saj nga ujërat e tepërta.

Andaj, duke parë rëndësinë e këtij projektligji, Lidhja Demokratike e Kosovës, do ta përkrahë atë në parim dhe kontributin tonë do ta japim edhe në kuadër të Komisionit funksional. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Më lejoni, të nderuar deputetë, që për një moment të kufizohem nga roli i kryesuesit dhe në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së t'i jap mbështetje në parim këtij projektligji. Pra, Grupi Parlamentar i AAK-së e mbështet në parim dhe voton "pro" këtë projektligj, në parim.

Ftoj që në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së deputeti Heset Cakolli të marrë fjalën.

HESET CAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ujitjen e tokave bujqësore është bërë për shkak se ligji në fjalë gjatë zbatimit të tij në praktikë ka hasur në vështirësi të ndryshme për shkak të mangësive që kanë ekzistuar në nene të caktuara të ligjit në fjalë.

Projektligji i propozuar ka gjithsej 31 nene dhe disa prej tyre e kanë rregulluar ligjin në mënyrë përmbajtësore, unë me këtë rast kisha përmendur nenin 4, 6 dhe 7, ndërsa nenet tjera të këtij projektligji i specifikojnë dhe sqarojnë shumë çështje, për çka besojmë se ky projektligj pas aprovimit të tij do të mund të zbatohet në praktikë më lehtë.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re, i jep mbështetje në parim dhe kërkon që të procedohet në Komisionin funksional, ndërsa kontributin tonë do ta japim nëpër komisione ku do të shqyrtohet projektligj nëpërmes anëtarëve tanë. Ju faleminderit zoti kryesues!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, ftoj deputetin Naser Rugova, ta marrë fjalën.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zotëri kryesues!

Kolegë deputetë,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Plotësim-ndryshimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ujitjen e tokave bujqësore ka qenë nevojë imediate e kohës pas monitorimit dhe analizimit të zbatimit në praktikë të këtij ligji që ka impakte direkt në zhvillimin bujqësisë dhe agrokultura.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e mbështet në parim këtë projektligj. Ne kemi disa sugjerime që kanë të bëjnë me nene të caktuara të këtij projektligji, që konsiderojmë që përfshirja apo ndryshimi i këtyre paragrafëve do të ndikojnë në zbatimin më të mirë të këtij projektligji.

Te neni 28 i këtij projektligji, do të propozonim fshirjen e titullit të nenit 37 dhe në vend të tij "zbatimit", të zëvendësohet "mbikëqyrja inspektuese", duhet të riformulohet si në vijim:

Fjala "zbatimi" të mbetet dhe neni 37 i ligjit të plotësohet si në vijim:

"37.1 Mbikëqyrja administrative e zbatimit të këtij projektligji do të bëhet nga Ministria";

37.2. Mbikëqyrjen inspektuese, tani, të zbatimit të këtij projektligji dhe akteve nënligjore që e rregullojnë këtë lëmi e bën inspeksioni i tokave bujqësore në nivel të Ministrisë dhe inspektorët komunalë të tokave bujqësore” sepse edhe organizimi i drejtorive të inspeksionit në nivel të komunave, sepse sipërfaqet e tokave bujqësore, do të thotë, po të bëhet fjalë për tërë territorin e Republikës së Kosovës, duhet t’i stimulojmë, angazhojmë dhe inkurajojmë edhe inspektorët e nivelit komunal që vërtet ta bëjnë prevencën e tyre si institucione.

Pastaj kemi edhe dy sugjerime tjera si grup parlamentar. Ekzistimi i bazës hidrologjike të Kosovës, e cila duhet të jetë në përputhje me planin hapësinor të Kosovës, të cilin nuk e kemi ende, do të kishte ndihmuar edhe në çështjen e ujitjes dhe kullimit të tokave bujqësore, duhet t’i parashohim për të ardhmen që ky ligj ta ketë një konsistencë dhe një zbatim adekuat.

Pastaj, duhet të shikojmë përcaktimin e masave të cilat duhet të ndërmerren ndaj shkaktarëve të ndotjes së ujit, si dhe institucionin përgjegjës për ndërmarrjen e këtyre masave.

Gjithsesi, zoti Ministër, është obligative që uji për ujitje të kontrollohet edhe në parametrat e kontaminimit të tij, sepse mund të kemi lumenj të caktuar që përmes sistemit të ujitjes janë të kontaminuar dhe i dëmtojnë kulturat bujqësore, do të thotë, në sektorët e caktuar. Ne i dimë lumenjtë në vendin tonë, të cilët janë të kontaminuar, qoftë nga ujërat fenolike, industriale apo edhe ujërat e zeza.

Është një ligj i mirë, është një ligj praktik, me disa ndryshime, ku LDD-ja do ta japë kontributin e saj në procedurat e mëtejshme, e përkrah në parim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputeti Zylfi Merxha e ka fjalën.

ZYLFI MERXHA: Faleminderit, zotëri kryesues!

Ju përshëndes juve dhe stafin tuaj!

Përshëndesim ministrat, edhe janë pak, por duhet t’i përshëndesim!

Ne në parim, Grupi 7+ e përkrahim Ligjin për ujitjen e tokave bujqësore, se deri më tani ligj më të mirë s’kemi pasur. Me këtë besoj se do të përparojë bujqësia e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar SLS nuk ka të paraqitur.

Për Integritet, jo! Është radha e deputetëve.

Deputetja Luljeta Shehu e ka fjalën, të përgatitet për fjalë deputetja Gjylnaze Sylja.

LULJETA SHEHU: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Ky projektligj ofron bazë të mirë ligjore për ujitjen e tokave bujqësore dhe ofron infrastrukturë të përshtatshme ligjore për subjektet që ofrojnë shërbime në këtë lëmi pasi që është harmonizuar Ligji edhe me ligjet e Bashkimit Evropian.

Unë i mbështes ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për ujitjen e tokave bujqësore dhe mendoj se ne jemi të vonuar në këtë çështje. Duke e ditur se investimet në lëmin e bujqësisë janë të domosdoshme për të pasur parasysh se investimet e bëra kthehen më shpejtë se në çdo lëmi tjetër të ekonomisë. Nëse dëshirojmë bujqësi të zhvilluar këtë nuk mund ta paramendojmë pa ujitjen e tokave bujqësore.

Unë mendoj se me këtë projektligj është rregulluar një segment shumë i rëndësishëm i zhvillimit të Kosovës, sepse është nevojë imediate investimi në lëmin e bujqësisë për të zbutur importin dhe për ndarjen e devizave në vend.

Në këtë projektligj kam një vërejtje, se ky projektligj a e rregullon vetëm çështjen e ujitjes së tokës bujqësore ose merret edhe me rregullimin e mbrojtjes së tokave bujqësore nga uji, kjo e fundit përmendet vetëm sipërfaqësisht.

Vërejtjet janë: titulli i projektligjit - të jetë Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 02/L-9 për ujitjen e tokës bujqësore, e jo “tokave bujqësore”.

Neni 1, ndryshohet dhe plotësohet duke përcaktuar këtë ligj me të cilin rregullohet krijimi i infrastrukturës ligjore për ujitje, por edhe për mbrojtjen e saj nga ujërat e tepërta. Mendoj që çështja e mbrojtjes së tokës bujqësore nga ujërat e tepërta duhet të përcillet me krijimin e infrastrukturës ligjore edhe për këtë problematikë e jo vetëm të përmendet.

Projektligji nuk është i strukturuar si duhet. Mendoj se do të duhej të bëhej një organizim më i mirë i tij duke bërë një sistem tjetër të neneve nëpër krerë siç praktikohet zakonisht duke i veçuar dispozitat e përgjithshme, shpjeguese, përcjellëse, kalimtare dhe përfundimtare.

Besoj që këto vërejtje dhe të tjerat që do të trajtohen gjatë debatit, do ta plotësojnë tërësisht këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Lus regjinë që t'i ftojë deputetët të kthehen në sallë. Për momentin, janë 49 deputetë dhe e fundit për fjalë për këtë pikë të rendit të ditës është paraqitur deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

E nderuara ministre,

Të nderuar ministra,

Unë po e shtroj që në fillim një çështje shumë të rëndësishme sa i përket sjelljes së ligjeve nga Qeveria dhe kjo është se ligji është sjellë pa një analizë paraprake se çfarë nuk ka funksionuar në ligjin aktual, që ne të dimë se cilat dispozita nuk kanë qenë të përshtatshme për zbatim dhe pse ligji nuk ka funksionuar. Kështu, do të thotë, së pari, ministër, është dashur të sjellim pse kemi nevojë ne për një ndryshim dhe plotësim të Ligjit numër 02/L-9 për ujitjen e tokës bujqësore? Pastaj, në bazë të asaj se çfarë nuk ka funksionuar, duhet të bëhen edhe në ndryshimin e ligjit aktual.

Do të thotë, që në fillim kërkoj nga Qeveria që kjo praktikë të pushojë dhe në të ardhmen, kur të sillni ndryshimet dhe plotësimet e ligjit, të sillni edhe analizën pse ose cilat dispozita të ligjit nuk po zbatohen në praktikë.

Tjetra është se, meqë kemi të bëjmë me një ndryshim i cili synon t'i avancojë politikat bujqësore, e që këto politika bujqësore kanë një rëndësi të madhe edhe për vetë

zhvillimin ekonomik, atëherë edhe dispozitat ligjore që i keni sjellë do të duhej të ishin më të qarta, sidomos ato të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen ujore ose me mbrojtjen nga ujërat e tepërta, edhe pse kryesisht ndryshimet dhe plotësimet e paraqitura kanë të bëjnë më tepër me menaxhimin adekuat institucional të ujitjes së tokave bujqësore, e më pak me menaxhimin e resurseve ujore.

Sa i përket vërejtjes së veçantë, unë i referohem nenit 28, pasi ka të bëjë me mekanizmat mbikëqyrës, siç është inspeksioni, atëherë është e paqartë se cilët janë inspektorët relevantë me të cilët duhet të bashkëpunojnë inspektorët e tokave bujqësore? Kjo, duhet të saktësohet.

Sa i përket përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së duhet cekur se direktivat e legjislacionit të BE-së rregullojnë çështjen e ujitjes së tokave bujqësore, janë shumë më të avancuara dhe rregullojnë një sferë shumë më të gjerë të menaxhimit të ujitjes, por edhe të mbrojtjes së ujërave sipërfaqësorë, të ujërave të përkohshëm dhe ujërave nëntokësorë.

Po qe se merren parasysh vërejtjet e mia, në parim i përkrah. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në sallë janë 60 deputetë. Nuk kemi kuorum për votim. Votimi do të bëhet në vazhdimin e seancës. Tani kemi pauzë deri në ora 14:30. Ju faleminderit!

Vazhdimi i seancës pas pauze

Drejtimin e seancës e mori zoti Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Votimin për pikën e katërt e lëmë më vonë, për shkak se nuk kemi kuorum, kurse për debat kemi, kështu që po fillojmë me pikën e pestë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për gjykatat

Në bazë të Rregullës 35 pika 1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministrin e Drejtësisë, zotin Haki Demolli, që në emër të Qeverisë para deputetëve të Kuvendit, ta prezantojë projektligjin.

Zoti ministër, e ke fjalën.

MINISTËR HAKI DEMOLLI: I nderuar kryetar i Parlamentit,
Të nderuar kolegë ministra, qenkeni 2 gjithsej,
Të nderuar deputetë të Parlamentit të Kosovës,
Kam nderin që në emër të Ministrisë së Drejtësisë t'i paraqes për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës Projektligjin për gjykatat.

Ky projektligj është rezultat i punës dhe përkushtimit të vazhdueshëm të Ministrisë së Drejtësisë për kompletimin e infrastrukturës ligjore në sektorin e saj, si dhe një përpjekje serioze e Ministrisë së Drejtësisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për reformimin e sistemit gjyqësor në përgjithësi.

Me Projektligjin për gjykata synohet që të bëhet organizimi i ri i sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës duke përfshirë këtu përcaktimin e kompetencave dhe përgjegjësi të secilit nivel të gjykatave.

Rëndësia e projektligjit shprehet edhe në faktin se sistemi gjyqësor duhet të reformohet dhe të jetë në harmoni me standardet ndërkombëtare.

Projektligji për gjykatat paraqet një domosdoshmëri të kohës, si për faktin se është ligj i ri dhe modern, por edhe për faktin se ky ligj rregullon në mënyrë thelbësore sistemin gjyqësor e që aktualisht është i rregulluar me ligj, i cili tanimë i takon një sistemi dhe organizimi të tejkaluar. Prandaj, projektligji në fjalë, paraqet një ndërhyrje të theksuar në përmirësimin e gjendjes ekzistuese e që do të ndikojë në shtimin e efikasitetit në punën e gjyqësorit në përgjithësi.

Me këtë projektligj do të kemi 3 nivele të gjykatave të Kosovës: - Gjykatën Themelore, në kuadër të të cilës do të funksionojnë departamentet përkatëse për fusha të caktuara; pastaj Gjykatën e Apelit, e cila do të jetë kompetente që të veprojë si gjykatë e shkallës së dytë dhe Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, si instancë e fundit e gjykatave të rregullta në Kosovë.

Me këtë projektligj garantohet funksionimi i sistemit unik gjyqësor në tërë territorin e Republikës së Kosovës, në të cilin do të kenë qasje të gjithë qytetarët e Kosovës, pa kurrfarë dallimi.

Ky projektligj është përgatitur nga Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë.

Ky projektligj do të mundësojë që gjykatat të jenë të hapura ndaj secilit person, duke synuar që askujt të mos i mohohet drejtësia. Secili person do të ketë të drejtë që t'u drejtohet gjykatave me qëllim të mbrojtjes dhe realizimit të të drejtave të tyre të parapara me ligj. Po ashtu, ky projektligj do të mundësojë që të gjitha gjykatat të funksionojnë në mënyrë të shpejtë dhe efikase për të siguruar zgjedhjen me kohë të rasteve para gjykatës.

Fuqizimi i këtij projektligji është i një rëndësie të veçantë, sepse pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës, do të ushtrohet nga gjykatat e pavarura dhe të paanshme, që gjykojnë dhe punojnë vetëm në bazë të Kushtetutës, ligjit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të aplikueshme drejtpërdrejt sipas Kushtetutës dhe atyre të ratifikuara nga Republika e Kosovës.

I nderuari, zoti kryetar,
Të nderuar deputetë,

Fuqizimi i këtij projektligji është në funksion të kompletimit të infrastrukturës ligjore në sektorin e drejtësisë, andaj propozoj që pas procedurave të shqyrtimit ky projektligj të miratohet dhe të mundësohet procedimi i tij në procedurë të mëtejme dhe dekretimin e tij nga Presidenti i Republikës së Kosovës. Ju faleminderit për vëmendjen!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Sipas radhës, nëse e do fjalën, është kryetari i Komisionit për Legjislacion e Gjyqësi.
Fjalën e ka kryetari i Komisionit Bahri Hyseni!

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër,

E kemi shqyrtuar Projektligjin për gjykatat dhe si Komision kemi konstatuar që është shumë i nevojshëm, duke marrë parasysh se fusha deri më tani në sistemin gjyqësor është rregulluar me ligje të vjetra dhe duke marrë parasysh efikasitetin aktual që e ka sistemi i drejtësisë në vend. Është domosdoshmëri edhe për aspektin tjetër, sepse organizimi me reforma i strukturës gjyqësore është i domosdoshëm që të jetë edhe në pajtim me standardet ndërkombëtare.

Ministria e Drejtësisë kohën e fundit i ka shkruar ligjet mirë dhe po them edhe Ligji që po e diskutojmë sot apo Projektligji, bën pjesë në grupin e ligjeve që janë shkruar mirë.

Megjithatë, konsideroj që duhet ndoshta sot të debatojmë për disa çështje të cilat janë të diskutueshme, për shembull neni 3, paragrafi 2 ku flet, domethënë për gjyqtarët gjatë ushtrimit të vet, është fjala për gjyqtarët që ta ushtrojnë në mënyrë të paanshme, por thotë “gjyqtarët ose gjykatat” që nuk ka kuptim, sepse gjykata nuk nxjerr vendime, por nxjerrin gjyqtarët, nëse e shihni në brendi, por edhe nëse duhet të jetë gjykata, atëherë të jetë gjykata e mandej gjyqtarët, për ta renditur.

Neni 5 flet për shumëllojshmërinë e gjykatave, domethënë titulli flet për shumëllojshmërinë e gjykatave, ndërsa fjala nuk është për shumëllojshmërinë e gjykatave, por është fjala për përbërjen etnike të strukturës së gjyqtarëve që do të punojnë brenda institucioneve gjyqësore dhe duhet gjithsesi të rregullohet kjo.

Pastaj paragrafi 5 i nenit 7, d.m.th. thotë “të gjitha gjykatat duhet të jenë efikase”, faktikisht nuk është normë, është një paragraf që ka dëshirë të jetë ashtu, mirëpo ne po bëjmë ligj, domethënë nuk është vetëm çështje e dëshirës.

Këtu, te struktura organizative, është e renditur mirë struktura se si do të organizohet sistemi i drejtësisë dhe konsideroj se do të ishte mirë të modifikohet me nenin 4 te ushtrimi i pushtetit gjyqësor, sepse është fjala për organizim të njëjtë, nuk ka nevojë ndoshta për t’u përsëritur.

Vlen të përmendet që ndoshta është mirë, disa komuna që i kanë lënë jashtë, të mos kenë degë, për shembull si Shtimja, është mirë të jetë degë, duke marrë parasysh se ka një numër të caktuar të popullatës dhe nuk ka nevojë që njerëzit të shkojnë në Ferizaj, sepse diku një numër shumë i madh i qytetarëve dhe do të bëjë pengesë prapë, mandej Gjykata Themelore nuk do të jetë në gjendje në Ferizaj për shkak të 200.000 banorëve që i ka, t’i përfundojë edhe lëndët e komunës së Shtimes.

Është diçka që vlen të përmendet dhe që është një vërejtje, ndoshta, kllapat është e panevojshme të jenë nëpër ligje, sepse nuk çojnë peshë, kjo është pjesë normative dhe nuk ka nevojë shumë për kllapa, për thonjëza qysh po i përdorin, por le të mbetet çështje që ndoshta e përmirësojmë nëse ka nevojë.

Brengosje për mua është neni 29. Pse është paraparë kompensimi i gjyqtarëve? Ne po e bëjmë ligjin për gjykatat. Ne po e bëjmë ligjin për organizimin e sistemit gjyqësor. Nuk po e bëjmë Ligjin për pagat e gjyqtarëve dhe çka nëse ne vendosim pagat e gjyqtarëve këtu në këtë ligj, së shpejti do ta kemi Ligjin për pagat e zyrtarëve të lartë dhe çka nëse nuk na përputhet? Ne nuk kemi mundësi për çdo ditë për të ndryshuar ligje. Ne e kuptojmë që gjyqtarët duhet të kenë paga të mira dhe për atë unë mendoj që duhet ta

mbështesë edhe Kuvendi, por nuk jemi për atë që çdo ligj që po vjen nga, pavarësisht cilën fushë, cilën ministri po e rregullon, po i rregullojnë pagat me ligjet përkatëse. Prandaj jam që neni 29 nuk duhet gjithsesi të ekzistojnë në ligj, sepse së pari është e paqartë, thotë “paga e kryetarit të Gjykatës Supreme të jetë e barabartë me pagën e kryeministrit”, mandej vazhdon kjo e gjyqtarëve me të ministrave, vazhdon.

Unë konsideroj që për këtë ka vullnet dhe Kuvendi duhet t’i rrisë pagat e gjyqtarëve, por jo në Ligjin për gjykatat, sepse nuk i shkon.

Dhe, krejt në fund, ne do të organizojmë edhe dëgjim publik për ligjin. Për herë të parë po e përdorim një sistem që nuk do të jetë i lehtë. Shpresoj se do ta organizojmë edhe një vizitë në Shqipëri, sepse e kanë këtë sistem një kohë të gjatë dhe mendoj që do të na ndihmojë të shohim nga praktika se si funksionon Gjykata e Apelit, që do të jetë vetëm një dhe besoj që në bashkëpunim edhe me Qeverinë, me Ministrinë e Drejtësisë, do të arrijmë që ta krijojmë apo të bëjmë një ligj me standarde dhe të zbatueshëm në praktikë. Faleminderit!

KRYETARI: Radha është e kryetarëve të grupeve parlamentare. Ramadan Gashi, e ka kërkuar fjalën. Në emër të komisionit, apo? Në emër të Grupit? Mirë, urdhëro! Ramadan Gashi e ka fjalën.

RAMADAN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuari ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për gjykatat dhe konsiderojmë se është një ligj shumë i rëndësishëm për sistemin gjyqësor dhe se aprovimi i tij është i domosdoshëm dhe paraqet një hap të mirë për të riorganizuar gjyqësorin në Kosovë, për të cilin lirisht mund të themi se është hallka më e dobët në pushtetin në Kosovë dhe e sistemit shoqëror në tërësi.

Vetë përvoja dhjetëvjeçare të cilën e kaluam me një mosfunksionim të duhur të gjyqësorit, është dëshmi se duhet ndërmarrë hapa shumë seriozë në riorganizimin e tij, për të krijuar institucione efikase në këtë sferë shumë të rëndësishme të rendit juridik në Kosovë.

Organizimi i deritanishëm i sistemit gjyqësor është treguar i papërputhshëm me realitetin dhe organizimin shoqëror që kemi ne në Kosovë. Prandaj, Projektligji për gjykatat të cilin e kemi sot në shqyrtim, rregullon bazën juridike për punën e gjykatave të Kosovës, ristrukturimin dhe riorganizimin e tyre me qëllim që administrimi i sistemit gjyqësor të jetë sa më efikas dhe ushtrimi i pushtetit gjyqësor të bëhet nga gjykatat si organe të pavarura dhe të paanshme, e që gjykojnë në bazë të Kushtetutës, ligjit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës.

Mendojmë se në ligj janë të organizuara dhe të parapara shumë mirë edhe kompetencat dhe ndarja e tyre edhe lëndore edhe territoriale dhe se në strukturën e tij mund të ketë vend për ndërhyrje të vogla, por konsiderojmë se vërtet ligji i plotëson të gjitha kriteret dhe Partia Demokratike e Kosovës përkrah aprovimin në parim të këtij ligji.

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, shefi i Grupit, Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zotëri kryetar!

Unë pa dashur ta zgjas, konsiderojmë si Grup Parlamentar që ky projektligj i plotëson të gjitha kriteret e nevojshme, gjithmonë me mundësi edhe të plotësimit të tij gjatë fazave të mëvonshme. E përkrahim në parim projektligjin në fjalë dhe kontributin tonë do ta japim më vonë në procedura të mëvonshme nëpër komisione, gjegjësisht në komisionet përkatëse. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Bajram Kosumi e ka fjalën.

BAJRAM KOSUMI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për ju, kryeministrin dhe për kolegët deputetë,
Nuk ka dyshim që Projektligji për gjykatat në zgjidhjet që i orfon është modern dhe sistemi që mendohet të krijohet me këtë ligj është në përputhje me standardet evropiane dhe është një shkëputje nga sistemet e kaluara.

Do të thotë, sa i përket kësaj pjese, Grupi ynë nuk ka dilema, do të thotë, në parim, në këtë pjesë, ne pajtohemi me këtë ligj.

Por, janë disa çështje tjera që nuk kanë të bëjnë drejtpërdrejt me nenet e projektligjit, por me politikat e këtij projektligji që mendoj janë çështje që duhet t'i mendojmë seriozisht dhe t'i diskutojmë.

Çështja e parë, ka të bëjë me vetë reformën. Reforma, si një proces në cilindo sistem, në cilindo institucion, parakupton ekzistimin e disa kushteve që të ketë sukses reforma.

Në të gjitha analizat, në të gjitha studimet që janë bërë për sistemet e pushtetit në Kosovë, sistemi i gjyqësorit rangohet poshtë në listë, do të thotë, ka rezultuar gjithmonë që gjyqësori është ai mekanizmi më i paqëndrueshëm, më i pastabilizuar, më jofunksional dhe jo shumë larg ndikimeve politike.

Pyetja që e shtrojmë ne sot, është kjo: A mundet një mekanizëm, një institucion që nuk është shumë stabil, që është i ndikueshëm politikisht, që nuk është sa duhet funksional, të hyjë në një proces të reformës dhe ta bëjë reformën me sukses?

Pyetja më e drejtpërdrejtë është kjo do të thotë: A është kjo koha kur duhet bërë reforma në sistemin e gjyqësorit?

Projektligji nuk e siguron funksionalitetin e gjyqësorit. Projektligji e ndërron strukturën e organizimit, por nuk e funksionalizon gjyqësorin.

Projektligji merret vetëm me ndërrimin e strukturës, me modernizimin e strukturës gjyqësore, por kjo nuk është garancë se gjyqësori do të funksionalizohet, kjo nuk është garancë që gjyqësori do të pavarësohet më shumë prej politikës. Kjo nuk është garancë se gjyqësori do t'i zgjidhë lëndët e grumbulluara, që është pika më e vështirë, më e rëndë e gjyqësorit në Kosovë.

Kjo është dilema e madhe sa i përket këtij projektligji.

Shikoni, te nenet ku flitet për lëndët e pazgjidhura, do të thotë, llogaritni – më 1 janar të vitit 2013, kur supozohet të implementohet sistemi i ri i gjyqësorit, sa prej lëndëve që janë sot të pazgjidhura do të jenë të pazgjidhura edhe në 2013-ën.

Në procesin e fazës së implementimit të ligjit, Këshilli Gjyqësor, thuhet taksativisht në ligj, do t'iu vejë numra të ri lëndëve të pazgjidhura dhe do t'i klasifikojë sipas gjykatave. Të gjitha këto lëndë të pazgjidhura që janë sot, plus shtu sa do të bëhen gjatë dy vjetëve të ardhshme, do t'i ketë në tavolinë sistemi i ri i gjyqësorit më 1 janar 2013. Do të thotë, ky është problem serioz. Në këtë periudhë të reformimit nuk do të zgjidhen lëndët që janë të grumbulluara me vite të tëra, lëndët e pazgjidhura, por do të grumbullohen edhe më tepër.

Do të thotë, ne po e bëjmë reformimin e sistemit të gjyqësorit, por po ia grumbullojmë lëndët edhe më tepër që në janar 2013, gjyqësori me qenë i ngulfatur prej lëndëve të pazgjidhura. Ky është problemi serioz.

Ne kemi pasur një rast, veç për analogji po e përmend Ligjin për arsimin në Kosovë, që është miratuar në legjislaturën e parë të këtij Kuvendi. Ka qenë reforma e parë e bërë për një sistem në Kosovë. Disa kolegë kanë qenë edhe atëherë në këtë Kuvend kur është diskutuar çështja e reformimit të shpejtë të sistemit të arsimit, por atëherë, Kuvendi vendosi, e miratoi ligjin dhe filloi të implementohet ligji. Kanë kaluar 3, 4 apo 5 gjenerata, e nuk janë pak 5 gjenerata të nxënësve që s'e kanë ditur çka duhet të bëjnë në klasën e nëntë të fillores. Do të thotë, i kemi goditur, i kemi dëmtuar 3, 4 ose 5 gjenerata me një ligj që e kemi miratuar në Kuvend, sepse kemi hyrë në një sistem të reformës, pa e përgatitur terrenin për reformë, pa e përgatitur mekanizmin dhe institucionin që të reformohet.

Ajo çka do të duhej të bëhej te gjyqësori, është që të lirohet gjyqësori prej lëndëve të pazgjidhura, që të mund të reformohet dhe mundësisht edhe të lirohet prej ndikimeve politike, por ky është një proces që s'mund të bëhet për një muaj ose për një vjet, duhet një kohë pak më e gjatë.

Çështja e dytë, që dua ta diskutoj sot këtu, është përvoja e gjykatësve. Ne kemi pasur probleme serioze me emërimin e gjykatësve në të gjitha nivelet për shkak të përvojës së tyre dhe kam besuar që me Ligjin e ri për gjykatat do ta gjejmë një zgjidhje për këtë problem, mirëpo, edhe këtu, sado që ka pasur një tendencë për ta zgjidhur këtë problem, nuk është zgjidhur.

Te neni 27 pika 3.2., për shembull, thuhet: “Për të qenë gjykatës në Gjykatën Supreme të Kosovës, duhet t'i kesh 15 vjet përvojë pune”. Mendojeni , në praktikë kjo çka do të thotë. 15 vjet përvojë pune, do të ishte kërkesë e rregullt në kushte normale, por në kushtet në çfarë ka ekzistuar Kosova në 20 vjetët e fundit, kur 10 vjet ka qenë jashtë ligjit Kosova dhe 10 vjet e fundit, këto të pasluftës, ende ...gjykatësit nuk kanë arritur t'i bëjnë 15 vjet pune – do të thotë nëse ky nen implementohet, anëtarët e Gjykatës Supreme të Kosovës, duhet të jenë gjykatës që kanë punuar para vitit 1989 në Kosovë , vetëm ata, asnjë më vonë nuk mund të bëhet gjykatës i Gjykatës Supreme. Kjo është edhe për nivele tjera. Unë e përmenda vetëm një rast.

Mendoj se përvoja e punës, që kërkohet për gjykatës, do të duhej të zvogëlohet për një 20%, së paku deri në vitin 2013 ose 2015, kur mund të kalojnë 15 vjet prej pas luftës, në mënyrë që t'ua hapim mundësinë gjykatësve të rinj, gjykatësve që janë shkolluar në

periudhën e pasluftës, gjykatësve që kanë edhe një vizion, por edhe një afirmim më shumë me gjyqësinë moderne, demokratike e tjera, e tjera.

Dhe, çështja e fundit, janë pagat e gjykatësve, që dua t'i diskutoj. Këtu është një kapitull për pagat e gjykatësve, nuk po e vë në dilemë a duhet të jetë këtu a s'duhet të jetë, por mendoj se nëse duam të kemi gjyqësor stabil dhe nëse duam të kemi një Kosovë demokratike, duhet të kemi gjyqësor stabil, pagat e gjykatësve duhet të jenë në nivelin e duhur. Gjykatësit duhet të kenë një motivim. Këtu është ofruar një zgjidhje e mirë për nivelin e pagës dhe unë e përkrah nivelin e pagës kështu si është kështu. Por, problemi është ky. Prej ditës së sotme e deri në ditën kur implementohet ky ligj, janë më shumë se dy vjet. Unë e kisha inkurajuar ministrin që të kërkojë prej Qeverisë edhe prej Kuvendit që ky nivel i pagave, Kuvendi në rishikim buxhetor, këtë vit, të miratojë këtë nivel të pagave për gjykatësit edhe në këtë periudhën prej tash deri në 2013. Ne duhet t'i ndihmojmë gjyqësorët edhe me paga, gjykatësve t'u ndihmojmë që t'ju krijojmë kushte që edhe tash deri në 2013 të kenë një motivim më të madh financiar për të punuar. Ju faleminderit dhe iu përshtendes.

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Në emër të AKR-së, deputetja Suzan Novobrdaliu.

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Edhe Grupi Parlamentar – Aleanca Kosova e Re e ka shqyrtuar Ligjin për gjykatat. Të njëjtin në parim e përkrahim, mirëpo i kemi edhe disa vërejtje teknike dhe përmbajtjesore.

Në nenin 5, përmendet shumëllojshmëria e gjykatave, u përmend edhe më herët nga deputeti Bahri Hyseni. Edhe unë mendoj që nuk duhet të jetë shumëllojshmëria e gjykatave, por të jetë përbërja etnike e gjykatave.

Neni 6, thotë se, tek vendimet e gjykatës, vendimet e gjykatës hartohen në formë të shkruar, në të cilën duhet të paraqiten arsyet, përfshirë këtu edhe çfarëdolloj mjete juridik apo ndëshkimi. Vendimet e gjykatës nuk përbëhen vetëm nga arsyetimi dhe nga këshilla juridike, por përbëhen edhe nga preambula, dispozitivi, arsyetimi dhe këshilla juridike. Kjo duhet të ndryshojë, të përmirësohet.

Në faqen 11, neni 11, kemi të bëjmë me organizimin e brendshëm të gjykatës, ku thuhet se , flitet për çështjet ekonomike dhe administrative, që lihen të jenë në kompetencë të Gjykatës Themelore. Çështjet administrative, nëse lihen të jenë në kompetencë të Gjykatës Themelore, atëherë kemi konflikt me Ligjin për konflikte administrative, ku kompetencë është Gjykata Supreme. Derisa, për zgjidhjen e çështjeve ekonomike, si gjykatë e vetme thuhet se është Gjykata Themelore, me seli në Prishtinë, mendoj se në këtë drejtim kishte qenë mirë të jenë së paku edhe dy gjykata tjera, për shkak të efikasitetit të kryerjes së lëndëve, në dy qytete tjera të Kosovës.

Pastaj, në pikën 6 thuhet “me kërkesën e një kryetari ose kryetareje”, këto duhet të përmirësohen gjuhësisht se nuk duhet të jetë “me një kryetare po me kërkesën e kryetarit” e më tutje.

Në pikën 7 thotë se “sipas rregulloreve të themeluara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, kryetari i secilës gjykatë themelore cakton lëndë në Departamentin e duhur sipas

rregulloreve të themeluara”, s’më duket fjalë adekuate të themeluara, të hartuara, të përpiluara, mirëpo jo themeluara, si dhe thotë “secilës gjykatë, “secilës” mendoj se duhet të hiqet ajo fjalë. Do të thotë, edhe gjuhësisht duhet të ketë përmirësime, por edhe në përmbajtje. Gjithashtu, thuhet “palët apo pala mund të kontestojë caktimin e një lënde në një departament të caktuar përmes paraqitjes së kërkesës, kryetarit të gjykatës” dhe më tutje vazhdohet. Këtu duhet të rregullohet, sepse ka të bëjë me lëndën e cila i dorëzohet një departamenti, i cili nuk është kompetent dhe duhet të jetë, për shembull – lëndën për vendosje, do të thotë pala ka të drejtë të paraqes kërkesë te kryetari kur ka të bëjë me caktimin e lëndës në departamentin jo kompetent dhe më tutje të rregullohet, do të thotë kjo.

Pastaj, në pikën 8, thotë “me kërkesë të një pale apo një gjyqtari” kjo të hiqet: “me kërkesë të palës apo gjyqtarit” e jo të një pale të një gjyqtari dhe gjithashtu në fund thotë “një lëndë tek një degë tjetër nëse përcaktohet” do të thotë “jo përcaktohet”, por “konstatohet” dhe kështu, do të thotë, me radhë.

Pastaj, në nenin 15, thuhet, është bërë bajagi një gabim, thuhet se “gjykatat themelore dëgjojnë dhe gjykojnë”. “Dëgjon” nuk më duke fjalë adekuate për këtë, normal që dëgjojnë dhe pastaj gjykojnë.

Pastaj thotë “veprat penale në vijim të parapara me Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës”. Kod të përkohshëm më s’ kemi. E kemi Kodin Penal të Kosovës. Do të thotë, kjo duhet të fshihet.

Neni 15, pika 1.20 “çfarëdo krimi” jo por “çdo krim”.

Pastaj e kemi nenin 19, pika 2 të konkretizohet, të jetë më e qartë.

E kemi nenin 21, thuhet “Gjykata Supreme ka kryetarin, siç parashihet në nenin 103 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Kryetari, po ashtu mund të kryejë edhe detyra të tjera të parapara me ligj”. “Po ashtu mund” nuk duhet të jetë ashtu, por duhet të jetë “kryetari kryen edhe detyra tjera të parapara me ligj”, e jo “po ashtu mund të kryejë”.

Neni 25, titulli, thotë “Rregulloret për organizimin e brendshëm të gjykatave”. Mendoj se duhet të rregullohet dhe “kjo rregullore” duhet të hiqet, të jetë “organizimi i brendshëm i gjykatave”.

Neni 26, kualifikimi i gjyqtarëve, pika 1. Formulimi të bëhet më i mirë, si dhe te kualifikimet, përmenden “të paktën”. Mendoj duhet të jenë ” strikte” jo “të paktën” ose maksimale ose më shumë, duhet të konkretizohen kushtet për emërimin e gjyqtarëve, çka duhet të plotësohen. Thotë, më poshtë “përveç kualifikimeve minimale”, pastaj vazhdohet me kualifikimet tjera, çka nuk jam e pajtimit të jenë ashtu.

Neni 25, pika – te përvoja e gjykatave. Edhe unë kam vërejtjen e njëjtë si të deputetit Bajram Kosumi. Mos ta zgjas më shumë, vërejtja krejt e njëjtë si deputeti i mëparshëm që e dha.

Pastaj në nenin 27, pika 3. Viti le të përmirësohet, se është thënë 1 janar 1017. Tek pika 4, prapë 1 janar 1020. Këto duhet përmirësuar.

Te kompensimi. Nuk po hyj në atë , kompensimi a duhet të jetë në këtë ligj apo nuk duhet të jetë në këtë projektligj, mirëpo e kemi në pikën 1.7, thotë “çdo gjyqtar i Gjykatës Themelore do të pranojë një pagë bazë, jo më pak se 70% të pagës së kryetarit” Dallimi 30%, në mes të pagës së kryetarit dhe gjyqtarit, është dallim i madh, mund të tolerohet deri në 10% e jo 30%.

Si dhe, tek pagat, tek neni 29, e kam vërejtjen shumë të madhe, sepse parashihen, nëse mendohet të mbeten, domethënë , pagat në këtë projektligj, atëherë hyrja në fuqi e këtij ligji, me nenet 35, 36, 38 dhe 40, parashihen të hynë në fuqi më 1 janar 2011, çka do të thotë se nuk përfshihen pagat e gjyqtarëve, por përshihen që këto rritje të bëhen në vitin 2013, për çka jam shumë kundër, sepse ne jemi tërë kohën duke thënë që shtylla kryesore janë ekzekutivi, legjislativi, gjyqësori. Atëherë t'i krahasojmë rrogat e ekzekutivit, legjislativit me të gjyqësorit, dalin shumë rrogat më të ulëta, për çka aspak nuk jam e pajtimit. Prandaj, nëse ngel kështu, si dhe, nëse tërë kohën jemi duke folur se gjyqësori duhet të forcohet, do të thotë, jeni kah thoni që po bëni çmos e me këtë mënyrë po shihet që s'po boni çmos, atëherë nëse mbesin pagat duhet që ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 2013, me përjashtim të neneve 29, kur parashihen pagat e gjyqtarëve 35, 36, 38, 40, të cilat do të hyjnë në fuqi, më 1 janar 2011. Faleminderit.

KRYETARI: Faleminderit! Unë po kërkoj që tash nga Komisioni, nëse çështja e pagave nuk është standard i të gjitha vendeve, do të thotë – hiqeni nga ligji dhe le të rregullohet me një ligj çështja e pagave.

Në emër të LDD-së fjalën e ka deputetja Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kolegë të nderuar deputetë,

Duke pasur, vërtet, parasysh gjendjen shumë të rëndë të funksionimit të drejtësisë, gjykatave në Kosovë, ky ligj është më se i vonuar, andaj Lidhja Demokratike e Dardanisë në bazë të shqyrtimit që i ka bërë, konsideron se ky ligj relativisht rregullon këtë fushë.

Natyrisht, me këtë ligj pretendohet që të garantojë sistem unik të gjykatave në tërë territorin e Kosovës dhe urojmë që të ndodhë një gjë e tillë.

Ne si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, natyrisht se do të japim kontributin tonë në komisionet funksionale.

Unë nuk do të ndalem këtu të jap vërejtjet nen për nen, ku ne kemi vërejtjet tona, por doemos duhet të ndalemi tek neni 29 për përcaktimin e pagave të gjykatësve, për arsye se kjo është ndoshta një ndër çështjet më kurciale. Në qoftë se vërtet ne pretendojmë të bëjmë një reformë të gjykatave në Kosovë , nuk mund të mendojmë që me këto paga, të cilat i kanë gjykatësit, mund të ndodhë një gjë e tillë. Përvojat e shteteve të Bashkësisë Evropiane, zoti kryetar, po e marr shembull Slloveninë, po këtë fushë e rregullon pikërisht me Ligjin për gjykatat. Edhe pse ne në Kosovë kemi përvojë që shumë agjencive dhe rregullatorëve që i ka formuar ky Kuvend, iu ka përcaktuar paga me ligj, me të njëjtin ligj që funksion ai agjencion apo rregullator, prandaj, kur i kemi parasysh gjykatat, në fakt, sa të rëndësishme dhe sa nevojë ka për t'u reformuar, atëherë nuk do koment që ne duhet t'i përvishemi punës dhe në bazë të këtij ligji duhet t'i rregullojmë pagat e dinjitetshme për gjykatat e Kosovës. Përndryshe, mos të pretendojmë t'i mashtrojmë as qytetarët as veten se mund të bëjmë reforma në gjykatat e Kosovës.

Unë nuk dua të lëshohem shumë dhe të marr kohë. Edhe në herë, premtojmë që Lidhja Demokratike e Dardanisë, në mënyrë shumë profesionale të japë kontributin e vet dhe pretendojmë që vërtet ky ligj të rregullohet. Dhe, natyrisht, mos të harroj se ky nen duhet të hyjë në fuqi së paku, ligji duhet të fillojë për t'u implementuar në vitin 2011, sepse ne nuk mund ta lëmë edhe 2-3 vjet në anarki kështu gjykatën dhe të themi se kemi bërë një ligj. Kushtimisht po e lëmë për këtë vit se buxheti është aprovuar, edhe pse ka mundësi për rishqyrtim të buxhetit në qershor, megjithatë në fillim të vitit 2011 gjithsesi ky ligj me gjithë këtë nen duhet të fillojë të implementohet dhe pastaj natyrisht t'i shohim rezultatet. Faleminderit për vëmendjen!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar 7+, deputetja Myfera Shinik e ka fjalën.

MÜFERA ŞINIK: Sayın Başkan, Bakanlar ve Milletvekilleri

Mahkemeler Yasa Tasarısının Kosova için çok önemli olduğu bilinmektedir. Yasa Tasarısında yeni sistemle çalışılması öngörülüyor, çağdaş bir şekilde çalışmalar için hazırlanmış bir Yasa Tasarısı. Ancak Yasadaki bazı mahkeme kategorileri sadece tek merkezli öngörülmuş, vatandaşların işlerini kolaylaştırmak için diğer belediyelerde de şubelerin açılması gerekmektedir. Niceki Prizren gibi daha büyük belediyelerde.

Yasama Komisyonunda bu Yasa Tasarısını kabul etmişizdir.

7+ Parlamento grubu olarak da incelemişiz ve birinci okunuşunu kabul etmekteyiz. Gerekli uyarı ve önerileri Fonksiyonel Komisyonuna sunacağız.

Teşekkür ederim.

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-ës, a e do dikush fjalën?

E ka fjalën Petar Miletik.

PETAR MILETIĆ: I naša Poslanička grupa u načelu podržava ovaj zakon i takođe ćemo kroz funkcionalne komisije dati svoj doprinos.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar për Integritet nuk ka. Atëherë vazhdojmë me diskutimet e deputetëve. Para se t'ua jap fjalën kemi parasysh se po diskutojmë në parim dhe e votojmë në parim ligjin.

Fjalën e ka deputeti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuari Kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Padyshim që ardhja e këtij ligji në Kuvendin e Kosovës është një ngjarje shumë e rëndësishme, sepse ka 10 vjet që sistemi gjyqësor ka funksionuar sipas modelit të trashëguar pas luftës dhe ky ligj jep një mundësi të mirë për strukturim organizativ të ri të gjykatave që është vetëm një segment i reformimit të sistemit gjyqësor, sepse siç u tha edhe nga parafolësit, ka edhe segmente tjera që duhet të punojnë që të implementohet një reformë e suksesshme e sistemit gjyqësor.

Risia e këtij ligji është që instalon një skemë të re organizative të gjykatave duke siguruar një organizim të gjykatave në tri instanca, sistem krejtësisht i ri, sepse suprimon sistemin ekzistues, ku kemi pasur gjykata komunale, gjykata të qarkut dhe gjykata supreme dhe kemi pasur edhe gjykata për kundërvajtje dhe gjykata ekonomike. Ky është një model

shumë më i thjeshtë, sepse do të kemi gjykata themelore, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme dhe padyshim se kjo është shumë e rëndësishme.

Duke përkuar me natyrën e leximit të parë, unë do të jap disa vërejtje parimore, kurse vërejtjet konkrete do t'i deponoj më vonë.

E para, mendoj se krahas përpjekjes që në këtë ligj instalohet pavarësia e plotë e gjyqësorit, ka vend ende shtesë që të instalohen mekanizma ligjorë që kjo pavarësi vërtet të implementohet dhe të mbrohet, jo vetëm nga interferimet politike, por edhe në raport me dy degët tjera të pushtetit.

Çështja e dytë ka të bëjë kryesisht me procedurën e përzgjedhjes së gjyqtarëve, kualifikimet e gjyqtarëve dhe përvojën e punës. U tha edhe më herët që ligji në mënyrë decisive përcakton kushtet, përzgjedhjet e gjyqtarëve dhe unë mendoj personalisht se këto kushte pak a shumë janë diskriminuuese, sepse padrejtësisht kërkojnë një përvojë të lartë të punës dhe gjasa për rekrutim apo për aplikim në këto gjykata kanë vetëm juristët që kanë 15, 10 vjet apo më pak përvojë pune, çka do të thotë kryesisht juristët që kanë punuar në një sistem ku sundimi i ligjit dhe gjyqësia nuk kanë qenë të pavarura, por kanë qenë kryesisht pjesë e një sistemi monist. Kështu që unë propozoj që të rishqyrtohet në pikëpamje konceptuale dhe të liberalizohet pak a shumë mundësia e aplikimit të gjasave të barabarta, sepse edhe Kushtetuta e ka promovua parimin e gjasave të barabarta në punësim në shërbimin publik - jo domosdoshmërisht, një kandidat i mirë për Gjykatë Supreme, duhet të ketë 15 vjet përvojë pune. Do të mundet edhe me përvojë më të vogël, në qoftë se është mirë i trajnuar, mirë i shkolluar të jetë kandidat i mirë për përzgjedhje.

Gjithashtu, ajo që u diskutua rreth kompensimit të gjykatave, kjo çështje duhet të trajtohet në pajtim me realitetin tonë. Unë e dëgjova një diskutim në mënyrë paraprake se në disa shtete lejohet që me ligj të veçantë të caktohen, po lejohen, po aty ku gjykatat kanë buxhet të vet të pavarur, ku e kanë edhe një pavarësi të plotë financiare, kurse ne për momentin kemi vetëm një buxhet të Kosovës dhe gjykatat marrin buxhet nga ky buxhet i Kosovës. Dhe, po të ishte një financim plotësisht i pavarur i gjykatave, atëherë do të ishte e mundshme që me një ligj të veçantë, siç është Ligji për gjykatat, të caktohen edhe kompensimet. Por, derisa legjislacioni për buxhetin dhe për pagat nuk është i ndarë, por është unik, është duke u përgatitur Ligji për pagat e të emëruarve publik, është pak problem që me një ligj të veçantë të përcaktohen pagat e gjyqtarëve, kështu që kjo duhet të diskutohet edhe në pajtim me konceptin e reformës së sistemit të pagave, sepse drafti i ligjit për pagat e nëpunësve publik dhe të emëruarve politikë i ka caktuar koeficientin adekuat edhe për gjyqtarët e të gjitha kategorive dhe nuk është e mundshme që me secilin ligj veç e veç të krijojmë precedent të caktimit të pagave.

Çështja e fundit, që dëshiroj të diskutoj, është faza e tranzicionit. Faza e tranzicionit këtu është një kaptinë e veçantë, është kaptinë krejtësisht teknike. Unë propozoj që në leximin e dytë të kemi kujdes që këtë fazë mirë ta precizojmë. Propozoj ta diskutojmë që a ta lëmë brenda ligjit apo ta vendosim në një akt tjetër nënligjor për shkak se këto janë dispozita të përkohshme. Nuk mundet me një ligj organik brenda ligjit të ketë norma të përkohshme. Normat e përkohshme i kemi te dispozitat kalimtare dhe jo në dispozita themelore, kështu që kjo çështje duhet të diskutohet se a mund detajet teknike, datat teknike, të jenë pjesë e një ligji organik – ligjit sistemor?

Dhe, çështja e fundit – çështja e kompetencave të Gjykatës Supreme. Koncepti i ligjit e lejon gjyqësinë e tri instancave, ashtu siç e kemi. Në qoftë se ne nuk krijojmë disa kritere se cilat lëndë mund të apelojnë në Gjykatën Supreme, ne mund ta ngulfatim këtë

gjykatë. Mund ta ngulfatim me qindra lëndë, me mijëra lëndë dhe kjo gjykatë do të jetë joefikase në implementimin e këtyre lëndëve, ndoshta duhet të mendohet për leximin e dytë që mundësia e apelimit të Gjykata Supreme të reduktohet vetëm për vepra penale të nivelit të lartë, të caktohet decidivisht pragu i apelimit të kjo gjykatë, kurse te kontestet pronësore të caktohet vlera e kontestit pronësor. Përndryshe, ashtu siç është në ligj, ne mund të shkojmë që kjo gjykatë të ngulfatet me çdo lëndë, mund të shkojë çdo lëndë në instancën e tretë dhe ne nga një instancë e lartë gjyqësore apo nga një gjykatë supreme do ta shndërrojmë në një gjykatë të rregullt e cila nuk do të mund t'i trajtojë çështjet e nivelit të lartë. Ndoshta edhe ideja e kësaj reforme organizative ka qenë pikërisht reduktimi i rrjetit të gjykatave që ka qenë mjaft joefikas deri më tani, kështu që në leximin e dytë unë propozoj që të amendamentohen edhe një herë kompetencat e Gjykatës Supreme dhe taksativisht të caktohet se cilat lëndë penale, cilat lëndë civile mund të apelojnë te kjo gjykatë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Nekibe Kelmendi!

NEKIBE KELMENDI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë ndiej kënaqësi të madhe sot që diskutojmë dhe është në rend dite Ligji për gjykatat të cilin Ministria e Drejtësisë e ka dorëzuar në procedurë në Qeveri për miratim, më 17 mars 2009, por ka pësuar disa ndryshime në ecje e sipër.

Në parim e mbështes këtë ligj jo në tërësi, por kam disa komente të mia të cilat ndoshta do të ndihmojnë, sepse do të shkruhet transkripti dhe Komisionit funksional do t'i shërbejnë këto komente për përmirësimin e disa ndryshimeve që janë bërë në këtë ligj në ecje e sipër.

Te pjesa e përkufizimeve, thuhet se “procesi i emërimit është proces i verifikimit gjithëpërfshirës e tjera, e tjera dhe thotë “i cili zhvillohet në përputhje me Urdhëresën administrative të UNMIK-ut 2008/2”. Urdhëresa administrative është akt më i ulët, me fuqi më të vogël juridike se sa Rregullorja e UNMIK-ut, që kjo urdhëresë e udhëzon riemërimin dhe kriteret në Rregulloren 2005/52, prandaj ose duhet të hiqet kjo prej këtu ose duhet të futet edhe Rregullorja 2005/52, sepse në bazë të kësaj urdhërese administrative, shumë gjyqtarë janë eliminuar nga konkurrimi për gjyqtarë.

Më pastaj, ka edhe disa vërejtje tjera që janë në kundërshtim me Kushtetutën dhe do të duhej të përmirësohen. Fjala është për nenin 10. “Degët e gjykatave themelore” Në një pjesë, në pikën 10 të këtij neni thuhet “Nëse në territorin e një komune nuk ekziston një degë e Gjykatës Themelore, atëherë kjo komunë mundet që me vendim të kuvendit komunal të kërkojë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës që të themelojë një degë brenda territorit të saj ose që kjo të përfshihet në juridiksionin e Gjykatës Themelore apo të degës së gjykatës më të afërt gjeografikisht”. Kjo normë është në kundërshtim me Kushtetutën, sepse tash nuk kemi më të parapara me këtë ligj gjykata komunale.

Struktura dhe organizimi i gjykatave themelore dhe i degëve të tyre bëhen vetëm me ligj. Nuk është kompetent Këshilli Gjyqësor që të themelojë gjykata, sepse kjo kompetencë është e rregulluar me nenin 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me të cilin janë përcaktuar kompetencat e Këshillit Gjyqësor dhe themelimi i gjykatave nuk është kompetencë e këtij Këshilli, por as e themelimit të degëve e as të departamenteve të një gjykate themelore.

Nga ana tjetër, ky nen apo kjo pjesë është në kundërshtim edhe me nenin 12 për organizimin e brendshëm të gjykatave themelore, sepse në këtë nen.....me 10, në të vërtetë, këtë e citova.

Pastaj, për zgjidhjen e konflikteve ndërmjet degëve të së njëjtës gjykatë themelore, kryetari ose kryetarja e gjykatës, me kërkesë të një pale apo të një gjyqtari të caktuar në atë gjykatë themelore apo në ndonjë nga degët e saj mund ta transferojë një lëndë tek një degë tjetër ose përcaktohet se lënda është caktuar në degën e gabuar. Kjo lejon një mundësi të keqpërdorimit të palëve që, sa herë nuk iu pëlqen një degë ose një departament, të bëjnë kundërshtim, të bëjnë kërkesën për përjashtimin e tij dhe në njëfarë mënyre të bëjnë përzgjedhjen edhe të gjyqtarëve, që nuk do të ishte mirë.

Pastaj, te neni 15. Departamenti për Krimet e Rënda i Gjykatës Themelore, i cili themelohet vetëm për Gjykatën Themelore në Prishtinë. Këtu vërejtja është pothuaj se e natyrës teknike, sepse në këtë nen janë paraparë cilat vepra penale gjykohen te Departamenti për Krime të Rënda dhe janë paraparë edhe kapitujt edhe nenet e atyre krimeve – veprave penale.

Meqë është në procedurë e sipër, ndryshimi i tërësishëm i Kodit Penal dhe i Kodit të Procedurës Penale, do të duhej që të gjithë kapitujt dhe të gjitha nenet nga ky nen të hiqen, sepse mund të mos jenë në përputhje me kapitujt dhe nenet e reja që do t'i ofrojnë Kodi Penal i Kosovës.

Më pastaj, te neni 27, kualifikimi i gjykatësve, u fol këtu, por e kam fjalën për kualifikimin shtesë. Është edhe një paqartësi te neni 26, pika 8. Thotë, të ketë së paku 3 vjet përvojë pune relevante në fushën e drejtësisë. Është diçka e paqartë. A është fjala që ketë punuar në organet e drejtësisë apo në ndonjë kooperativë bujqësore apo në ndonjë ndërmarrje të vogël e tjera, e tjera. Duhet të qartësohet – fjala “relevante”.

Pastaj neni 27. Kualifikimet shtesë, për gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme të zbatueshme deri më 1 janar 2020. Këtu pak është i paqartë dhe do të duhej të qartësohej në shqyrtim të dytë, nëpërmjet të amendamenteve.

Neni 29, i cili bën fjalë për pagat e gjyqtarëve. Ky është ligj special. Unë mendoj se me këtë ligj mund të rregullohen edhe pagat e gjyqtarëve. Me rregullimin e pagave të gjyqtarëve me këtë ligj, luftohet korrupsioni në gjykata. Nga ana tjetër, gjyqtarët nuk janë të varur nga Qeveria se sa do t'ua caktojë buxhetin për pagat e tyre, por do ta ndajnë fatin e pagave të kryeministrit, zëvendësministrave e tjera. Dhe, unë jam për atë që të mbetet neni 29 ashtu siç është edhe këtu, sepse gjyqtarët e prokurorët nuk kanë benificione tjera siç i kanë ministrat apo deputetët, nuk kanë vetura, nuk kanë karburante, nuk kanë shtesa tjera, kështu që do të ishte shumë në favor të luftimit të korrupsionit nëse pagat parashihen kështu siç është paraparë me ligj.

Në nenin 33, janë paraparë detyrat e gjyqtarëve, mirëpo me ligj nuk është paraparë askund e drejta e gjyqtarit për ankesë apo për apelim të vendimit në rast të shkarkimit të tij, që është një mohim i një të drejte themelore të çdo njeriu, e lëre më të gjyqtarit. Prandaj, duhet të shtohet këtu edhe një nen dhe t'u pranohet edhe gjyqtarëve e drejta në apelim të vendimit për shkarkimin, sepse zaten edhe me nenin 105, paragrafi 5 të Kushtetutës, është e paraparë dhe e garantuar e drejta e apelit, në rast të shkarkimit të gjyqtarëve para skadimit të mandatit.

Pastaj, neni 37 e parasheh transferimin e gjyqtarëve, mirëpo Kushtetuta, me nenin 104, paragrafi 6 parasheh se për transferimin dhe ricaktimin e gjyqtarëve kërkohet pëlqimi i tyre dhe pa pëlqimin e tyre nuk mund të bëhet një transferim i tillë. Merreni me mend, një gjyqtar prej Dragashit nëse e transferojmë në Prishtinë, familja i jeton atje dhe i çrregullohet plotësisht jeta.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, edhe një minutë ia vazhdoni, por realisht ky ligj është shkruar goxha herët.

NEKIBE KELMENDI: Faleminderit! Procedura për ankesa, këtu parashihet që të ankimohen apo të apelohehen edhe vendimet e formës së prerë. Ato nuk mund të apelohehen me mjete të zakonshme juridike, vetëm me mjete të jashtëzakonshme juridike dhe kjo është kundër parimeve në drejtësi dhe kundër standardeve.

Dhe e fundit, është paraparë që me hyrjen e këtij ligji në fuqi të shfuqizohet Ligji për gjykatat e rregullta i Jugosllavisë. Nuk ka punuar Kosova para luftës me Ligjin për gjykatat e Jugosllavisë, por e ka pas ligjin e vet – Ligjin për gjykatat e rregullt atë Kosovës, të vitit 1988, prandaj nuk ka nevojë këtu të futet...

KRYETARI: Faleminderit! Ne jemi të gatshëm të rrimë edhe 20 minuta për diskutim, por është mirë ta racionalizoni kohën, sepse vërtet i kemi edhe një 6 deputetë për diskutim.

Fjalën e ka deputetja Nerxhivane Dauti.

NERXHIVANE DAUTI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar, zoti ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për gjykatat është një ligj me rëndësi të veçantë për Republikën e Kosovës, ligj për të cilin jam interesuar që të shqyrtohet në Kuvend e për të cilin kam parashtruar pyetje parlamentare, prandaj e mirëpres sjelljen e këtij ligji në shqyrtim në Kuvendin e Kosovës.

Ligji i propozuar rregullon sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës, duke përfshirë organizimin, juridiksionin dhe kompetencat e gjykatave.

Projektligji për gjykatat i adresohet pushtetit gjyqësor në Kosovë i cili ushtrohet nga gjykatat si organe të pavarura dhe të paanshme. Nxjerrja e këtij projektligji është një nevojë e domosdoshme për reformimin e sistemit gjyqësor duke pasur parasysh faktin që kjo fushë deri më tani është rregulluar me legjislacionin e vjetër, i cili i përket një sistemi të kaluar dhe jo demokratik.

Projektligji i propozuar ka një sistematizim të ri dhe më të qartë të materies që e rregullon, përfshin zgjidhje të reja dhe krijon një infrastrukturë ligjore më të avancuar.

Qëllimi i projektligjit është ristrukturimi dhe riorganizimi i gjykatave në Kosovë, me qëllim që administrimi i sistemit gjyqësor të jetë sa më efikas dhe më i afërt për qytetarët.

Ligji është i harmonizuar me direktivat dhe standardet ndërkombëtare. Sipas këtij ligji, pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës, ushtrohet nga gjykatat themelore me këtë ligj: gjykatat themelore, gjykatat e apelit dhe nga Gjykata Supreme.

Projektligji për gjykatat e Kosovës do të lehtësojë punën e gjykatave dhe do të rrisë efikasitetin e gjykatave në përgjithësi.

Duke marrë parasysh rëndësinë e veçantë që ka ligji për gjykatat, për sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës, e mbështes Projektligjin e propozuar në shqyrtim të parë, ndërsa kontributin tim profesional do ta paraqes në Komisionin funksional. Ju faleminderit për vëmendjen!

KRYETARI: Faleminderit, edhe për kursimin e kohës! Fjalën e ka deputeti, Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar, zotëri kryetar,

Të nderuar ministra,

Deputetë të respektuar,

Disa vërejtje parimore, që janë parimore: Një, po e zëmë, me këtë, sikundër të miratohej ky dokument apo jo, do të institutohej një institut juridik pothuaj se i paparë. Një, po e zëmë. Edhe... e kemi po e zëmë sistemin, e kemi ligjin dhe e kemi konceptin bashkëkohor sa i përket konflikteve administrative. Do të shfuqizohej ligji për konfliktet administrative pa u shfuqizuar. Këtu është përcaktuar ndër të tjera se gjykatat themelore gjykojnë çështje juridike, administrative dhe kjo do të bëhej kështu. Domethënë, do të suprimohej edhe Këshilli për ankesa, që në njëfarë mënyre është supstitut i Gjykatës Administrative të Lartë. Austria, Gjermania, Franca, kanë gjykata supreme administrative. Ne nuk kemi, por kemi Kolegj Administrativ dhe tash do të ishte krejtësisht e palogjikshme dhe e pa precedencë që gjykatat themelore t'i gjykojnë çështjet juridike, administrative e më pastaj do të krijohej edhe një balancë, një **ballast** tepër, për krye të gjitha lëndëve që konsiderohet se janë 250.000 lëndë sot për sot të paprekura. Është fjala te sistemi, te koncepti që nuk mund të kalojë, se nuk ka logjikë dhe nuk ka krahasim të tillë valid. Ne mund të bëjmë diçka çka nuk e ka parë kurrkush, ama do të dilte e shëmtuar.

Më pastaj, ose bie fjala sot për sot, aktualisht, çështjet juridike, administrative, sipas aktpadive, pasi që të ketë përfunduar procedura administrative, i gjykon Gjykata Supreme nëpërmes Kolegjit Administrativ nga 3 gjykatës, e këtu është përcaktuar nga 1 gjykatës. Kjo është qesharake, si me thënë, kështu.

Ose lëndët juridike, civile pothuaj se janë substanca predominante në çështjet e gjykatave themelore. Këtu fare nuk është përcaktuar, si me thënë, korpusi i lëndëve. Këtu thuhet – “Departamenti i përgjithshëm” edhe “për krime të rënda”. Më pastaj për “çështjet ekonomike”, për “civile” fare. Edhe për çështjet administrative.

Një çështje që është si me thënë, koncept, e papranueshme, së paku, sipas meje. Gjykata Supreme që do të duhej të ishte gjykatë kompetente vetëm për çështjet juridike të cilat kanë përfunduar si me thënë, të iniciuara sipas mjeteve juridike të përgjithshme – të jashtëzakonshme, por jo edhe sipas ankesave, nëse do të miratohej alineja 1 e paragrafit 1 – ankesat ndaj vendimeve të Gjykatës së Apelit, bile jo “ndaj”, po “kundër” atëherë Gjykata Supreme do të bëhej gjykatë, jo supreme, por gjykatë e shkallës së dytë. Ajo duhet të jetë gjykatë e instancës së fundit për mjetet juridike të jashtëzakonshme, eventualisht pranë Institutit siç është... në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, po edhe atë

që kolegu i nderuar Bajrami e tha që me vend, apo jo. Po e zëmë çështjet juridike-civile, po e zëmë, tash për tash po e japi si me thënë pa medituari sa duhet e si duhet, po e zëmë të vlerës mbi 100 mijë euro, po e zëmë, ose dënimet penale, po e zëmë kapitale e për ato ka vend që Gjykata Supreme po e zëmë në Kolegjin e Veçantë t'i gjykonte këto çështje.

Në shumë dispozita të këtij ligji, thuhet “nëse nuk rregullohet ndryshe me ligj”. Me cilin ligj? Po ky është ligji, po ky është ligj special – lex specialis derogate lex generalis. Ky është ligj. Po me cilin ligj atëherë, domethënë, do të duhej të bëhej edhe një ligj, nuk e di se cili ligj. Ky përsëritet jo vetëm në nenin 22.

Sikundër të miratohej, po e zëmë, paragrafi 4 i nenit, i cili ke ky, i nenit 28 do të cenohej parimi i së drejtës së fituar. Se, në qoftë se një gjykatës aktual është zgjedhur ai, a po a jo, nuk do të mundte të kërkohej të shkarkohej, po e zëmë, po qe se ligji i më pastajmë do të kërkonte kushte më rigorozë. Kurrresi, apo jo. Ajo do të vlente për ata, për ato që do të emëroheshin më pastaj. Ky është një parim juridik, valid në sistem juridik evropian kontinental, kudo.

Në këtë dokument vend e pa vend, do me thënë, ja një provë, hartuesi nuk e ka lexuar bile dorën e fundit. Po ky nuk është ligj vëllimor, ka mund të lexohet, është dashur të lexohet edhe sikundër të kishte pasur 1000 faqe, kështu që termat e përdorura për një institut juridik të llojllojshme, herë po e zëmë, shembull, ekzemplar, herë gjykatës porotë, herë gjykatës laik, që nuk është asnjëra shprehje adekuate. Porotë nuk është në gjuhën shqipe, laik është ofendues, por në qoftë se përdorim gjykatës profesionalist, gjykatës jo profesionalist. Ka këso terma edhe tjera për të cilat nuk do të isha ndalur. Edhe po e zëmë, te neni 38, e kështu me radhë, kjo është çështje që do të duhej të rregullohej me një akt nënligjor se pa vend përderisa thuhet se gjykata themelore, gjykatë e shkallës së parë aktualisht gjykatat komunale janë gjykata të shkallës së parë, në lëndët e caktuara se gjykatat e qarkut tash për tash nuk janë absolutisht gjykata të shkallës së dytë, por për lëndët e caktuara janë gjykata të shkallës së parë e për ato shkojnë mjetet juridike të rregullta Gjykatës Supreme e që është mirë që ajo të mbyllet, domethënë, gjykatat themelore, gjykata të shkallës së parë, Gjykata e Apelit gjykatë e shkallës së dytë. Gjykata Supreme vetëm për mjete juridike të jashtëzakonshme dhe për po e zëmë për çështjet juridike-penale ku janë dënimet kapitale, juridike civile, po e zëmë apo edhe ekonomike, po ato janë civile sipas vlerës që do të kishim caktuar me konsensus.

Edhe, po e zëmë, neni 41 me nenin 43 është koliziv. Neni 41 thotë: ky ligj, hyn në fuqi me 1 janar 2013, me përjashtim të disa neneve, mirë, ndërsa, neni 43 thotë kështu, “ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës”, domethënë, shikoni, me këtë hyn komplet, a këndej e bën një restriktion për disa nene. Do të thotë, nuk është përgatitur si duhet, nuk është investuar një punë normale jo e jashtëzakonshme.

Natyrisht, kam edhe vërejtje tjera, po këto janë vërejtje parimore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Sylja!

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Deputetë të nderuar,

Se reformat në sistemin gjyqësor janë të nevojshme, kjo është evidente, duke marrë parasysh funksionimin e tanishëm të dobët të gjykatave, pastaj funksionimin e tyre në bazë të ligjit të mëparshëm për gjykatat e rregullta, që ka paraqitur pengesë për zhvillimin e gjyqësisë, grumbullimin e një numri të madh të lëndëve të pazgjidhura në gjykata, korrupsionin në gjyqësorin, si dhe një sistem i tanishëm më i ndërlikuar.

Prandaj, duke i marrë parasysh të gjithë këta faktorë, është me rëndësi të fillojë reformimi i sistemit gjyqësor, por i cili duhet shikuar vetëm si një segment i reformimit të sistemit të drejtësisë, për të cilin konsideroj se patjetër duhet të sillen në Kuvend edhe ligjet tjera, si Ligji për prokurorinë, Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorial. Dhe, një aspekt tjetër me rëndësi, nuk mund të kemi gjykata të fuqishme në qoftë se nuk kemi edhe një arsimim ligjor adekuat në Kosovë ose një formë të re të arsimimit.

Sipas këtij projektligji, reformat të cilat janë të parapara, janë në të vërtetë, si edhe çdo reformë, komplekse dhe të vështira, por unë më tepër do të fokusohem në procesin e zbatimit të mekanizmave ose të zgjidhjeve të cilat i ofron ky projektligj për gjykatat dhe do t'i shpreh pastaj dilemat e mia.

E para, që kisha dashur të diskutoj edhe me ministrin, mbase edhe do të marr ndonjë përgjigje, është se – ministër cili është mekanizmi që është paraparë në ligj apo pse s'është paraparë një mekanizëm i cili do të siguronte se nuk ka ndikime politike në gjyqësorin, sepse kjo sigurisht se e pengon punën e gjyqësorit.

Tjetra është se, zgjidhjet e ofruara në lidhje me zgjidhjen e një numri të madh të lëndëve të grumbulluara nuk janë mekanizma të cilët janë bindës se këto lëndë do të zgjidhen, që do të thotë se do të kemi një gjyqësor më efikas dhe këtu po i referohem nenit i cili flet që Këshilli Gjyqësor duhet të formojë një plan të detajuar, i cili do të merrej me çështjen e tranzicionit, do të thotë, të transferimit të gjyqtarëve, të sistemimit të punëtorëve, të lëndëve e tjerë. Do të thotë, sipas mendimit tim, ky plan i detajuar në këtë fazën e tranzicionit, mbase do të duhej më tepër të definohej me akt nënligjor, i cili në një mënyrë edhe në mënyrën më detaje se sa që është në ligj do të përcaktonte mënyrën e kalimit të fazës së tranzicionit dhe do të siguronte se sistemi i ri do të ndërtohet në mënyrë efektive mbi sistemin e vjetër.

Një çështje tjetër, që dëshiroj ta shtroj patjetër, është çështja e zbatimit lidhur me buxhetin, sepse sipas nenit 40 të Ligjit për gjykatat thuhet se Qeveria e Kosovës do të sigurojë fonde prej buxhetit dhe parashihet një vlerësim shtesë i buxhetit diku afër 6 milionë, ku duhet të merren diku 102 të punësuar, do të thotë, diku 45 gjykatës, por edhe ky buxhet ka të bëjë me rritjen e pagave të gjyqësorit.

Bindja ime personale është se nuk mund të kemi gjyqësor të fuqishëm po mos të mbështeten gjykatësit me paga në të cilat mund ta kryejnë punën e tyre, sepse kemi të bëjmë me përgjegjësi të gjyqtarit i cili edhe mund të kërcënohet jeta e tij ose e anëtarëve të familjes së tij dhe ata kanë të drejtë për t'u mbrojtur, përndryshe nuk kanë se si ta kryejnë punën e tyre, e mos të flas që edhe është edhe një çështje për të larguar korrupsionin nga gjykatat.

Po ashtu ekzistojnë edhe rreziqe tjera financiare, siç janë se nuk dihet se ky sistem i ri i gjykatave sa do të kushtojë në tërësi, sidomos duke marrë parasysh planin të cilin e përmenda për ristrukturimin e gjyqësorit.

Dhe, në fund propozoj që patjetër si Kuvendi ashtu edhe Qeveria, sidomos Qeveria të mendojë për trajtimin e këtyre çështjeve të mjeteve buxhetore në kornizën afatmesme të shpenzimeve 2001-2013. Përndryshe, edhe ashtu, zbatimi i ligjit do të fillojë diku në 2011 dhe sipas ligjit deri në 2020, për të siguruar se reformat do të fillojnë, patjetër buxheti duhet të sigurohet. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Pajtohem plotësisht se ardhja e këtij projektligji edhe pse me vonesë, jo vetëm në krijimin e institucioneve, por edhe pas shpalljes së pavarësisë është i domosdoshëm, është e rëndësishme shumë të veçantë. Do të mundohem që të jam shumë i shkurtër, për shkak se shumëçka edhe tash u identifikuan edhe vërejtjet më kryesore dhe më parimore të cilat i karakterizojnë mangësitë në projektligj.

Së pari, te vlerësimi financiar dhe pajtueshmëria me asqui communautaire është e vitit 2009, domethënë, është e muajit 5 të vitit 2009 dhe nuk iu ka bërë një rivlerësim i ri për vitin 2010 e koston buxhetore dhe kjo e paraqet problemin kryesor për zbatimin apo moszbatimin e këtij ligji. Këtu, domethënë, edhe Qeveria, tash në organizimin e brendshëm në disponimin e tyre për të komunikuar për linjat e ndryshme qeveritare, shihet se këtu nuk iu ka dhënë rëndësi e veçantë apo siç thuhet sot, sepse vlerësimi buxhetor jepet në vitin 2009, ndërsa ligji vjen po një vit prapa në vitin 2010 dhe gjithçka lidhet me këtë temë.

Do të mundohem t'i shkurtoj, sepse u thanë shumica. Shumëllojshmëria e gjykatave apo përbërja etnike, si domi t'i quajmë e cila thirret në nenin 5 përbërja e gjyqësorit pasqyron shumëllojshmërinë etnike të Republikës së Kosovës në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Po çka nëse në degët e gjykatave themelore, për shembull, cila do të jetë shumëllojshmëria etnike në Podujevë ose në Deçan. Prandaj, kjo duhet të futet me nene të veçanta dhe të specifikohet dhe karakterizohet se cila është e nevojshme.

Te neni 15, plotësisht është edhe në kundërshtim tash me procedurat që janë. Departamenti për Krime të Rënda i referohet Kodit Penal të Kosovës. Kodi Penal i Kosovës është në shqyrtim dhe në ripunim tash tërësisht të ri dhe aty thirret në nene të caktuara. Më mirë është që mund të thirren në dispozitat që do të jenë të Kodit Penal të Kosovës dhe t'i referohen në të ardhmen, sepse mos të kemi menjëherë pas aprovimit të këtij ligji plotësim-ndryshim të këtij ligji.

Neni 27, u kuptua nga të gjithë, është një matematikë shumë çuditëse që as ata vetë që e kanë hartuar këtë ligj nuk do të dinë t'i japin shpjegim se si janë ndarë çuditërisht në vite 13, 17, 15, 20 zgjedhja e gjyqtarëve, përvoja e punës. As ndërkombëtarët, as vendorët, as hartuesi i ligjit, as Qeveria.. por ne si deputetë nuk po e kemi të qartë as nuk mundet kush me definuar ndarjen si është bërë sipas përvojës ose çka kërkohet për të qenë gjyqtar në të ardhmen.

Te kompensimet për gjyqtarë u kuptua – mbrojtja. Mbrojtjen nuk mund ta vlerësojë Këshilli Gjyqësor. Mbrojtjen e vlerëson Ministria e Punëve të Brendshme se kemi organe të pavarura, të cilat janë. Edhe pse aty kostoja buxhetore fare nuk paraqitet.

Neni 36, po ashtu vlerësimet, domethënë thirret te zbatimi ose te planifikimi. Flitet për planifikim, zbatimin do ta bëjë ligji i ardhshëm i cili është për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, prandaj këto nene që i përmenda, që i përmendën edhe kolegët, krijojnë

konfuzitet, jo reformë në gjyqësi, por me këtë ligj ndoshta edhe do të ketë stagnim, po ndoshta është më fatmirësi se e kanë paraparë që hyrja në fuqi do të jetë në vitin 2011-2013 dhe deri atëherë sigurisht do të kemi kohë të rishikimit, sepse kështu siç është ky nuk i plotëson nevojat e reformës të sistemit gjyqësor në Kosovë.

Këto janë disa kritika parimore, se s'po e vazhdojmë më gjatë se po keqkuptohemi, mos po kemi pretendime për ministra për ta kritikuar Qeverinë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti dhe anëtari i Kryesisë, Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Unë do të flas vetëm për një nen. Ky është neni i parafundit – hyrja në fuqi, neni 41. “Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 2013, me përjashtim të neneve 3.5, 3.6, 3.8 dhe 4.0, të cilat do të hyjnë në fuqi më 1 janar 2011”. Ky nen është antikushtetues. Dihet me Kushtetutë që çdo ligj hyn në fuqi pasi ta votojë Kuvendi, ta nënshkruajë presidenti dhe të dalë në “Gazetën zyrtare”.

Të dyja këto data, 2013-shi që vlen për gjithë ligjin dhe përjashtimet e katër neneve, që kanë të bëjnë me fazën tranzitore, i bie që për një vit ne s'bëjmë kurrëgjë me këtë ligj, ia ndalojmë vetvetes ta bëjmë edhe fazën tranzitore dhe ta fusim në fuqi ose të hyjë në fuqi tek në vitin 2013. Me një fjalë, ky nen duhet të riformulohet totalisht.

U bisedua këtu edhe për rroga e të tjera, ata që po bisedojnë, le ta lexojnë mirë se nëse ky s'hyn në fuqi deri në 2013, mos të fantazojnë që kanë ndrequr punë, qoftë edhe deklarativisht për pagesat të cilat derivojnë pastaj – drejtësi, përgjegjësi, antikorrupsion e tjera.

Dhe, së dyti, unë e dëgjova me vëmendje ish-ministren, ministren deri para do ditësh, zonjën Kelmendi. Kjo ka bërë aso vërejtjesh të mëdha që njeriu çuditet pse gjithë këto vërejtje në një ligj që e kemi përpara. Dhe, zonja Kelmendi mua më thotë që po, po është varianti që është, në të cilin është intervenuar nga pika të ndryshme të fuqisë, ta quaj, të ndikimit, e cila e ka bërë variantin e parë shumë të derivuar. Prandaj, unë propozoj që, para se të kalohet në amendamente, të gjithë juristët me profesion e me zakon këtu që i kemi në Kuvend, ta diskutojnë në komisionet funksionale këtë punë para se të bëhet diskutimi publik, sepse, zoti kryetar, nëse ne shkojmë me të gjitha këto variacione, ne do të na duhet ta rishkruajmë me amendamente edhe një herë këtë ligj, që është punë e vështirë dhe nuk është shumë e dobishme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Po shtohen deputetët...! Deputeti, Naim Rustemi e ka fjalën!

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit!

Unë do të ndalem vetëm në dy nene të këtij ligji. Është neni 26 pika 1, ku jepen kushtet e kualifikimit të gjyqtarëve dhe kisha thënë që herëve tjera kur krijohen ligje të tilla, s'ka nevojë të dyfishohen kushtet, sepse ne e kemi miratuar edhe ashtu një ligj – e kemi miratuar Ligjin për provimin e jurisprudencës, në të cilin është saktësisht e definuar se provimit i jurisprudencës i nënshtrohen kandidatët të cilët e kanë të përfunduar fakultetin juridik. Me fjalë të tjera, nëse vendosim ne këtu të ketë fakultetin juridik, në një kusht dhe më pastaj të themi e ka të kaluar provimin jurisprudencës, pikë koti është njëra ndaj tjetrës. Me fjalë tjera, veç fakultetin juridik, sepse nënkuptohet që është provimi i jurisprudencës.

Dhe, gjithashtu kam vërejtje në nenin 32 kur flitet për veprimtaritë profesionale. Kisha pasur dëshirë që Ministria e Drejtësisë të bashkëpunojë ngushtë me Ministrinë e Arsimit dhe që të jetë shumë më e saktë, më profesionale në përcaktimin e të drejtave që kanë të drejtë nga aspekti i veprimtarisë profesionale të ndodhin nëpër gjykatës, po edhe tek njerëzit të cilët i nënshtrohen vendimeve që merren nëpër gjykata nga aspekti etik i saj dhe që në njëfarë forme të jemi pak edhe shoqëri më etike, sepse aty kemi të bëjmë me grupe ndoshta edhe që janë vullnerabel ndaj, si për shembull si janë njerëzit që janë të burgosur, ndaj vendimeve të ndryshme që kanë të bëjë drejtpërdrejtë me qenien njerëzore. Me fjalë të tjera që edhe të tjerët që futen të mund të marrin të dhëna për gjykatat dhe gjyqtarët t'i nënshtrohen një, si me thënë, kodi etik që do të ishte prodhim i Ministrisë së Arsimit e të Shkencës dhe Ministrisë së Drejtësisë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti, Driton Tali e ka fjalën!

DRITON TALI: Faleminderit!

Unë, po ashtu do të jem konkret në dy pika, ndonëse i pata tri pika, por zoti Sabri Hamiti i plotësoi ato, i tha ato çka desha të them.

Sidoqoftë, unë do të ndalem, po ashtu, te kualifikimi i gjyqtarëve, te pika 1.2., ku thotë se, “të ketë së paku 25 vite” Shtrohet pyetja- çka? 25 vite moshë apo eksperiencë? Nëse është 25 vite eksperiencë... Pastaj, e qet nga loja, po them, pikën 1.6, jo ekskluzivisht, por më falni, por zakonisht, gjersa të jetë 25 vite moshë, kjo as teoretikisht nuk ka mundësi për shkak se, nëse merret nga fakti se për t'u bërë gjyqtar, të vyen fakulteti, fakulteti është 3 + 2, që bën 5 vite. Pastaj, vjen 1 vit eksperiencë për provimin e jurisprudencës, do me thënë u bën 24 vjet apo 25, nëse kandidati e ka kryer shkollën e mesme në moshën 17 vjeçare apo 18 vjeçare. Pastaj vijnë 3 vite eksperiencë pune për t'u bërë gjyqtar, që do me thënë kalon 28-shi, në aspektin teorik edhe praktik.

Duhet të qartësohet, me fjalë tjera, 25 vite çka kërkohet. Nëse kërkohet 25 vite eksperiencë pune, atëherë na kthen në monizëm, do me thënë na kthen te integriteti moral apo personal, te pika 1.1.6, ndonëse pajtohem se kjo është shumë deskriptive, por ne që nga viti 2000 kemi të bëjmë me gjyqtarë moralisht të shantazhuar, sidomos ata që ishin aktiv në periudhat e diktaturës apo të aparthejdit, të cilët kanë marrë detyra të rëndësishme për të luftuar paligjshmërinë në Kosovë, e dihet se ata individë nuk mund të marrin vendime, të ndajnë drejtësi për shkak të shantazheve, njerëz, po them, me personalitet apo me integritet të ulët personal.

Andaj, do të kërkoja që kjo të qartësohet. Kjo pastaj do të lidhet edhe te Gjykata Supreme. Gjithmonë flas për integritetin personal apo moral të personave atje, të cilët nga definicioni do të duhej të ndanin drejtësi. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputeti Bujar Dugolli e ka fjalën.

BUJAR DUGOLLI: Ju faleminderit, kryetar!

Unë prita që po i thonë disa çështje që mendova edhe unë tash t'i them, por mbasi që nuk u thanë nga të tjerët, mendoj që do të ishte mirë që të na sqaronte ministri te aspekti i përkufizimeve, neni 1.1, te procesi i emërimeve, do me thënë, këtu thuhet është proces i verifikimit gjithëpërfshirës në mbarë Kosovën, të përshtatshmërisë së të gjithë aplikantëve për emëime të përhershme deri në moshën e pensionimit të paracaktuar me ligj, e nënkuptohet që, në rast se emërohen një herë, ata më nuk kanë nevojë të emërohen më kurrë derisa të pensionohen apo është e paracaktuar ndryshe. Plus thirret këtu në një

rregullore administrative të UNMIK-ut, që mendoj se duhet të na sqaroni ose pse nuk ka rregullore apo udhëzim tash të institucioneve të Kosovës, por prapë thirreni në këto të kaluara. Tek neni, te kreu i tretë, ku flitet për strukturën organizative dhe kompetencat e gjykatave, tek gjykatat themelore, neni 2.4 do të doja të pyesja, ku bëhet fjalë për Gjykatën Themelore të Gjakovës dhe futet këtu në tërësi territori i komunës së Gjakovës, Malishevës, Rahovecit. Malisheva, a ka qenë gjithë me këtë gjykatë të Gjakovës apo tash është bërë një kombinim i tillë dhe a do të ishte më mirë të ishte Prizreni apo Gjakova, veç kërkoj sqarime për këtë. Ju faleminderit, nuk kam diçka tjetër.

KRYETARI: Ju faleminderit, dhe diskutuesi i fundit është deputeti Gani Koci.

GANI KOCI: Zoti kryetar, ju faleminderit!

U thanë shumë çështje dhe nuk dua t'i përsërisë, po sigurisht se pak u intrigova ose u befasova me diskutimin e ministres Kelmendi dhe në qoftë se vërtet ekziston e vërteta që ky projektligj nuk është ai që është përgatitur në kohën e saj, atëherë vërtet nuk di se si komisionet do t'i kishin bërë këto ndryshime dhe si do të kenë mundësinë dhe kapacitetet që vërtet t'i përfshijë të gjitha ato ndryshime në këtë Projektligj. Prandaj, është çështje e Kuvendit që të vendos për këtë.

Dhe një çështje tjetër që është më tepër çështje, e përmendi edhe profesori Sabri, që ku ka kuptim që një dispozitë...

(Kryetari: deputetët le të kthehen në sallë për votim)

...të miratohet në vitin 2013, kur sot është në kundërshtim me Kushtetutën. Neni 80, pika 6, thotë decidivisht se kur një ligj hyn në fuqi dhe e ka edhe një presje tjetër, përveç nëse me ligj përcaktohet ndryshe. Prandaj, në ligj është përcaktuar se një dispozitë mund të mos aplikohet në ditën e hyrjes në fuqi të atij ligji, por një vit, dy ose gjashtë muaj më vonë se ai ligj. Prandaj, ne si deputetë jemi në dilemë a ta pranojmë si të tillë komplet këtë projektligj, me të gjitha ato vërejtje që u thanë dhe Komisioni përkatës a do të ketë mundësi që t'i bëjë të gjitha ato ndryshime, që për mua më duket se janë të arsyeshme që të bëhen.

KRYETARI: Mirë. Fjalën e ka, për replikë, deputetja Nekibe Kelmendi, pastaj Sabri Hamiti.

NEKIBE KELMENDI: Është e vërtetë që Ligji që e kam hartuar, është dorëzuar në Qeveri më 17.03.2009, mirëpo nuk ka qenë i miratuar. Më 1.03. të këtij viti është miratuar, kështu që ka pasur mundësi të ndryshohet. Unë apeloj që për hir të proceseve, të miratohet ky ligj dhe të amendamentohen ato çka janë për t'u amendamentuar, sepse na pret Raporti i progresit dhe do të jetë një minus shumë i madh nëse ky ligj sot nuk miratohet, në parim.

KRYETARI: Ju faleminderit, deputete! Sabri Hamiti, pastaj ju ministër.

SABRI HAMITI: Ju faleminderit!

Unë kolegut nuk dua t'ia përmend emrin, se nuk dua të më replikosh ti edhe njëherë, por po sqaroj. Arsytet e mia ekzistojnë që i thashë. Finalja është që ai nen të mos jetë i formuluar... Nëse gjendet neutraliteti kushtetues që procedura ndryshohet dhe është e kushtetuese, nëse thuhet në një pikë të veçantë të rendit të ditës kur hyn në fuqi, e pra

unë thashë dhe po e përsërisë, ai nën duhet të rishkruhet, në mënyrë që ligji të hyjë në fuqi më herët. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Zoti ministër, shkurt, nëse e ke ndonjë fjalë.

MINISTRI HAKI DEMOLLI: Unë, së pari do ta kisha filluar nga pyetja e koleges Gjylnaze, e cila pyeti për mekanizmin për mbrojtjen nga ndikimet politike, kurse pyetja m'u drejtua mua personalisht. Vetëm ia kisha bërë ume dije se ky projektligj është dorëzuar në mars të vitit 2009, kur unë kam qenë larg prej Qeverisë dhe larg prej Ministrisë. Prandaj, vërtetë, jam këtë moment, por projektligji është dorëzuar shumë më parë. Kurse, sa i përket pyetjes së kolegut Bujar Dugollit, deputetit Bujar Dugolli, mund të them se procesi i emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve është rregulluar me nenin 150 të Kushtetutës së Kosovës dhe pikërisht neni 5 atje, që është aprovuar në këtë Kuvend, pak është, të themi, jo aq i qartë, por thotë se pavarësisht nga dispozitat e neni 105 të kësaj Kushtetute, mandati i të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve, që në mënyrë të suksesshme e kalojnë procesin e emërimit, siç është përcaktuar në këtë nen dhe të cilët e kanë ushtruar funksionin së paku dy vite para emërimit, sipas këtij neni është i përhershëm deri në moshën e pensionimit sikurse është përcaktuar me ligj, përveç nëse shkarkohen në pajtim me ligjin, që do të thotë nëse kanë kryer ndonjë vepër penale. Dhe, krejtësisht në fund, do të kisha theksuar, pavarësisht vërejtjeve, me disa prej të cilave edhe unë personalisht pajtohem, jam i mendimit që ky projektligj sot në parim të aprovohet, për shkak se:

- 1) Përmban parimet tejet të rëndësishme për gjyqësorin e Kosovës, të cilat hasin pothuajse në të gjitha ligjet bashkëkohore të kësaj natyre.
- 2) E përcakton një strukturë të re organizative për gjykatat tona që është e përafërt me shumicën e vendeve të Evropës.
- 3) Paraqet Ligjin bazë për reformimin e sistemit gjyqësor të Kosovës, që është kërkesë gati e të gjithë qytetarëve dhe të komunitetit juridik të Kosovës.
- 4) Njëherësh ky ligj do të shërbejë si bazë për nxjerrjen e ligjeve të tjera nga lëmi i gjyqësorit, siç janë: Ligji mbi këshillin gjyqësor, Këshillin prokurorial, prokurori.
- 5) Me këtë ligj do të bëhet një shkëputje apo ndërprerje nga Ligji i mëparshëm, i cili tani më është i tejkaluar.
- 6) Është hartuar nga ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë dhe është në harmoni me legjislacionin *acquis-communitaire*, dhe
- 7) Edhe pse jemi të vetëdijshtë për vërejtjet, mirë është që komentet e juaja të dorëzohen në komisionin funksional, në mënyrë që kur të dalë në shqyrtimin e dytë, të jetë i kompletuar. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!

Gjatë punës mund të sqarohen disa çështje me Qeverinë. Tani është puna e komisionit.

Të nderuar deputetë, votojmë për dy ligjet, votojmë për pikën 4 dhe pikën 5, fillimisht me pikën 4. Është fjala për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për

ujitjen e tokave bujqësore. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Në sallë kemi 70 deputetë.

Me 66 vota “për”, 2 “kundër” dhe 3 abstenime, Kuvendi i miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ujitjen e tokave bujqësore.

Në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional,
- Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
- Komisionin për Buxhet dhe Financa,
- Komisionin për Komunitete, dhe
- Komisionin për Integritet Evropian.

Komisioni duhet që brenda dy muajve, nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t’ia paraqesin raportin me rekomandime. Pasi është ligj i plotësuar, kishte për të qenë mirë që sa më shpejt të sillet raporti me rekomandime.

Radha është për të votuar ligjin e dytë, në shqyrtim të parë, Projektligjin për gjykatat. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Me 62 vota “për”, 1 “kundër”, 5 abstenime, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për gjykatat.

Në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kuvendi ngarkon këto komisione

- Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional,
- Komisionin për Buxhet dhe Financa,
- Komisionin për Komunitete, dhe
- Komisionin për Integritet Evropian

Komisionet duhet që brenda dy muajve, nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t’ia paraqesin raportin me rekomandime. Ju falënderoj edhe për këtë çështje që e kaluam.

Në rend dite e kemi pikën e gjashtë:

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për grevat

Në bazë të Rregullës 35, pika 1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim, në parim, të këtij Projektligji.

Ftoj ministrin Yagcilar, që në emër të Qeverisë, para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë Projektligjin.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë dhe të pranishëm,

E drejta në grevë sipas konventave ndërkombëtare, po ashtu edhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është një e drejtë e garantuar dhe e pakontestueshme.

Të punësuarit në organizatat e ndryshme të punëtorëve, kërkesat dhe të drejtat e tyre i realizojnë përmes formave të ndryshme të deklarimit. Njëra ndër format e deklarimit

dhe të prezantimit të kërkesave për mbrojtjen e interesave sociale dhe ekonomike të punëtorëve është edhe organizimi i grevave nga të punësuarit. Kjo formë e parashtrimit dhe prezantimit të kërkesave për realizimin e të drejtave nga marrëdhënia e punës nuk ka qenë e rregulluar me norma juridike. Në marrëdhëniet juridike të punës të krijuar ndërmjet punëtorit dhe punëdhënësit lindin të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë reciproke, ku në ato marrëdhënie mund të ketë probleme, si mosmarrëveshje, konflikte të cilat duhet të zgjidhen sipas rregullave të caktuara. Moszgjidhja e problemeve të konflikteve dhe mosmarrëveshjeve mund të sjellin edhe organizimin e grevave masive nga punëtorët e pakënaqur.

Në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve, sidomos të të drejtave kolektive të një numri më të madh apo të një kategorie të punëtorëve, rol të rëndësishëm mund të luaj edhe Sindikata, e cila ka edhe përgjegjësi për mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të punëtorëve.

Të nderuar deputetë,

Projektligji për grevat rregullon çështje shumë të rëndësishme për të punësuarit, ku përfshin kushtet për organizimin e grevës së punëtorëve, duke iu dhënë të punësuarave lirinë sindikale për organizimin e grevës me qëllim që të mbrohen interesat ekonomike, shoqërore dhe sociale.

Projektligji për grevat përmban dispozitat e nevojshme për paralajmërimin e grevës për të punësuarit dhe mbajtjen, kohën e fillimit të grevës, paralajmërimin, përkatësisht lajmërimin e grevës tek organet përkatëse kompetente, në mënyrë që të ruhet rendi dhe qëllimi i grevës. Meqenëse është fjala për një projektligj me rëndësi të veçantë për të punësuarit, si dhe duke u mbështetur në aktualitetin kosovar, me ç'rast Qeveria e Republikës së Kosovës dhe institucionet e tjera janë duke u përballuar me kërkesat shumta të të punësuarave me rastin e organizimit të grevave, ju lus që Projektligjin e përmendur ta përkrahni dhe të miratohet, në parim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër!

Më lejoni që ta hapi debatin për diskutim në parim të këtij Projektligji. Në emër të Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, unë kam shumë të lajmëruar, por a ka ndonjë...? Po, Sadik Idriz është. Fjalën e ka deputeti Sadik Idriz.

SADIK IDRIZ: Hvala predsedavajući!

Poštovane kolege poslanici,

Ministri,

Komisija je razmatrala prijeto nego što zakon dođe na prvo čitanje i smatra da je Zakon urađen kvalitetno, ali predlaže da se povuče da se vrati nazad, da ne ide u dalju proceduru. Razlog je jednostavan, što Vlada još nije dostavila Zakon o radu, bazični zakon, a ovaj Zakon o štrajku, nekoliko članova se vezuju sa Zakonom o radu i poziva se na Zakon o radu. Jednoglasno su članovi Komisije mišljenja da se Zakon varati i da bude procesuiran nakon što bude usvojen Zakon o radu. Ne možemo regulisati prava koja proizilaze iz Zakona o radu, i jedno od tih prava je pravo na štrajk, a da nemamo za sada zakon koji reguliše prava radnika, njihove obaveze, dužnosti i mnogo drugo čega.

Znači, u ime Komisije tražimo da se zakon zaustavi, vrati i da ne ide u dalju proceduru. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të komisioneve tjera, nuk shoh... Në emër të grupeve parlamentare, për Grupin Parlamentar të PDK-së, deputeti Ramadan Avdiu e ka fjalën.

RAMADAN AVDIU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, me vëmendje e ka shqyrtuar Projektligjin për grevat dhe konsideron se ky ligj është i domosdoshëm për shoqërinë tonë, ngase përveç rregullimit dhe garantimit të lirive dhe të drejtave të punëtorëve për organizimin e grevave, atëherë kur nuk mundën të dakordohen punëdhënësit e tyre në formë tjetër, ai e plotëson një vakum ligjor në shoqërinë tonë.

Projektligji është i hartuar jashtëzakonisht mirë, është eksplicit dhe qartëson mënyrën, kushtet, të drejtat dhe detyrimet e punëtorëve dhe të punëdhënësve gjatë organizimit të grevave. Po ashtu, ligji sanksionon se cilat kategori të të punësuarve nuk kanë të drejtë të organizojnë grevën. Zbatimi i ligjit nuk përmban implikime dhe kosto buxhetore.

Ndonëse akoma nuk e kemi aprovuar Ligjin e punës, të cilin shpresojmë se së shpejti do ta kemi në Parlament, Ligji për grevat është hartuar në përputhje me rregullat dhe parimet themelore të Organizatës Ndërkombëtare të Punës dhe në përputhje me konventat ndërkombëtare për të drejtat dhe mundësitë e punëtorëve për grevat e ligjshme.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, në parim e mbështet Projektligjin për grevat dhe zotohet se gjatë shqyrtimit në komisionin funksional dhe në komisionet e tjera do të angazhohet për të kontribuar konkretisht në përgatitjen për leximin e dytë dhe aprovimin përfundimtar të këtij ligji të nevojshëm.

Me këtë rast, të nderuar deputetë, unë dua të tërheqë vëmendjen në një vërejtje konkrete, në faqen 7, neni 9, paragrafi 4, për të cilin konsideroj se duhet të riformulohet ose duhet të fshihet i tërë paragrafi nga teksti. Ju faleminderit!

Sa i përket qëndrimit të komisionit, ne mendojmë pavarësisht se mungon dhe akoma nuk është aprovuar Ligji i punës, konsiderojmë se është i domosdoshëm Ligji për grevat, sepse jemi dëshmitarë që ka pasur dhe janë në futur në grevë edhe kategoritë e të punësuarve, të cilët normalisht në një shoqëri normale dhe në një shtet të organizuar mirë, nuk do të kishin pasur të drejtë të bëjnë grevë.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, ftoj deputeten Nurishahe Hulaj ta marrë fjalën.

NURISHAHE HULAJ: Ju faleminderit, kryesues i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Projektligji për grevat procedohet në Kuvendin e Kosovës për herë të dytë, megjithatë paraprakisht projektligji është shqyrtuar në komisionin funksional me datë 6 prill 2010 dhe në lidhje me këtë Projektligj, anëtarët e komisionit funksional i kanë dhënë vërejtjet e tyre me përmbajtjen se ky projektligj nuk do të duhej të kalojë pa pasur mbështetje në Ligjin e punës, që është ligj i rëndësishëm për punëdhënësin dhe punëmarrësin.

Paraqes disa arsye pse ky projektligj nuk do të duhej të kalojë, duke u bazuar në fakte ndërkombëtare, por edhe në disa dispozita të këtij projektligji. Edhe pse ligji është shumë

mirë i strukturuar dhe është shumë i rëndësishëm, mirëpo në prapavijë nuk e ka një bazë dhe një mbështetje ligjore për t'u zbatuar. Prandaj, i paraqes disa arsye:

1) Pakti ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, parasheh të drejtën e grevës të ushtruar në përputhje me ligjet e vendit përkatës.

2) Këshilli i Evropës, Karta sociale evropiane, neni 6.4, njeh të drejtën e grevës, por duke u respektuar detyrimet që mund të rrjedhin nga kontrata kolektive në fuqi, të cilën kontratë kolektive punëtorët e Republikës së Kosovës nuk e kanë.

3) Karta e të drejtave fundamentale e BE-së parasheh të drejtën në grevë, neni 28 i kësaj Karte njeh të drejtën e punëtorëve për të lidhur kontratë kolektive, kurse një e tillë nuk ekziston, sikurse nuk ekziston as Ligji i punës.

4) Bazuar në këtë Projektligj për grevat, sipas nenit 7, paragrafi 1.1, që është në dispozitat e po këtij ligji, është në shpërputhje me arsyen e hyrjes në grevë të punëtorëve. Citoj: “Arsyet për ngritjen e punëtorëve në grevë mund të jenë moszbatimi i dispozitave ligjore të cilat mbrojnë interesat e punëtorëve”. Pra, ne nuk kemi dispozita ligjore pas hyrjes së Kushtetutës në fuqi që do të mbrojnë interesat e punëtorëve.

5) Gjithashtu, pika 1.5 e nenit 7, po të këtij projektligji, citoj: “Moszbatimi i dispozitave të kontratës kolektive, (e them edhe një herë, ne nuk e kemi këtë kontratë kolektive të punës) e cila do të duhej të inkorporohej në Ligjin e punës”. Gjithashtu, pika 1.6 e nenit 7 e po këtij projektligji, thotë kështu, citoj: “Për arsye të tjera, të cilat kanë mbështetje në ligjet bazike të zbatueshme të vendit tonë apo në kontrata ndërkombëtare të punës”. Këtë projektligj sponzoruesit janë munduar që ta harmonizojnë me konventat ndërkombëtare, mirëpo nuk kanë gjetur arsyen e plotë. Këto pra ishin disa arsye pse ky projektligj nuk duhet të miratohet pa pasur paraprakisht Ligjin e punës. Edhe një herë e them, të gjithë anëtarët e komisionit funksional të të gjitha partive janë po të këtij mendimi, që me të vërtetë duhet të ekzistojë Ligji i punës për të qenë ky ligj i zbatueshëm, përndryshe nuk do të gjente zbatueshmëri të plotë dhe do të hasim në probleme të ndryshme. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputete! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fjalën e ka deputetja Gjylnaze Sylja.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

E nderuara ministre,

I nderuar ministër,

Deputetë të nderuar,

Është shqetësuese mënyra e punës së kësaj Qeverie. Ekzistojnë prioritetet në këtë vend, duhet mbrojtur të drejtat e punëtorëve, por edhe të drejtat e punëdhënësve.

Ligji bazik i punës, i cili është paraparë nga vetë Qeveria, me agjendën legjislative është dashur të sillet në Kuvend më 31 mars të këtij viti. Nuk e ka përmbushur Qeveria këtë obligim. Arsyetimi i vazhdueshëm ishte se kostoja është shumë e lartë e ligjit dhe kjo nuk është e vërtetë, kostoja e ligjit është 1.8 milionë euro. Në qoftë se zbatimi i ligjit bëhet me një rregullore, shtroj pyetjen se sa kushton ky ligj në bazë të kësaj rregulloreje, sa po zbatohet kjo rregullore dhe sa kushton ajo rregullore? Do të thotë, ekzistojnë të gjitha kushtet dhe Qeveria e ka buxhetin për ta sjellë ligjin dhe për t'u zbatua në praktikë ky ligj.

Duke marrë parasysh këtë, ju ftoj dhe thërras në ndërgjegjen e juaj që mos ta votoni Projektligjin për grevat, por të ushtroni trysni mbi Qeverinë që ta sjell ligjin bazë, Ligjin për punën. Kjo është e para.

E dyta, është se në këtë mënyrë Qeveria, duke proceduar Ligjin për grevat, po përpiket të mbulojë mungesën e Ligjit të punës dhe të krijojë përshtypjen se po punon, Edhe kjo nuk është e vërtetë.

E treta, janë mangësitë e Projektligjit për grevat. Ky projektligj nuk mund të zbatohet në tërësi për shkak të mungesës së ligjit bazë, të Ligjit të punës, sepse në nenin 6, pika 1.3, ku definohen kushtet e përgjithshme për organizimin e grevës, thotë: “ka për qëllim të realizojë kërkesat nga marrëdhënia e punës, sipas Ligjit dhe kontratës së punës”. Me këtë, do me thënë, nuk mund të mbështetet në këtë dispozitë, nuk mund të zbatohet kjo dispozitë dhe, në qoftë se aprovohet ky ligj, mundet vetëm parcialisht të zbatohet. Me një fjalë, Ligji nuk e arrin qëllimin e vet. Për shkak të mungesës të Ligjit të punës dhe pamundësisë së zbatimit në tërësi të Projektligjit për grevat, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës nuk e mbështet në parim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputete! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputetja Suzan Novobrdaliu e ka fjalën.

SUZAN NOVOBRDALIU: Ju faleminderit, kryesues!

Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re e ka shqyrtuar Projektligjin për grevën. Është një projektligj shumë mirë i punuar, mirëpo siç thanë edhe parafolësit e mi, mungon Ligji bazik i punës, andaj parimisht i njëjti nuk duhet të diskutohet. Duhet të kthehet dhe me ardhjen dhe miratimin e Ligjit të punës, duhet të na vijë edhe Ligji për grevat. Jemi të vetëdijshëm që një ligj i tillë duhet të aprovohet sa më shpejtë, sepse në një mënyrë kanë mbrojtje punëtorët për kërkesat e veta, mirëpo pa Ligjin e punës, është gabim të shqyrtohet ky Projektligj për grevat. Prandaj, e lusim Qeverinë që sa më shpejt ta bie në Kuvend Ligjin e punës që të shkoj më tutje Ligji për grevat. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputete! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, ftoj Qamile Morinën ta marrë fjalën.

QAMILE MORINA: Ju faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Deputetë të nderuar,

Lidhja Demokratike e Dardanisë, si edhe gjithë parafolësit tjerë konsideron se Projektligji për grevat, i sjellë në Kuvend para miratimit të Ligjit bazik të punës dhe të Ligjit për organizimin sindikal, si i tillë ky projektligj nuk mund ta arrijë zbatueshmërinë në mënyrë të drejtë dhe efikase. Qëllimi i Projektligjit për greva në esencë është krijimi i raporteve ligjore shumë të rëndësishme për punëtorët dhe punëdhënësit me qëllim të përfaqësimit dhe të mbrojtjes së interesave ekonomike, sociale dhe profesionale të punëtorëve nga puna dhe marrëdhënia e punës, andaj ky projektligj i referohet Ligjit të punës, Ligjit të organizimit sindikal dhe Kontratës kolektive, që fatkeqësisht ende nuk janë miratuar në Kuvend.

Lidhja Demokratike e Dardanisë ka potencuar edhe më parë në Kuvend, se nuk dëshiron të minimizojë rëndësinë cilitdo projektligj të sjellë në Kuvend për miratim, por konsideron se është shumë e rëndësishme t’u jepet përparësi projektligjeve me interes

të veçantë për qytetarët e vendit, si dhe interesit shtetëror, duke respektuar parimin e prioritetit të assesit të prioritetit të piramidës së përmbysur. Në këtë kontest, duhet theksuar se sjellja e ligjeve bazike, si Projektligji i punës, po përcillet me një histori të rëndë dhe kontradiktore, e më së pakti me arsyetime bindëse apo profesionale për mosmiratimin e tij gjer më tani.

Kur e them këtë, kam parasysh se ky Projektligj nuk arriti të miratohet në Kuvend gjatë këtyre tri legjislaturave. Së fundi, në vitin 2008, ky Projektligj është tërhequr nga Qeveria dhe arsyet që janë dhënë atëherë dhe tani nga ministria përkatëse, si pengesë e pakapërcyeshme për përkrahjen e këtij Projektligji, janë institucionet ndërkombëtare, si Banka Botërore dhe FMN me vërejtjet e tyre për implikimet e larta buxhetore. Edhe pse vlerat për implikimet buxhetore këto dy vite kanë qenë aq të ndryshme, që janë sjellë prej 60 milionë, 24 milionë dhe tani së fundi, e kemi vlerën prej 1.8 milionëve në vit, gjë që ngritë shumë dyshime për mungesë të një ekspertize të mirëfilltë të implikimit buxhetor për këtë ligj.

Një nga vërejtjet kryesore lidhur me këtë Projektligj, ka të bëjë me nenin 3, i cili decidivisht përcakton duke i numëruar organet shtetërore që nuk kanë të drejtë të mbajnë grevë dhe organet të cilat përcaktohen me dispozitë, janë Forca e Sigurisë së Kosovës, Policia e Kosovës, shërbimet e zjarrfikësve dhe shërbimet emergjente. Konsiderojmë se kjo nuk do të duhej të përcaktohet në këtë mënyrë, duke apostrofuar disa organe shtetërore, duke pasur parasysh që me projektligj e drejta në grevë nuk është absolute. Kështu, neni 16 dhe 17 në projektligj përcakton se e drejta në grevë mund të kufizohet për shërbimet esenciale, në rrethana të veçanta për të garantuar mbrojtjen e interesit publik, nacional apo shëndetin publik.

Në shumë shtete të BE-së, greva në mënyrë të posaçme rregullohet sipas të drejtës ndërkombëtare e jo me ligje të veçanta. Andaj, edhe pse i rëndësishëm Projektligji për greva, i cili përmban dispozita për organizimin e grevës, të drejtën në pjesëmarrje, udhëheqjen e grevës, si dhe ajo esenciale, kriteret për mbrojtjen e të drejtave të të punësuarve, si dhe punët të cilat nuk duhet të ndërpriten gjatë grevës, në mungesë të Ligjit të punës, të Ligjit të organizimit sindikal dhe të Kontratës kolektive, do të mbetet i mangët në zbatueshmërinë e tij dhe si të tillë nuk do ta mbështesim.

Lidhja Demokratike e Dardanisë konsideron se Qeveria dhe ministria përkatëse duhet të qasen me shumë seriozitet, përgjegjësi dhe qasje vendimmarrëse për hartimin e ligjeve bazike, të zbatueshme për vendin, si Ligji i punës, sidomos duke pasur parasysh që Kosova po hynë në vit tejet sfidues në aspektin e politikave dhe vendimmarrjeve në fushën e ekonomisë, që doemos do të kërkojë infrastrukturë ligjore për mbrojtjen e interesave të punëtorëve të vendit tonë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputete! Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputeti Xhezair Murati e ka fjalën.

DŽEZAIR MURATI: Hvala, predsedavajući!

Dozvolite da pozdravim i vas i ovo dvoje ministara što su nam preostali, kolege kojih je takođe mali broj ovde, što da ne konstatujem.

Mislim da i mi smo ozbiljno razmotrili Zakon o štrajku i zaista delim mišljenje prethodnih diskutanta da se radi o jednom solidnom predlogu Nacrta zakona o štrajku, međutim mislim da smo danas čuli i ministra za rad i socijalnu politiku, koji je bio optimista kada je u pitanju usvajanje Zakona o radu. To smo čuli danas da će biti, šta ja

znam, saglasnost do kraja ovog meseca, početkom idućeg i tako dalje. Mi smatramo da je ovde redosled obrnut, da treba da prvo usvojimo ono što je fundament, što je osnova na osnovu kojeg se može jedan štrajk organizovati, a to je Zakon o radu. Ja ću citirati ovde član 6. tačka 1.3, kaže: “ima za cilj da ostvaruje zahteve iz radnog odnosa prema Zakonu i Ugovoru o radu”. E sada, ako to nemamo, to vam je kao pravite kuću, a niste raščistili imovinsko-pravne odnose o placu a pravite kuću. Nešto tako mu dolazi ovo.

Mi, nažalost, smatramo da je obrnut redosled i ovog puta nećemo biti u mogućnosti da glasamo za ovaj zakon, jer treba da mu prethodi Zakon o radu. Evo toliko u ime naše grupe. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar SLS, nuk ka të lajmëruar. Tash u lajmërua, Petar Miletij e ka fjalën.

PETAR MILETIĆ: Obzirom da je ovaj zakon došao na osnovu člana 33. stav 2. Pravilnika o radu Vlade i da je prošao kroz sve faze postupka predviđene Pravilnikom o radu Vlade, mi ćemo podržati ovaj Nacrt zakona i nećemo uslovljavati da prethodno dođe u skupštinsku proceduru Zakon o radu, već ćemo podržati ovaj Nacrt zakona, jer je i ministar u današnjoj raspravi, dok je odgovarao na poslanička pitanja, rekao da će i Zakon o radu vrlo brzo doći u ovaj dom.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Për Grupin Parlamentar për Integrim, në emër të tij nuk ka të lajmëruar. Kalojmë te deputetët, sipas radhës. Fjalën e ka deputetja Donika Kadaj, përgatitet deputeti Riza Smaka.

DONIKA KADAJ – BUJUPI: Ju faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Në Ligjin për grevat, neni 1, thotë: “Ky ligj ka për qëllim garantimin e lirive dhe të drejtave lidhur me organizimin dhe pjesëmarrjen e të punësuarve në Kosovë në grevë sipas standardeve ndërkombëtare”. Ndërkaq, unë duhet të potencoj që sot, atë që e dimë të gjithë, Kosova është vend i vetëm në rajon, i cili ende nuk e ka ligjin themelor, Ligjin bazë të punës, e që në mungesë të tij, shumë punëtorë në Kosovë sot diskriminohen nga punëdhënësit.

Përveç kësaj, mungesa e Ligjit të punës është edhe në kundërshtim me të gjitha konventat ndërkombëtare. Sot në Kosovë nuk paguhet pushimi vjetor, nuk paguhet pushimi i lehonisë. Është një shqetësim i madh sepse kemi rënie drastike të natalitetit dhe është një kërkesë e grave të Kosovës që ky ligj sa më parë të jetë në Kuvendin e Kosovës, të aprovohet dhe të rregullohet pushimi i lehonisë, i cili me të vërtetë po shkakton probleme jashtëzakonisht të mëdha, sidomos te familjet e reja. Nuk paguhet pushimi mjekësor, përshkrimi i vendeve të punës, nuk respektohet pasi që në shumicën e rasteve nuk njihet institucioni i kontratës. Në deklaratën e fundit të kësaj Qeverie kemi pasur që më 31 mars të këtij viti do të kemi në Kuvendin e Kosovës Ligjin e punës. Çka ndodhë? Sot jemi me 15 prill dhe në rend dite na vjen Ligji për grevat.

Të nderuar, përkundër nevojës për këtë ligj, kjo është komplet e papranueshme. Unë ju ftoj, deputetë, pavarësisht a jemi nga pozita apo opozita dhe me theks të veçantë i ftoj koleget e mia deputete, që gjithë bashkë mos ta votojmë këtë ligj, ta kthejmë dhe ta kushtëzojmë me Ligjin e punës, sepse është prioritet për këtë shoqëri dhe është prioritet për qytetarët e Kosovës. Më duhet patjetër që të theksoj edhe atë që tha një nga kolegët e mi më herët, që në një shoqëri normale, kategoritë e caktuara nuk mund të hyjnë në

grevë, ndërkaq unë do ta mbylli diskutimin tim, që një qeveri normale nuk e sjell Ligjin e grevës para Ligjit të punës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputete! Fjalën e ka deputeti Riza Smaka, përgatitet deputetja Mimoza Ahmetaj.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryesues,

Ministra të nderuar,

Deputetë të respektuar,

Zonja Kada me vend e theksoi këtë rrethanë. Ligji për punën është parakusht për t'u miratuar, po e zëmë, Ligji për grevën. Kjo është *kondiktio sine kwanon*, nuk bën, ju lutem, të bëhet një ligj i cili e ka bazamentin në ligjin i cili nuk ekziston. Flas juridikisht, profesionalisht, sepse është fjala për akt ligjor, nuk është fjala për akt politik apo ndonjë referat e tjera. Kjo është kësisoj dhe kështu do të duhej të ishte dhe të bëhej.

Tash, disa vërejtje parimore. Neni 3, po të miratohej, do të ishte në kolizion me të drejtat themelore të njeriut, pa marrë parasysh se punon këtu apo aty, po e zëmë. Nëse është e drejtë edhe themelore, atëherë nuk mund t'i limitohet t'i restriktohet ajo e drejtë, apo jo. Edhe aq më parë, kur me nenin 17, neni 3 është përpunuar më mirë. Prandaj, kjo dispozitë do të duhej të binte. Ja, po e zëmë, një shembull që nuk mund të qëndronte, po e zëmë, një formulim i paqëndrueshëm. Neni 14: nëse i punësuar në kohën e grevës dëmton me qëllim pronën e punëdhënësit apo të personit të tretë, atëherë ai do të duhej të..., do me thënë, me qëllim kjo nuk është, se kurdoherë do të thoshte – jo me qëllim, a në juridikë ekzistojnë dy terma kruciale, relevante - veprimi kulpos edhe veprimi dolos. Dolos kur me qëllim thotë, me qëllim e kam bërë këtë dëm material, po e zëmë, ndërsa kulpos, kulpallata është pothuajse krejtësisht pak i dalluar nga qëllimi i dyllos dhe kurdoherë është i ndëshkueshëm. Prandaj, pa marrë parasysh – me qëllim a pa qëllim, aty janë nga tri gradacione – qëllimi dhe pa qëllimi, dolos malus, dolos metus e tjera, do të thotë do të duhej të përgjigjej, sepse ai apo ajo që do të bëjë grevë, që ka të drejtë, do të duhej për ta rimbursuar dëmin, për ta zhdëmtuar të dëmtuarin, pa marrë parasysh – e bëri me qëllim apo pa qëllim. Ky është parim juridik te përgjegjësia civile.

Më pastaj, te procedura e pajtimit, paragrafi 4. “marrëveshja e arritur në procedurën e pajtimit duhet të jetë në formën e e shkruar”. Do të duhej të shtohet se marrëveshje, po qe se do të bëhej, do të miratohej, do të ishte e plotfuqishme edhe e ekzekutueshme, se kjo është edhe në procedurën juridike-civile, juridike-administrative, juridike-penale dhe juridike-ekonomike. Është parim fundamental, që marrëveshja ndërmjet palëve në kontest, në konflikt është akt ekzekutiv. Prandaj, do të duhej të ishte asi soji.

Edhe përfundimisht, për postet tjera, po e zëmë, te dënimet me të holla, jo gjobat, do të duhej të precizohej që do të duhej të dënohej me të holla entiteti natyral, etniteti legal edhe përfaqësuesi ligjor i entitetit legal. Duhet bërë dallim, ku është në pyetje, po e zëmë, një institucion apo një organizatë që duhet të dënohet, po e zëmë, organizata në mënyrë që ta hetojnë, ta ndiejnë edhe ata/ato që e përjetojnë atë dënim dhe të ishte bazament për të ndërmarrë masa, po e zëmë, kundër personit legal, përfaqësuesit ligjor, do me thënë drejtorit, menaxherit apo administratorit apo presidentit, si quhet, e kësi soji. Do të thotë, kjo do të duhej të bëhej medoemos.

Unë, kësisoj, nga parimi do të isha angazhuar që mos ta miratojmë këtë dokument, sepse duhet fillimisht të miratohet Ligji për punën. Pa Ligjin për punën, ju lutem, si

mund të krijohet marrëdhënia e punës. Ne e dimë fare mirë sa dëmtohen, sa nëpërkëmbën të punësuarit sot. Më së pari, nuk ua japin fare kontrata, më pastaj edhe për vendet e punës, të cilat janë të përhershme, kontratat në shumicën e rasteve bëhen në kohë të caktuar dhe krijohet një psikozë të punësuarit. Ajo psikozë ndikon që ata të bëhen servil dhe ta cenojnë edhe dinjitetin e vet elementar. Kjo është çështje kruciale, nuk është çështje, si të them kështu, juridike, formale që dikujt po i teket – jo nuk ka ligj për punë, nuk e votojmë këtë. Kjo është çështje edhe politike, ju lutem, edhe ekonomike e sociale. Prandaj, nuk do të ishte zgjidhje e mirë që ta bëjmë një ligj, i cili mbështet në një ligj që nuk ekziston. Ju faleminderit, zotëri kryesues!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputetja Mimoza Ahmetaj, përgatitet deputetja Kaqusha Jashari.

MIMOZA AHMETAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për ministren dhe ministrin dhe për të gjithë deputetët!

Unë, që në fillim po them se parimisht e përkrah këtë projektligj, është diçka e domosdoshme që i nevojitet infrastrukturës ligjore që Kosova deri me tash nuk e ka pasur. Mendoj se ne kemi kaluar ligje edhe të tjera, të cilat ndoshta nuk i kanë pas ligjet bazë dhe jo vetëm kjo Qeveri, por edhe qeveritë e kaluara e kanë kaluar Ligjin, për shembull, për inspektoratin e punës, i cili kryekëput dhe drejtpërdrejtë lidhet me Ligjin bazë të punës dhe asnjëherë nuk është diskutuar nga deputetët e legjislaturës së kaluar që një ligj i tillë nuk duhet të kalojë për mungesë të Ligjit bazë të punës.

Qeveria e kaluar e ka kaluar Ligjin për shëndetësinë, pa e pasur fare ligjin, për shembull, për sigurimet shëndetësore, që është ligji bazë me të cilin lidhet drejtpërdrejt Ligji për shëndetësinë, apo Ligjin për praksën private për shëndetësi, që po ashtu e ka lidhjen direkte me Ligjin për sigurime shëndetësore dhe asnjëherë nuk e kemi pasur dhe asnjëherë nuk është diskutuar mungesa e ligjeve të tilla, kanë kaluar dhe sot, edhe më tutje funksionojnë ligjet e tilla. Nuk është e vërtetë se nuk paguhet pushimi vjetor. Do ta pyesja zonjën deputete, që më herët e përmendi, në gusht kur nuk vjen në seanca dhe Kuvendi është në pushim vjetër, a merr rrogë apo nuk merr për muajin gusht. Nuk është e vërtetë se nuk paguhet pushimi i lehonisë, pushimi i lehonisë paguhet 3 + 3, paguhet 100% tre muaj dhe paguhet 70% tre muajt e tjerë. Ne kemi insistuar dhe vazhdojmë të insistojmë që me Ligjin të cilin do ta krijojmë si për punën, si për sigurimet shëndetësore, që pushimi i lehonisë të zgjatet deri në 9 muaj dhe unë plotësisht pajtohem me të gjitha ato gra dhe jam edhe vetë njëra nga ato përkrahëse të kësaj forme që të jetë 9 muaj pushimi i lehonisë dhe të jetë tërësisht i paguar. Do me thënë, këtu është qëllimi. Ne e kemi një rregullore të punës, me të cilën rregullohet marrëdhënia e punëtorëve dhe punëdhënësve dhe paguhet kjo çështja e pushimit të lehonisë, prandaj dëshiroj që jo në emër të grave të manipulohet dhe të sillen në emër të promovimit apo të përkrahjes të të gjitha grave, të sillen manipulime dhe të pavërteta në Kuvend.

Parimisht e përkrah Ligjin dhe besoj se është shumë i domosdoshëm. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Replikë, deputetja Donika Kadaç e ka fjalën, 2 minuta.

DONIKA KADAJ - BUJUPI: Ju faleminderit!

Unë me të vërtetë u befasova me reagimin. Ajo çka unë kërkoj, është ajo çka kërkojnë gratë e Kosovës, që fëmijët e tyre të kanë mundësi të rriten me nëna dhe kjo t'ju paguhet, do të thotë, pushimi i lehonisë. Po më vjen keq që një deputete nuk po e dika që është

problem pushimi i lehonisë, që vjen si mungesë e Ligjit të punës dhe nuk po i dika amendamentet që i kemi bërë në Ligjin e punës, si deputete.

E dyta, e nderuar, ndoshta ju paguheni për seanca kur nuk jeni këtu, por njerëzit dhe punëtorët të cilët punojnë në sektorin privat, absolutisht nuk kanë të drejta të tyre, të drejtat që ju garantohen me konventa ndërkombëtare. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Kundër replikë, deputetja Mimoza Ahmetaj, 1 minutë e ka fjalën.

MIMOZA AHMETAJ: Atëherë, nuk është çështje e grave, zoti Hyseni, është çështje dhe nuk jemi rrokë, por po bisedojmë për çështje në parim. Edhe një herë po e them, unë tash po e pyes zonjën – gjatë gushtit, kur Kuvendi nuk punon, e merr apo nuk e merr rrogën në shtator. Edhe të gjitha gratë të cilat punojnë në institucionet publike, e kanë të drejtën e pushimit vjetor dhe paguhen, edhe të pushimit të lehonisë po ashtu paguhen. Çështja, kërkesa e të gjitha grave është që, në parim, pushimi i lehonisë të shtyhet në 9 muaj, për çka tërësisht pajtohem. Pajtohen të gjithë, gra dhe burra. Edhe në institucionet publike, edhe në ato private, e drejta e pushimit vjetor është e garantuar po aq sa edhe e drejta e pushimit të lehonisë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputete! Përfundon me kaq për këtë çështje, nuk ka më, të lutem, me Rregullore të Punës. Deputetja Kaqusha Jashari e ka fjalën, përgatitet deputeti Emrush Xhemajli.

KAQUSHA JASHARI: I nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në qoftë se e shikojmë vetëm përbërjen e ligjit të propozuar, Projektligjin për greva, është e rregulluar në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe është paraparë rregullimi një prej të drejtave të punëtorëve për ta protestuar, për ta kërkuar përmes grevave realizimin e të drejtave të tyre nga marrëdhënia e punës, nga kontratat e punës. Gjithashtu, është paraparë edhe mënyra e organizimit të grevës, udhëheqja e grevës, kush mund të përfaqësojë interesat e punëtorëve dhe të drejtat tjera, e gjithashtu është rregulluar edhe mbrojtja e jetës dhe shëndeti i njerëzve, siguria e tyre, siguria e pasurisë, por gjithashtu një pjesë e kemi të rregulluar ku grevat nuk lejohen të mbahen për shkak të resorëve të cilat duhet të punojnë.

Në arsyetimin për këtë projektligj thuhet se po plotësohet infrastruktura ligjore për grevat dhe Ligji është në pajtim me legjislacionin e Bashkësisë Evropiane dhe është në pajtim me konventat ndërkombëtare të punës, jo vetëm në pajtim, por është edhe obligim edhe nga ky aspekt i shikimit të ligjit mendoj se duhet të rregullohet kjo e drejtë dhe unë ligjin nga ky aspekt e përkrah. Por, nëse e shikojmë anën tjetër, është përmendur edhe nga diskutimet tjera se cila është arsyeja e mbajtjes të grevës, pse punëtorët do të protestojnë, kryesisht është kërkesa e tyre nga punëdhënësi për t'i plotësuar kushtet e parapara nga Kontrata e punës. Por, cila është baza për një kontratë të punës? Baza për kontratën e punës është kontrata kolektive, baza për kontratën kolektive është Ligji i punës, prandaj edhe me aprovimin e këtij ligji, janë do pengesa serioze për zbatimin e tij.

Jemi dëshmitarë të keqpërdorimit dhe shfrytëzimit të punëtorëve, duke filluar prej orarit të punës, mos pagesës së punës jashtë orarit, për nivelin e pagës, të pushimeve, a janë, a nuk janë dhe sa janë, prandaj ka shumë padrejtësi ndaj tyre. Në qoftë se e rregullojmë

vetëm këtë segment të drejtës për greva, e jo edhe pjesën tjetër ku bazohet kontrata e punës, do me thënë pa Ligjin e punës, unë mendoj se ne e bëjmë edhe një padrejtësi shtesë ndaj tyre. Prandaj, unë e kam një propozim konkret, që ky projektligj qysh ka hyrë në procedurë, të vazhdojë. Unë do të votoj për këtë propozim, por po presë të mbajë fjalën ministri i Punës, sot që tha shumë shpejt do të vjen edhe Ligji i punës, edhe ai të procedohet dhe duhet të bashkëngjitet edhe Ligji për organizimin sindikal. Në qoftë se ky Ligj i punës nuk hynë në procedurë edhe nuk diskutohet për te, unë në leximin e dytë nuk do ta votoj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputeti Emrush Xhemajli e ka fjalën, përgatitet deputetja Sanije Alijaj.

EMRUSH XHEMAJLI: Ju faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar ministër,

E nderuara ministre,

Kolegë deputetë dhe të pranishëm,

Është i mirëseardhur Ligji për grevat, edhe pse ende nuk është proceduar Ligji i punës, si ligj bazik, si dhe Ligji për sindikatat, pa të cilët ky ligj është i pazbatueshëm, por është mirë që po e shqyrtojmë dhe po e lëmë gati për të ardhmen.

Partia Socialiste që e përfaqësoj, mbështet në parim këtë ligj, ndërsa kemi vërejtje konkrete, parimore në te. Deri në fund, ky ligj është shumë i mirë, por ai do të jetë i pazbatueshëm nëse nuk rriten sanksionet, gjohet për ata që nuk i zbatojnë ato pjesë që duhet të zbatohen. Është plotësisht me standarde ndërkombëtare neni 11 – e drejta e grevës, paragrafi 2, ku mirë thuhet se, po e citoj: “I punësuari nuk mund të jetë i diskriminuar për shkak të organizimit dhe pjesëmarrjes në grevë”, si dhe neni 13, pika 6, ku përcaktohet që gjatë grevës, punëdhënësit nuk mund të punësojnë punëtorë të rinj, të cilët do t’i zëvendësonin këta pjesëmarrësit e grevës. Por, të drejtën e grevës, pjesëmarrjes, garantimin e vendit të punës gjatë kohës së grevës dhe kufizimin për të marrë punëtorë tjerë në kohë greve, punëdhënësi i shkelë sa herë të dojë me gjohet nominale që janë dhënë këtu 500 deri 5000 euro. Prandaj, unë propozoj që gjohet me të vërtetë të jenë gjoha serioze për punëdhënësit. Përndryshe, cili nga punëdhënësit e sotëm nuk do të lejonte punëtorët të bëjnë grevë në pajtim me këtë ligj, cili nga ata nuk do t’i zëvendësonte punëtorët grevistë me punëtorë tjerë. Kjo, e para.

Po ritheksoj, te neni 8, pika 6, në të thuhet se në rastet kur greva del jashtë kontrollit, Këshilli i grevistëve detyrohet t’i lajmërojë organet kompetente të rendit. Mirë, mirëpo më mirë edhe më saktë, për mendimin tim do të ishte, sikur të thuhet: kur greva merr formë të dhunshme, se këtu është fjala për prishje të rendit, Këshilli grevist i lajmëron organet kompetente të rendit. Duhet zëvendësuar kështu, sepse siç është thënë, shprehja jashtë kontrollit, është shprehje shumë e gjerë, gjendja mund të jetë jashtë kontrollit, ta zëmë, të këshillit grevistë edhe për arsye jashtë sigurie, bie fjala për shkak se ia prishin ndonjë diçka këshilli grevist, këta grevistët që i kanë thirr në grevë, ose kërkojnë zvogëlimin e kërkesave ose zgjerimin e kërkesave si grevistë. Edhe kjo është dalje jashtë kontrollit, nga koncepti i këshillit grevist. Mirëpo, edhe pse kjo mund të mos i pëlqejë këshillit grevist, kjo nuk mund të quhet si rrezik për rendin dhe të thirren organet e rendit. Prandaj, mendoj se këtu duhet ndërruar kjo pjesë.

Gjithashtu, neni 9, duhet lënë në pajtim më të plotë me praktikat ndërkombëtare, sepse një pjesë e grevave në botë, ndodhin edhe në kohën e ndryshimeve dhe të mos ndryshimeve të ligjeve që kanë të bëjnë me të drejtat dhe statusin e punëtorëve dhe këto

zakonisht bëhen edhe para institucioneve, që në fakt ky projektligj nuk i përmend, bile në njëfarë forme edhe e kufizon.

Sidoqoftë, Ligjin ju thërras ta votojmë për shkak të nevojës së madhe që ka Kosova për te, përkatësisht punonjësit, por edhe punëdhënësit. Sot në shumicën e ndërmarrjeve private, sidomos në ato më të mëdhatë, shkelen të drejtat e grevës, të drejtat e punëtorëve, siç u tha edhe këtu, trajtohen me një fjalë sikur të jenë robër, e kam fjalën për sektorin privat. Kjo bile nuk diskutohet fare. Rrogat ju vonohen nga 2-3 muaj, diku edhe më tepër. Nëse ndonjëri e kërkon rrogën, ai është i rrezikuar që të largohet të nesërmen ose pas një kohe i thonë – mos hajde në punë se më nuk na vyen, e kështu me radhë. Pavarësisht, thashë, sikurse e cekën edhe disa deputetë, që nuk i kemi ligjet bazike, duhet të dihet, te ne jo një herë, ligjet ndërtohen në mënyrë induktive, nuk shkohet prej ligjeve bazike kah këto që varen prej tyre, por shpeshherë ndodhë e kundërta. Sikur montimin e avionëve, i ndreqet një pjesë këtu, një pjesë atje dhe në fund montohen. Kjo praktikë është ndjekur te ne, nuk është ndoshta e rregullt, por meqë nuk është për herë të parë duke u ndjekur kështu, ju kisha thirr që këtë ligj shumë të rëndësishëm ta procedojmë, ta votojmë edhe gjatë procedimit, pastaj, bëhen ndryshimet e nevojshme. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet! Deputetja Sanije Aliaj e ka fjalën, përgatitet deputeti Naser Rugova.

SANIJE ALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të respektuar kolegë deputetë,

Deri më tani, organizimi i grevave në Republikën e Kosovës është bërë pa bazë ligjore. Prandaj, Ligji për sindikatat, që rregullon të drejtën e organizimit sindikal, si dhe sot Projektligji për grevat, që synon të rregullojë të drejtat e të punësuarve për organizimin, mbajtjen dhe pjesëmarrjen në greva të ligjshme, plotësojnë infrastrukturën ligjore në këtë fushë. Por, me këtë rast do të shtroja dilemën – si do të organizojnë sindikatat përmes këshillit grevistë të punësuarit për realizimin e të drejtave të tyre ekonomike e sociale, kur të drejtat në punë nuk janë të rregulluara ende me ligjin bazik – Ligjin e punës. Me asgjë më nuk arsyetohet prolongimi i Ligjit të punës në Kuvendin e Kosovës. Por, edhe për kundër kësaj, unë do të jap disa vlerësime lidhur me Projektligjin që sot po e shqyrtojmë.

Projektligji për grevat propozoj që do të ishte mirë të emërtohet Projektligji për grevat e ligjshme, sepse Organizata Ndërkombëtare e Punës parasheh edhe lloje të tjera të grevave për realizimin e të drejtave të punëtorëve. Unë konsideroj se për deputetët janë të njohura edhe llojet tjera të grevave. Prandaj, ky projektligj asnjë dispozitë nuk parasheh se si janë përgjegjësitë e punëdhënësit dhe të të punësuarve me rastin e organizimit të llojeve tjera të grevës.

Me këtë projektligj rregullohen dhe përcaktohen të drejtat e të punësuarve në grevë, si dhe të drejtat dhe detyrimet e të punësuarve dhe të punëdhënësit gjatë mbajtjes së grevës. Pra, ka për qëllim të realizojë kërkesat nga marrëdhënia e punës sipas ligjit dhe kontratës së punës. Njëherësh, projektligji në nenin 3 përcakton që disa institucioneve vitale të Republikës së Kosovës iu mohohet e drejta e organizimit të grevës.

Neni 7 i projektligjit rregullon arsyet e mbajtjes së grevës, që janë të renditura shumë mirë, por që të zvogëlohen arsyet e organizimit të grevës konsideroj se Qeveria dhe

monitoruesit e zbatimit të ligjit, pra inspektorët e punës të bëjnë kontrollin e ndërmarrjeve se sa ofrojnë punëdhënësit kushte të punës me standarde bashkëkohore në punë, sa respektohet profesionalizmi i të punësuarve dhe sa bëhet vlerësimi i punës së tyre në mënyrë që të ndalet hovi i të rinjve tanë që largohen nga Kosova.

Me nenin 10 të projektligjit – Mënyra e organizimit të grevës, parashihen tri mënyra të organizimit. Në paragrafin 1.3 të këtij projektligji, grevat realizohen edhe përmes mungesës së të punësuarve nga puna. Konsideroj se greva është reagim ndaj mosrespektimit të të drejtave në punë, e si të kundërshtojë punëdhënësin punëtori duke qëndruar në shtëpi. Propozoj që ky nen të hiqet nga projektligji.

Në nenin 13 të projektligjit – Mbrojtja e të drejtave të punësuarit gjatë grevës, paragrafi 2 i mohon të punësuarit të drejtën e pagës sa të qëndrojnë në grevë. Greva është e garantuar me të drejtat ndërkombëtare nga Organizata Ndërkombëtare e Punës. Pra, konsideroj se është shkelje e të drejtës së punës, se grevat janë të lejuara nga Organizata Ndërkombëtare e Punës dhe me shumë konventa tjera, sepse është kërkesë për punë të dinjitetshme të punëtorëve, si dhe është në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 19, që gjatë zhvillimit të grevës pezullohen detyrimet që rrjedhin nga kontrata e punës.

Neni 25 rregullon masat ndëshkuese për kundërvajtje ndaj punëdhënësit. Mendoj se neni duhet shtuar edhe disa paragrafe, që e obligojnë punëdhënësin në përmirësimin e kushteve të punës për të punësuarit me standarde ndërkombëtare.

Në memorandumin shpjegues jepen këto arsyeime që projektligji të kalojë në leximin e parë, ndër të tjera se nuk ka implikime buxhetore, se është në pajtim me aktet dhe të drejtën ndërkombëtare. Edhe përkundër asaj që BE-ja ende nuk e ka rrumbullakuar legjislacionin e saj, ekziston karta e të drejtave fundamentale e BE-së që parasheh të drejtën në grevë, por unë propozoj se do të ishte mirë që ky projektligj të begatohet dhe të përmirësohet në mënyrë që e drejta në grevë vërtet të rregullohet me ligj, ashtu siç iu ka hije institucioneve të Kosovës.

Prandaj, do të ishte mirë që ky projektligj t'i kthehet Qeverisë dhe të bëhet edhe më i mirë dhe më i përsosur. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Deputeti Naser Rugova e ka fjalën, le të përgatitet deputeti Shkumbin Demaliaj.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Zoti ministër,

Po diskutojmë për një ligj jashtëzakonisht të rëndësishëm që ka për qëllim garantimin e lirive dhe të drejtave lidhur me organizimin dhe pjesëmarrjen e të punësuarve në Kosovë në grevë, sipas standardeve ndërkombëtare.

Së pari, nuk është korrekte të bëhen krahasime me standardet ndërkombëtare, me të drejtat e punëtorëve sipas organizimeve të tyre nëpër organizatat sindikaliste botërore, sepse në Kosovë nuk e kemi infrastrukturën ligjore organike apo bazike, nën një.

Nën dy, e potencova edhe në një diskutimet për një projektligj më herët, gjithashtu të rëndësishëm, kur komisioni funksional nuk e jep miratimin e vet, qoftë edhe formal, atëherë shpesh vërtet, a ka nevojë për rekomandimet dhe mendimin e trupave të veta

funkSIONALE, si Kuvend i Republikës së Kosovës, apo komisionet funksionale nuk janë kah e bëjnë në mënyrë cilësore punën e tyre, që janë të thirrura sipas Kushtetutës, ligjit dhe Rregullores së Punës së Kuvendit. Ky Kuvend sot ka rënë dy herë në provim edhe me këtë projektligj. Vallë, institucionet apo mekanizmat, trupat punuese funksionale të Kuvendit formalisht po mbledhen dhe nuk po i analizojnë ligjet, që sipas Kushtetutës jemi ligjvënës dhe hartojmë ligje dhe procedojmë ligje për miratim në Kuvend, apo vërtet është interes i ekzekutivit që pa marrë parasysh çka thonë trupat funksionale, komisionet funksionale të Kuvendit, të kalojnë ligjet.

Emëruesi i përbashkët i këtyre, fatkeqësisht, është moszbatimi i këtyre ligjeve, interferimi i ligjeve në mes veti, tani pa Ligjin për punën. Ky është një ligj mirë i strukturuar, diku rreth 80% përfshin kërkesat imediate, ka edhe zbrazëtira, ka edhe paragrafe dhe nene të artikuluar jo si duhet, ka nga një herë edhe interferime dhe diskrepanca.

Pastaj, tek institucionet e rëndësishme, që kanë një rëndësi të veçantë, si FSK-ja, Mjekësia emergjente, Policia, zjarrfikësit e të tjera, ata njerëz kanë të drejtë t'i shprehin brengat e veta, pakënaqësitë e veta në raport me punën e tyre dhe me punëdhënësit, gjithnjë pa u rrezikuar siguria e qytetarëve, siguria nacionale, por me një masë kritike të domosdoshme, sepse s'kemi të drejtë që 4 shtyllave kryesore të shtetit dhe punonjësve të atyre shtyllave t'ua mohojnë të drejtën për grevë. Këtu duhet të kemi kujdes, kjo është tejet centraliste.

Andaj, duke e parë që nuk po respektohen mendimet e komisioneve funksionale, nuk është Ligji bazik i punës, nuk kemi kontratë kolektive e cila nuk po respektohet me vite të tëra, këtu është faj i sponzorizuesit. Pse? Këtu ka qenë dashur të vijë një pako e ligjeve që e rregullojnë aspektin social. Ne po hymë tani në vitin më sfidues, kur kanë për t'u privatizuar tri ndërmarrjet më të mëdha publike. Do të ketë largim të njerëzve prej pune, sepse investitori i ri ka për të riformatizuar dhe sistemuar dhe ka për të sjellë një frymë të re menaxheriale. Dihet që janë stërmbytur me konkurs e pa konkurs ato ndërmarrje shoqërore dhe njerëzit do të largohen, do t'i largojnë nga puna. Kush i mbron, me çfarë ligji apo vet ... shteti i Kosovës dhe ky Parlament mbi ata njerëz. Fatkeqësisht, me këtë rrjedhë të punimeve të Kuvendit, me këtë procedim të ligjeve, kur vjen një ligj që vërtet është i nevojshëm, po nuk e ka ligjin organik, që i rri mbrapa dhe e fuqizon që të implementohet në praktikë, atëherë çfarë legjislacioni po hartojmë dhe pse po ndodh kjo.

Unë do të propozoja që ky ligj të kthehet mbrapa, edhe pse nuk është ligj i punuar dobët, është një ligj solid, i strukturuar mirë dhe të vijë në pako me ligjet e tjera të pakos sociale, konkretisht me Ligjin e punës. Do i kaloni për një seancë, sepse kur është rëndësi e veçantë për një fokus grup më të madhin të shoqërisë, në këtë rast punonjësit, po edhe punëdhënësit që e mbajnë gjallë jetën dhe veprimtaritë shoqërore dhe institucionale në Kosovë, atëherë ky Parlament duhet të këndellet pak edhe ta kryej punën e vet. Në parim do të kisha sugjeruar që të vijnë në pako, le të shtyhet për një muaj ose dy, se edhe ashtu pa Ligjin për punën nuk do të gjejë zbatim. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Fjalën e ka deputeti, Shkumbin Demaliaj, le të përgatitet deputetja Nerxhivane Dauti.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar ministër Yagcilar,

Kolegë deputetë,

Sot po flasim për Projektligjin për greva. Qëndrimi i Grupit tonë Parlamentar është se do të votojmë kundër për shkak të kërkesës së ligjshme se nuk ekziston ligj bazik, ku ky ligj duhet të mbështetet në një dispozitë për vetë ardhjen e tij në Kuvendin e Kosovës, prej kah buron. Është qenësore t'i kthehet ky ligj sponzoruesit, në këtë rast, Qeverisë së Kosovës. Arsyeja se pse sot nuk kemi Ligj për punë, është pikërisht ajo që e thanë kolegët opozitarë, në këtë rast, po pati edhe nga pozita, që i përshëndes, sepse po e njohin mirë strukturën e sistemit legjislativ dhe të mos kemi pengesa për përhapjen e këtij sistemi më tutje.

Kosova sot ka një rregullore të UNMIK-ut për Ligjin e punës 2001/27. Është një prej rregulloreve më të mira të mundshme që ka hartuar OKB-ja ndonjëherë për Kosovën, në këtë rast, jo UNMIK-u po prej OKB-së ka ardhur, do me thënë në vitin 2001, ende pa u ndërtuar Qeveria e Kosovës, për Ligjin e punës në Kosovë. Në këtë rast, gjithë ai ligj është duke u zbatuar, përpos masave ndëshkuese, sepse me nenin 25 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/27, masat ndëshkuese janë të ndaluara pa një urdhëresë të lëshuar nga administratori i UNMIK-ut, sepse ajo rregullore posa të bëhej ligj dhe të hiqej ajo pengesë, ne do të kishim pasur një mbrojtje shumë më të mirë të të punësuarve në Kosovë nga Inspektorati i Punës. E tha kolegja deputete, Mimoza Ahmetaj, që nuk pati kohë të rrijë më shumë, tha se ne kemi nxjerrë ligj për Inspektoratin e Punës, pa pasur Ligjin për punë. Nuk është e vërtetë. Ligji për Inspektoratin e Punës është bazuar në Rregulloren e Punës së UNMIK-ut, sepse ky Kuvend nuk mund të bie në ndikimin e dikujt pa pasur një bazë dhe të vazhdojë të nxjerrë ligje pa ligje bazike.

Ligji i Inspektoratit të Punës edhe në këtë Kuvend, pas shpalljes së pavarësisë, është plotësuar dhe ndryshuar edhe njëherë. Mirëpo, Qeveria e Kosovës dhe vetë ky Kuvend e ka nxjerrë Ligjin për siguri në punë 2003/19, ku neni 5, pika 5.1 thotë se duhet të themelohet Këshilli Nacional i Sigurisë në Punë nga Qeveria e Kosovës, ku bëjnë pjesë njerëzit e Qeverisë, punëdhënësit, përfaqësuesit e punëdhënësve dhe punëmarrësve, por sot nuk i ka interesuar gjendja e të punësuarve në Kosovë.

U fol shumë për marrëveshjen kolektive. Kosova ka pasur një marrëveshje kolektive, që i ka dalë mandati në shtator të vitit 2007. Ka qenë e nënshkruar, po ka qenë i nënshkruar gabimisht, sepse e kanë qitur Qeverinë para aktit të kryer në atë periudhë, ka qenë një bombë e kurdisur, sepse institucionet nuk guxojnë të përzihen në vullnetin e sindikalistëve dhe të punëdhënësve të resorit publik, në këtë rast, që janë resori privat. Asaj marrëveshje i ka dalë afati dhe Qeveria, përfaqësuesit e punëdhënësve dhe të punëmarrësve, në këtë rast, asnjëherë më nuk kanë parë të arsyeshme të vrapojnë pas një kontrate kolektive, që i mbron të drejtat e punëtorëve në këtë rast.

Organizimi sindikal, sot në Kosovë kemi mbi 13 organizime, duke përfshirë edhe shërbimin civil, shihet që është i ndikuar shumë nga politika. Ne në Komisionin për Siguri dhe Punë të Brendshme kemi pasur rastin kur na vjen një njoftim nga ministri i Punëve të Brendshme, që tani ka shkuar, thotë – iu kam drejtuar drejtorit të përgjithshëm të Policisë që të shkojë në Sindikatën e Policisë edhe t'ju thotë se Kryesisë së Sindikatës i ka dalë afati dhe ata duhet ta mbajnë Kuvendin. Do të thotë, elementi i kontrollit të brendshëm edhe brenda sindikatës, ky dokument ekziston edhe në Komisionin për Siguri, është njoftim nga ministri i Punëve të Brendshme. Kështu, kur flasim për ligjet bazike, ne kemi 70 mijë punëtorë të administratës në Kosovë, flasim se nuk kemi pasur ligj. Në qoftë se Rregullorja për Shërbimin Civil e UNMIK-ut nuk është në fuqi, atëherë të gjithë të punësuarit janë të jashtëligjshëm në administratën shtetërore. Në qoftë se sot, më vonë kemi një pikë që e kemi Projektligjin për Mërgatën, Qeveria e Kosovës e ka shuar një

institucion që është Shërbimi Qendror i Punësimit, po aty duhet të jenë të regjistruar gjithë punëtorët tanë që punojnë në botën e jashtme dhe ata sot nuk i paguajnë asnjë taksë Kosovës, nuk ia paguajnë atë taksë, po atë taksë deri tash e ka përfituar Qeveria e Serbisë. Është taksa themelore për lidhjen e marrëdhënies së punësimit për nënshtetasin e huaj në vendet perëndimore, që Kosova i ka, ne e kemi këtë ligj në Kosovë, e kemi nxjerrë në vitin e kaluar, por ende nuk mbikëqyret dhe nuk sanksionohen nënshtetasit e huaj që punojnë në Kosovë. Kemi me dhjetëra, mijëra qytetarë që vinë nga shtetet e huaja dhe ne nuk i kemi futur asnjëherë masat ndëshkimore, në këtë rast, sepse neni 25 i Rregullores mbi Ligjin e punës e ndalon. Kjo është fatkeqësia edhe e vet komisioneve mbikëqyrëse të ligjeve, që i kemi në Kuvendin e Kosovës, se e drejta e nënshkrimit i ka kaluar presidentit të Kosovës dhe kanë mund ta nxjerrin këtë urdhëresë dhe të hiqet ajo dispozitë dhe të lejohet, t'i ketë duart e lira Inspektorati i Punës dhe ta kryej punën e vet, sepse me nxjerrjen e Ligjit të punës së Kosovës vetëm kanë për t'iu rritur të ardhurat, arka e shtetit do të mbushet.

U fol për pushimin e lehonisë. Nga kjo përfitojnë vetëm administrata civile, do të thotë nëpunësit civilë, në resorin publik kjo nuk zbatohet. Me rastin që merr vesh se e punësuar është shtatzënë, e largojnë nga puna, nuk i paguajnë kontributet edhe keqpërdoren pozitat, kryesisht është diskriminim shumë i madh ndaj gjinisë femërore në resorin publik apo privat, si mund ta themi tani.

Desha të them edhe diçka. Kur thuhet se ne kemi shkelë dispozitat dhe kemi nxjerrë një ligj pa ligj bazik, sot Qeveria e Kosovës nuk e ka ligjin e vet, punon me Rregullore të UNMIK-ut. Ne të gjithë qytetarëve u kemi thënë, edhe vetë Kuvendi u ka thënë qytetarëve të vet se UNMIK më nuk ka në Kosovë, atëherë duhet të dimë a është ende Zanieri përgjegjësi kryesor që administron Kosovën apo është kjo Qeveri, Presidenca apo institucionet e këtij vendi. Faleminderit, shumë! Nuk do ta votoj projektligjin.

KRYESUESI: Faleminderit, deputet!

Fjalën e ka deputetja Nerxhivane Dauti, le të përgatitet deputeti Bahri Hyseni.

NERXHIVANE DAUTI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari zoti ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Njëra ndër format e deklarimit dhe të prezantimit të kërkesave për mbrojtjen e interesave sociale dhe ekonomike të punëtorëve është edhe organizimi i grevave nga punëtorët. Greva është mjeti më energjik të cilin punëtorët e përdorin me qëllim të realizimit të interesave të tyre. E drejta në grevë konsiderohet si një e drejtë legale vetëm në qoftë se është e organizuar nga sindikata. Greva konsiderohet se është një nga mjetet më të rëndësishme të presionit të punëtorëve, respektivisht organizatave sindikale kundër punëdhënësit dhe, si e tillë, ajo paraqet formë të organizuar të ndërprerjes së punës. Kjo formë e parashtrimit dhe prezantimit të kërkesave për realizimin e të drejtave nga marrëdhënia e punës nuk ka qenë e rregulluar me anë të ligjit të veçantë. Qëllimi i projektligjit të propozuar është krijimi i i raporteve ligjore shumë të rëndësishme për punëtorët dhe punëdhënësin.

Arsyeja e hartimit të këtij projektligji është krijimi i infrastrukturës ligjore për grevat në pajtim me konventat ndërkombëtare të punës dhe me legjislacionin e BE-së.

Projektligji për grevat adreson një varg çështjesh të rëndësishme nga fusha e të drejtave të punëtorëve për organizimin e grevës së ligjshme. Ligji i propozuar në mënyrë efikase

rregullon fushën e mbrojtjes së të drejtës së punës, rregullimin e drejtpërdrejtë të marrëdhënieve të punës në mes të punëdhënësit dhe punëmarrësit, dialogun paqësor në mes të dy akterëve, shfrytëzimin e të gjitha procedurave të pajtimit të parapara me Ligjin për greva sipas Konventës Ndërkombëtare të Punës.

Projektligji i propozuar ka arritur që në mënyrë gjithëpërfshirëse të rregullojë tri lloje themelore të grevave, si grevën të punëdhënësit, grevat sipas veprimtarisë dhe grevën e përgjithshme. Marrë në përgjegjësi, ligji përmban një teknikë juridike të mirë dhe një gjuhë të qartë juridike.

Duke marrë parasysh rëndësinë e veçantë që ka Ligji për grevat, e mbështes projektligjin e propozuar në shqyrtim të parë, ndërsa kontributin tim profesional do ta paraqes në komisionin funksional. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni, le të përgatitet deputeti Fatmir Rexhepi.

BAHRI HYSENI: Faleminderit shumë, zoti kryesues!

Përshëndetje, zoti ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Nuk e pata ndërmend fare të diskutoj, mirëpo arsyeja pse duhet diskutuar, po më duket që kushtëzimet që po i bëjmë, janë të panatyrshme për Kuvendin e Kosovës. Bile, po i interpretojmë edhe pak më ndryshe. Nuk është Ligji i punës bazë për Ligjin e grevave, nuk është ligj bazik, absolutisht nuk ka të bëjë, nëse e merrni dhe e lexoni dhe nëse lexohet nga qëllimi dhe deri në nenin 28, kurrë nuk ka të bëjë me të drejtat themelore të marrëdhënieve të punës.

(Ndërhyrje)

Të lutem, më dëgjo! Është e natyrshme dhe është e domosdoshme ta kemi Ligjin e punës, është diçka e domosdoshme Ligji i punës dhe të gjithë deputetët duhet të bëjmë tryzni që ta kemi Ligjin e punës, por ta kushtëzojmë një ligj që, po më vjen mirë grupi punues që ka qenë, deri tash nuk ka pasur ligj më të mirë që ka ardhur në Kuvendin e Kosovës, i hartuar mirë, plotësisht me standarde, me teknikë të përsosur juridike dhe ta kushtëzojmë tash me Ligjin e punës, nuk po e kuptoj.

Sot në Kosovë 73.000 shërbyes civilë punojnë, punojnë edhe nga 200.000 apo 300.000 të cilët kanë kontrata. A i respektojnë a nuk i respektojnë, është çështje tjetër. Por, sot mos ta rregullojmë çështjen e grevave, kur kemi mundësi, është gabim i madh dhe sot nuk po u ndihmojmë punëtorëve të Kosovës, nuk po u ndihmojmë absolutisht, sepse Ligji për grevat nuk flet asgjë tjetër pos kush ka të drejtë të bëjë grevë, kur organizohet greva, ku konsiderohet e ligjshme, ku bëhet kërkesa, si paralajmërohet vendi, kush mund të jetë në këshill grevist, sa mund t'i ketë këshilli grevistë dhe kjo është ajo mënyrë e organizimit të grevave dhe kush nuk ka të drejtë të organizojë grevat. Prandaj, është mirë që Kuvendi të mos e kushtëzojë, unë e kuptoj që komisioni funksional në këtë rast ka marrë vendim politik, do me thanë për një dëshirë të madhe që ta kemi Ligjin e punës, hajt mos ta votojmë në parim Ligjin për grevat. Por, hiq më pak nuk u bëjmë dëm punëtorëve të Kosovës nëse nuk ua rregullojmë çështjen me ligj. Ligji bazik për greva është Ligji i grevave dhe jo Ligji i punës, as Ligji i sindikatave. Unë po pyes – si po organizohen grevat sot në Kosovë? Për çdo ditë kemi greva, bile nganjëherë edhe kundërligjshme, pikërisht që nuk e kemi ligjin në fuqi. Unë po pyes – a po veprojnë sot sindikatat në

Kosovë? Në të gjithë sektorët ka sindikata, në bazë të çkahit po veprojnë? Prandaj, ne si deputetë të Kuvendit të Kosovës duhet që sa më parë ta ftojmë Qeverinë që ta sjellë Ligjin për punën, sepse rregullorja aktuale nuk është shumë e mangët, por nuk po respektohet dhe ne po dëshirojmë të kemi ligj për punëtorin sot në Kosovë, sepse në mënyrën më të vrazhdë po iu shkelen të drejtat dhe liritë. Por, nuk do të thotë që nesër do ta bëjmë ligjin dhe kompanitë private do ta respektojnë edhe ligjin. Edhe sot e kemi një inspektorat të punës dhe ne e dimë që sot kompanitë, një pjesë të madhe të punëtorëve i mbajnë pa kontratë, e largojnë prej punës në mënyrat ma të ndryshme. Nuk është në pyetje Ligji i punës, po ekziston një rregullore e punës, ekziston një rregullore e punës e cila duhet të zbatohet, bile me keqardhje po ju them që nuk e keni parë mirë ligjin e punës, sepse Ligji i punës nuk përmban as përafërsisht të drejtat që i ka dhënë rregullorja e punës, merreni lexoni, nesër është në publik.

Prandaj, është kështu çështja. Ne nuk duhet t'i kushtëzojmë ligjet, a e kemi Ligjin e punës apo s'e kemi Ligjin e punës. Është mirë të votohet Ligji për grevat dhe mandej ta kërkojmë Ligjin e punës, ta bëjmë ashtu si duhet dhe ta monitorojmë e ta zbatojmë në praktikë. Por, jo tash të nxjerrim, se Ligji për grevat nuk duhet të shkojë se është ligj bazik Ligji i punës. Nuk është as Ligji i sindikatave bazik për Ligjin e grevave, as Ligji i punës, kjo është plotësisht gabim. Ligj bazik ka qenë, për shembull, Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale, që do ta bëjmë para Ligjit të gjykatave dhe para Kodit penal që do të vijë, sepse ndërlihet dhe duhet të thirret në nene dhe jo tash Ligji i grevave, në asnjë nen nuk thirret.

(Ndërhyrje)

KRYESUESI: Unë kërkoj që të respektohet Rregullorja e Punës, nuk ua u ka përmendur emrin, tërhiqni butonat për fjalë! Fjalën e ka deputeti Fatmir Rexhepi, le të përgatitet deputetja Sala Berisha – Shala.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Mendoj që ne në një debat parlamentar, jo veç sot por çdo herë detyrë primare tonin e kemi që të japim kontributin, qoftë përmes debatit në përgatitje, në procedim, por edhe në ndërtimin e kornizës ligjore. Në këtë rast, është e rëndësishë pra që kemi kodifikimin, pra, përmes këtij ligji edhe të mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve për grevë, që ka një rëndësi të veçantë.

Unë e dëgjova edhe ekspozenë e ministrit, edhe ajo çka u tha nga deputetët për projektligjin, por edhe ajo çka kam lexuar nga projektligji, që vërtetë është një projektligj i përgatitur me një përmbajtje shumë të mirë për natyrën dhe qëllimin për të cilën ne sot e kemi debatin.

Prandaj, duke i dhënë përkrahje të plotë, në parim, këtij projektligji, unë mendoj që ne vërejtjen tonë kryesore e patëm te strategjia e prioritetit të përcaktuar nga Qeveria, por edhe ne nga Parlamenti lidhur me atë se a është dash më parë të vijë Projektligji për punën dhe më pastaj të vjen Projektligji për grevat. Bazuar edhe në këtë vlerësim, që mendoj që ishte e drejtë nga ana e deputetëve, unë kam një propozim konkret. Me qenë se filloj një praktikë edhe më herët në këtë Parlament edhe nga Parlamenti, edhe nga Qeveria, sikurse që ishte Ligji për gjykatat, që të hynë në fuqi pas nja 3 vitesh, unë kam propozimin konkret që komisioni funksional, për hir të punës së madhe që e ka bërë

Qeveria, Ministria përkatëse një ligj shumë të mirë, të procedohet ligji, ndërsa t'i shtohet vetëm një amendament në pjesën përfundimtare që ky Projektligj të hynë në fuqi 3 muaj apo 6 muaj pas hyrjes në fuqi të Ligjit për punën. Mendoj që kështu e mbyllim gjithë ciklin sa i përket përgatitjes dhe përfundimit të këtij projektligji, mos ta kthejmë mbrapa, por ta votojmë, të hecim dhe mendoj që me këtë amendament komisioni funksional mundet pra ta plotësojë edhe atë konditë, e cila u kërkuar nga deputetët.

Prandaj, në fund edhe një herë po them, e përkrah në parim, do ta votoj dhe do të kërkoj pra që të shtohet ky amendament në kuadër të kësaj që Projektligji për grevat të hyjë në fuqi pas aprovimit, pra në një afat të caktuar, të Projektligjit për punën. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Deputetja Sala Berisha – Shala, e ka fjalën, le të përgatitet deputeti Berim Ramosaj.

SALA BERISHA – SHALA: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë dhe ju të pranishëm,

Unë nuk e pata ndërmend ta marrë fjalën në lidhje me këtë ligj, mirëpo po e shoh të arsyeshme t'i them nja 2 – 3 fjalë. Dhe, që në fillim po them se e mbështesë, në parim, Ligjin për grevat, jam ithtare e ecjes, jo e stagnimit apo e vendnumërimit apo edhe e kthimit mbrapa. Dhe, këtë qasje shpresoj se duhet ta kemi secili si deputetë në Parlamentin e Kosovës.

Këtu është e vërtetë se mungon një pako e ligjeve, siç është Ligji i punës, Ligji i organizimit sindikal, në këtë rast, edhe Ligji i grevës. Mendoj që nëse mospuna sjell punë, nuk po e miratojmë këtë ligj, sepse duke e refuzuar ose mos me e miratua, do të thotë jemi në sfondin e mos punës. Po, nëse mendoni se mospuna sjell mospunë, atëherë cila është zgjidhja, kah t'ia mbajmë, pra?

Dhe, rrjedh pyetja në këtë drejtim – në qoftë se do të ishte projektligji për të drejtat e patronëve, a do ta kishin refuzuar një pjesë e opozitës? Kjo e ka logjikën e vetë. Thirrja në mos ekzistimin e Projektligjit të punës më tingëllon më shumë se naive. Çdo herë, një pjesë e deputetëve opozitarë jo konstruktivë gjend diçka për zvarritjet e projektligjeve, herë nuk janë të punuar mirë, herë kushtëzohen me ligje të tjera e kështu me radhë.

Ja pikat e përbashkëta që dolën gjatë diskutimit të shumicës së kësaj qasjeje opozitare jo konstruktive...

KRYESUESI: Merru me ligjin, të lutem, jo me opozitën!

SALA BERISHA – SHALA: ...s'ka Ligj të punës, s'ka kontratë kolektive...

KRYESUESI: Ju lutem, merruni me ligjin, e jo me opozitën, sepse po ka reagime, pastaj!

SALA BERISHA – SHALA: Ju lutem, zoti kryesues, jam në temë, po kjo le të jetë sqarim. Në qoftë s'ka Ligj të punës, nuk ka Ligj të organizimit sindikal, po u dashka gjithsesi të mos ketë as Ligji për grevat.

Ju ftoj ta përkrahni në parim, ju ftoj t'i ikni qasjes refuzuese, destruktive, të nderuar kolegë deputetë. Dhe, e mbështes edhe propozimin e parafolësit tim që të miratohet ky

ligj, që është i punuar aq mirë dhe me një nen të veçantë të thuhet - të hyjë në fuqi me kushtëzimin e sjelljes së Ligjit të punës sa më parë në Parlament. Faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Deputeti Berim Ramosaj, e ka fjalën.

BERIM RAMOSAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe njëherë shfrytëzoj rastin t'ju përsëndes të gjithëve! Vërtet, më bën përshtypje shumë, s'e kisha mendjen të diskutoj, se shumë diskutues i prekën ato çështje që janë të rëndësishme. Por, më bën përshtypje vetëm një fakt. Ne sot e kemi përpara Ligjin e grevës. Mos t'i përziejme konceptet. Deri te greva, kjo çështje rregullohet me ligje të tjera. Çështja është prej momentit të grevës dhe pastaj me këtë çështje merret ligji, nuk merret as me çështjen e punës, as me çështjen e marrëdhënies midis punëtorit dhe punëdhënësit, sepse kjo në vendet perëndimore që kanë traditë e raportet e marrëdhënieve punëdhënëse – punëmarrëse rregullohet me kontrata.

Ju lutem, Kontrata kolektive është institucioni që e rregullon çështjen e marrëdhënies midis punëdhënësit dhe punëmarrësit, e jo Ligji mbi grevën. Ligji mbi grevën vlen në momentin kur përfundohen të gjitha mjetet demokratike sindikale dhe shkohet në grevë, si akt i fundit. Andaj, Ligji mbi grevën, si është i prezantuar sot, i plotëson kushtet për periudhën e grevës, jo për periudhën para grevës. Andaj, ju kërkoj falje shumë deputetëve të cilët po më duket, me respekt po ju them, por nuk i kanë të qarta. Ky ligj nuk merret me çështjen para grevës, nuk merret me çështje që rregullohen me Kontratën kolektive midis punëdhënësit dhe punëmarrësit, por merret vetëm me periudhën kur fillon greva e tutje. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Naim Rrustemi, e ka fjalën.

NAIM RRUSTEMI: Unë do të jem shumë më i shkurtër se të tjerët, se po mendoj se shumë prej diskutuesve nuk e kanë pasur në dorë kurrë Ligjin për marrëdhënien e punës. Me fjalë të tjera, nuk janë shumë në dijeni se çka përshkruhet aty. Është shumë e qartë që Ligji i punës rregullon marrëdhënien mes punëdhënësit dhe punëmarrësit, rregullon këtë marrëdhënie, kjo është çështja primare me të cilën merret Ligji i punës. Ne e kemi një Rregullore 2001/27, është një rregullore, kurse ky ligj, Ligji për grevat normalisht që është në marrëdhënie të drejtpërdrejtë me Ligjin e punës, është normalisht se janë efektet, për shembull, e ke nenin 18, efektet e grevës. Efektet e grevës në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikojnë në marrëdhëniet mes punëdhënësit dhe punëmarrësit. Të thuhet se nuk ka relacion, nuk ka relacion mes Ligjit të punës dhe Ligjit për grevat, është non-sens.

(Ndërhyrje)

Po, nuk kisha pasur çka të diskutoj, se prej fjalimit të juaj, zoti Berim Ramosaj, desha të ta jap rastin për replikë, u pa se nuk e ke lexuar Ligjin e punës. Kështu që shumë e arsyeshme, shumë e arsyeshme kishte për të qenë, nuk po them që ligji është i keq, ligji është në rregull, mund të flasim për të. Po, a ka nevojë që ky ligj për t'u bërë si komplet, si paketë, normalisht që është kërkesë e domosdoshme për të pasur edhe Ligjin e punës. Unë veç desha, s'kam dash të diskutoj, po desha ta bie në vijë. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë, Berim Ramosa, po mos u çudit se socializmin veç sa e kemi lënë prapa, nga pak ndikohemi. Urdhëro, Berim!

BERIM RAMOSAJ: Shiko, desha t'i them kolegut të nderuar se kur të vjen momenti të diskutojmë për Ligjin e punës, do të shohim cili e ka kuptuar më mirë, jo cili e ka lexuar. Ndërsa, sa iu përket çështjeve, nëse mendoni ju me Ligjin e punës t'i rregulloni këto çështje, ka vdekur komunizmi dhe socializmi, me kontratën kolektive rregullohet ajo çështje. Vaj medet, që s'i kemi ne ende kontratat kolektive midis punëdhënësit dhe punëmarrësit, e mandej sqarohen këto. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë, Naim Rustemi, një minutë.

NAIM RRUSTEMI: Do të vjen Ligji i punës, unë hala se kam parë, po ky që është sot, nis neni 1.1, - Kjo rregullore rregullon punësimin në Kosovë, duke përfshirë edhe marrëdhëniet e punës, sipas të cilave kryen punët ose shërbimet. Versioni ndoshta është version i updated.

KRYETARI: Driton, e ke fjalën, nëse mundesh si shkurt me i ra.

DRITON TALI: Jo, unë desha veç edhe një pyetje, po e thanë këta dy diskutuesit para meje. Çka rregullon, në realitet, çka përfiton me Ligjin për punën grevisti, punëtori? Do me thanë, pos asaj që ka të drejtë të marrë pjesë apo të hyjë në grevë, çka tjetër? Kjo është ajo që desha ta ngreh çështjen. Do me thanë, ka të drejtë të protestojë, po për çka të protestojë, nëse e di edhe ai vetë për shkak se nuk i ka normat për të cilat duhet të protestojë apo mos të protestojë.

KRYETARI: Mirë, faleminderit! Votimin për këtë projektligj do ta bëjmë kur të jemi mbi 61 deputetë në sallë.

Vazhdojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për energjinë elektrike

Në bazë të Rregullës 35.1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim, në parim, të këtij Projektligji.

Ftoj ministren e Energjisë dhe të Minierave, Justina Shiroka Pula, që në emër të Qeverisë para deputetëve të Kuvendit të prezantojë projektligjin.

MINISTRJA JUSTINA SHIROKA PULA: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Në emër të Ministrisë së Energjisë dhe të Minierave i praques për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës Projektligjin për energjinë elektrike.

Ligjet në fuqi për sektorin e energjisë, ndër to edhe Ligji për energji elektrike, numër 2004/10, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe i shpallur nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm në qershor të vitit 2004, përmes rregulloreve përkatëse, megjithëse kanë dhënë kontribut shumë të madh për ndërtimin e një baze infrastrukturore të sektorit të energjisë, kanë pasur edhe paqartësi në delegimin e përgjegjësisë dhe të autoriteteve, si dhe relacioneve ndërmjet tyre. Këto mangësi të evituara gjatë zbatimit të këtij ligji kanë bërë që të ketë edhe hezitime në vendimmarrje të rëndësishme, si dhe kanë shkaktua debate të panevojshme. Duke i shtuar kësaj edhe faktin se që nga viti 2004 e

këndeje është plotësuar baza legjislativë për shumë fusha që janë të ndërlidhura me sektorin e energjisë.

Konsiderojmë si të domosdoshme që të zëvendësohet ligji, i cili është në fuqi, me ligj të ri. Një motiv tjetër për zëvendësimin e legjislacionit ekzistues është edhe qasja e Bashkimit Evropian për integrimin e plotë të tregut të energjisë me të ashtuquajturën – Pakon e tretë legjislativë, ku edhe Kosova do të jetë një aktor i rëndësishëm i këtij tregu dhe duhet të jetë sa më parë i përgatitur për t’iu përshtatur kërkesave të reja.

Qëllimi i projektligjit për energji elektrike është të zhvillojë një treg konkurrues dhe të qëndrueshëm të energjisë elektrike, të garantojë kushte për prodhim, transmetim, shpërndarje dhe furnizim të sigurt, të qëndrueshëm dhe të përhershëm me energji elektrike, duke iu përmbajtur parimeve të efikasitetit të energjisë, të përcaktohen procedurat për dhënien e licencës për veprimtaritë në sferën e energjisë elektrike dhe për autorizimet dhe tenderimin e kapaciteteve të reja konsumatorëve jo shtëpiakë dhe të tjerëve.

Me këtë ligj përcaktohen rregullat e përgjithshme për kryerjen e aktiviteteve të prodhimit, të transmissioinit, të shpërndarjes, të furnizimit dhe qasjes së interkoneksioinit, organizimin e qasjes ndaj sistemit të transmissioinit dhe sistemit të shpërndarjes, si dhe për funksionimin dhe qasjen ndaj tregut të organizuar të energjisë elektrike.

Projektligji për energji elektrike përbëhet prej 12 krerëve dhe 39 neneve.

I nderuari kryetar,

Të nderuar deputetë,

Projektligji për energji elektrike është hartuar me përputhje me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007. Projektligji ka formën dhe strukturën standarde në pajtim me Udhëzimin administrativ nr. 14/2008, për hartimin e projektligjeve dhe të akteve nënligjore.

Në hartimin e këtij projektligji kanë marrë pjesë ekspertë nga institucione të rëndësishme vendore, si Zyra e Kryeministrit të Kosovës, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Korporata Energjetike e Kosovës, Zyra e Rregullatorit për Energji, si dhe Operatori i Sistemit të Transmissioinit dhe Tregut.

Përveç institucioneve vendore, në hartimin e këtij Projektligji janë angazhuar gjithashtu ekspertë nga Brukseli, ku më pas ky projektligj u është dërguar edhe institucioneve tjera ndërkombëtare, si ICO, Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian, konsulentëve nga USAID-i si dhe Traktatit të komunitetit të energjisë, me ç’rast janë marrë parasysh dhe janë inkorporuar komentet dhe sugjerimet të tyre, që do të thotë se ky projektligj është në harmoni të plotë me direktivat e Fondit të Bashkësisë Evropiane për sektorin e energjisë.

Po ashtu, ky projektligj nuk cenon ndonjë nga parimet të përgjithshme të *acquis communautaire* sipas deklaratave të lëshuara nga Agjencioni për Koordinimin dhe Zhvillimin e Integrimin Evropian.

Gjithë puna e hartimit të projektligjit është bërë në frymën e transparencës dhe të bashkëpunimit ndërinstitucional.

Vlen të theksoj se me këtë projektligj përmbushet pika 2 e Vendimit të datës 1 prill 2010, të këtij Kuvendi, për krijimin e ambientit ligjor për konkurrencë në treg të lirë në fushën e sektorit të energjisë.

Të nderuar deputetë,

Ju propozoj që ta miratoni, në parim, këtë projektligj, i cili do të jetë në funksion të kompletimit të infrastrukturës ligjore në sektorin e energjisë në Republikën e Kosovës.

Ligji për energjinë elektrike do të përfshihet në pakon e ligjeve të energjisë, të cilat janë miratuar, në parim, nga ky Kuvend. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Kryetari ose raportuesi i komisionit funksional, nuk është lajmëruar.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, kush e do fjalën? Deputetja Sala Berisha – Shala.

SALA BERISHA – SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

Përsëritje, zonjës ministre Shiroka Pula!

Kolegë deputetë,

Ju të pranishëm,

Në kuadër të pakos të projektligjeve për energjinë, është edhe Projektligji për energjinë elektrike.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka analizuar, si dhe të gjitha vërejtjet që kanë dalë edhe nga seanca në të cilën është kthyer ky projektligj siç janë, bie fjala, ristrukturimi i sektorit të energjisë, zhvillimi i tregut, operatorët e tregut, konkurrenca, tarifat e rregulluara e tjera, çështje të cilat kanë dalë si arsyetim nga një seancë e mëhershme që të kthehet ky projektligj.

Mendojmë që këto çështje janë të rregulluara në mënyrën më të mirë të mundshme, duke mos e përjashtuar edhe mundësinë e përsosjes edhe më tej gjatë fazës së amendamentimit në komisionin funksional.

Dy projektligje të tjera të kësaj pakoje, siç është Projektligji për energjinë dhe Projektligji për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, kanë mbet peng i këtij projektligji, pa i nënshtuar fazës së amendamentimit në komisionin funksional përkatës.

Andaj, edhe si komision presim që t'u hapet rrugë në pako këtyre projektligjeve për ecje të mëtutjeshme ngase janë të ndërlidhur njëri me tjetrin, e të gjitha këto, edhe me Strategjinë e energjisë. Përveç kësaj, në mungesë të projektligjeve të cekura, zvarriten edhe shumë projekte të tjera që janë të ndërlidhura me këto çështje. Zvarritja e mëtejshme nuk do të na arsyetohet me asgjë. Nuk do me thënë që edhe pas një periudhe kohore të mos jenë objekt i plotësim – ndryshimit prapë këto projektligje, por edhe ligje të tjera të fushave të tjera, natyrisht varësisht nga zhvillimet.

Në fund, kolegë deputetë, ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështesim, në parim. Me këtë rast ju ftoj edhe juve, të nderuar, ta mbështesni në parim, të na mundësohet kryerja e obligimeve tona edhe si komision funksional. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Zef Morina, e ka fjalën.

ZEF MORINA: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka analizuar me vëmendje dhe duke pasur parasysh që Ligji 2004/10, i cili ishte i miratuar në vitin 2004, pra, nuk i plotësonte të gjitha kriteret të cilat përcaktohen për mbarëvajtjen ose funksionimin në këtë lëmi. Mendojmë që plotësimi ose ky ligj i cili tani do t'i plotësojë ato zbrazëtira, ka një rëndësi të veçantë. Ka rëndësi të veçantë sepse përcakton rregullat për kryerjen e aktiviteteve, përfshirë këtu prodhimin, transmissionin, pra, duke përcaktuar detyrat dhe kriteret për operatorët të transmissiionit, shpërndarjen ose gjithashtu përcaktimin e kriterëve dhe të obligimeve që i jepen operatorit të shpërndarjes, furnizimin si dhe qasjen në interkonekcione.

Qëllimi i këtij ligji është të zhvillojë një treg të qëndrueshëm dhe konkurrues të energjisë elektrike, të garantojë kushte për furnizim të sigurt me energji elektrike, të përcaktojë procedurat për dhënien e licencave për veprimtarinë në sferën e energjisë elektrike, si dhe të sigurojë masa të duhura për mbrojtjen e konsumatorëve.

Sigurisht që ka nevojë, do me thanë, ka edhe elemente për të cilat në leximin e dytë ne do të japim kontributin tonë. Në parim, e mbështesim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Haki Shatri e ka fjalën.

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka vlerësuar këtë ligj si ligj të nevojshëm dhe përmbajtjen e tij si të pranueshme. Mendojmë që ka një zgjidhje shumë të mirë, në veçanti sa i përket promovimit të parimeve të ekonomisë së tregut në lëmin e energjisë elektrike.

E vetmja brengë e Grupit tonë Parlamentar është se si të harmonizohen veprimet në praktikë, nga sektori aktual, me dispozitat e këtij ligji, që ne i konsiderojmë të mira. Duhet ose të ndryshohet ligji, ose sjelljet. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, shefi i Grupit, Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i AKR-së e ka shqyrtuar projektligjin, edhe pse nuk ka ndonjë ndryshim shumë të madh nga projektligji i cili është kthyer mbrapa. Ministrja tha që kanë marrë pjesë ekspertë më të mirë të Kosovës edhe ndërkombëtarët, e boll keq qenka bërë, bre ministre, se kam menduar që më shumë do të duhej të kishin bërë ata, pasi qenkan më të mirët. Po, të shohim se si do të shkojë në praktikë.

Grupi Parlamentar i AKR-së e mbështet, në parim, këtë projektligj, edhe pse jemi të vetëdijshëm që do të ketë mjaftë punë në komision, pastaj, për t'u rregulluar dhe harmonizuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të LDD-së, Naser Rugova, e ka fjalën.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Po e diskutojmë për herë të dytë këtë projektligj, një nga projektligjet jashtëzakonisht të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të vendit, në veçanti të sektorit të energjetikës.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë vërtet e ka analizuar me seriozitetin më të madh këtë ligj tejet të rëndësishëm dhe me keqardhje dua të them që kur seanca plenare e kthen një ligj mbrapa dhe jep vërejtjet e veta substanciale, ato vërejtje duhet të shikohen, të analizohen, të përpunohen dhe, thjeshtë, të hynë si ndryshime në atë projektligj, për çka edhe është kthyer mbrapa. Fatkeqësisht, ndryshimet janë minimale, nuk prekin bërthamën, strukturimin, organizimin, qoftë të furnizimit me energji elektrike, nuk është në përputhje me Strategjinë e energjisë, e cila u votua si u votua në këtë seancë plenare, pa vërejtjet substanciale të këtij Parlamenti, me presione të mëdha.

Unë kërkoj nga Qeveria dhe nga Ministria e Energjetikës, por edhe Komuniteti ndërministror të çlirohen nga presionet dhe të mendojnë mirë e drejtë për zhvillimin e sektorit energjetik në vend, pa presione, pa tensione dhe të orientohen sipas kërkesave dhe interesit nacional të qytetarëve të Republikës së Kosovës, as më shumë e as më pak. Dhe, në qoftë se vërtet ky ligj është kthyer, ka pësuar ndryshime minimale, atëherë çka po ndodh me këtë Kuvend, ku është komisioni funksional, pse në emër të komisionit funksional nuk ka sqarim cilat ndryshime janë bërë në këtë projektligj tani që ka ardhur.

Anëtarësimi i Kosovës në Komunitetin e Energjisë, Traktatit të Athinës, pastaj obligimet që dalin nga direktivat e Bashkimit Evropian sa i takon sektorit të energjisë, me këtë qasje, me këtë menaxhim, me këtë vizion do të kemi probleme serioze. Duke i ditur tani edhe afatet e paracaktuara, hapat radikal që duhet të merren për mbylljen e Termocentralit “A”. Pastaj, edhe një sërë kriteresh të tjera, që jemi të obliguar si shtet dhe si shoqëri, si institucione t’i plotësojmë. Ministre, frikoj që ky ligj adreson mënyrën më të duhur këto orientime, këto interesa nacionale dhe zhvillimin e sektorit të energjisë në përgjithësi.

Andaj, këtu po shihet që vërtet po kthehen ligjet mbrapa nga seanca, që është organi kompetent vendimmarrës për të gjitha dhe, e tha edhe kryetari i Kuvendit më herët për një projektligj tjetër, vërtet, ku është roli tani i komisioneve funksionale. A po bëjnë punë si duhet, a po procedojmë si duhet, a po i respektojnë procedurat që jemi të thirrur si njerëz të zgjedhur të qytetarëve.

Lidhja Demokratike e Dardanisë do të marrë pjesë në votim dhe le të jetë vullneti i secilit deputet se a do ta votojë këtë projektligj a jo. Ju faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputeti Zylfi Merxha, e ka fjalën.

ZYLFI MERXHA: Faleminderit, zoti kryetar i Parlamentit, doktor Jakup Krasniqi, që ma dhatë fjalën!

I përshëndes dy ministrat, ministren dhe ministrin, për hasret që po rrinë këtu me ne.

Ashtu, kolegët e mi, deputetë, që gjysma ikin e gjysma janë këtu, prapë kurrgjë s’u bëhet.

Ne, në parim, e mbështesim këtë ligj, se e kemi pasur edhe një herë. Ligj më i mirë s’na duhet, loçkë është. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit parlamentar të SLS-së, kryetari i Grupit, Petar Miletij e ka fjalën.

PETAR MILETIĆ: Poslanička grupa Samostalne liberalne stranka u načelu podržava ovaj zakon.

KRYETARI: Faleminderit!

Grupi për Integrim, nuk janë këtu.

Atëherë, shkojmë sipas radhës së paraqitur të deputetëve. Janë 6 deputetë, këta të tjerët që lajmërohen si pranojmë. Qe edhe i shtati, shtatë janë, tetë si pranoj më, u krye.

Deputeti Lulzim Zeneli e ka fjalën.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, seanca plenare një kohë më parë ka dhënë mendimin sa i përket këtij projektligji dhe faktikisht mendimi ka qenë që një projektligj i tillë nuk i plotëson kriteret që të shkojë më tutje dhe ka votuar “kundër”. Sot kemi po të njëjtin dokument dhe, fatkeqësisht, sot po më habisin disa qëndrime të disa grupeve parlamentare që për të njëjtin dokument kanë mendim tjetër.

Ajo çka duhet theksohet, se në qoftë se Kuvendi i Kosovës në vitin 2004 ka miratuar një Projektligj për energjinë elektrike dhe sot vjen një projektligj i ri, që nuk dihet se çka është në përmbajtje ndryshimi, flitet për harmonizim me direktivat e BE-së, edhe në atë kohë, në vitin 2004, po i njëjti projektligj ka qenë i harmonizuar me direktivat e Bashkimit Evropian dhe cilat janë ndryshimet, çka ka ndryshuar në kuadër të këtyre direktivave, e para. Flitet për konkurrencë, koncepti i konkurrencës që lansohet këtu tek ne, në Kuvendin e Kosovës, nuk korrespondon me realitetin. Në fakt, sot kemi një monopol dhe dalëngadalë po shndërrohem në një monopol tjetër dhe s’ka këtu konkurrencë.

Dhe, tjera, çka flitet për kosto buxhetore. Shikoni projektligjin dhe mund të vini në përfundim. Është diçka interesant që po na përcjell në seancë plenare dhe këtë Kuvend. Sot, më parë e patëm një projektligj, ku të gjitha grupet parlamentare u shprehën “kundër” dhe në fund u miratua ai projektligj. Është diçka për habi çka po ndodhë, ose ka nevojë për një vetëdijesim më të lartë, ose diçka nuk është në rregull. Në qoftë se seanca plenare një dokument e ka kthyer edhe ka dhënë vërejtjet konkrete dhe prapë Qeveria e Kosovës e sjell po të njëjtin dokument, pa asnjë ndryshim, prapë është diçka jo serioze. Prandaj, konsideroj që ndoshta është momenti i fundit që ta korrigjojnë vetveten. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Nerxhivane Dauti e ka fjalën.

NERXHIVANE DAUTI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuari zoti ministër dhe ministre,

Ju përshëndes të gjithëve!

Sa i përket Ligjit për energjinë, do t’i prezantoj disa çështje të rëndësishme lidhur me këtë ligj. Projektligji për energjinë elektrike paraqitet si nevojë e plotësimit të zbrazëtirave në sistemin juridik të Kosovës, ndarjen e përgjegjësiave mes institucioneve, lehtësimin e investimeve dhe përafrimin me direktivat e BE-së për fushën e energjisë, si dhe implementimin dhe përmbushjen e obligimeve që dalin nga traktati i komunitetit të energjisë.

Qëllimi i këtij projektligji është që të zhvillojë një treg konkurrues dhe të qëndrueshëm të energjisë elektrike me rregullat e përbashkëta sa i përket prodhimit, transmissioinit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike dhe për qasje në treg, të garantojë kushtet për furnizim të sigurt, të besueshëm dhe të përhershëm me energji elektrike, duke iu përmbajtur parimeve të efikasitetit të energjisë, të përcaktojë procedurat për dhënien e licencave për veprimtari në sferën e energjisë elektrike.

Projektligji për energjinë elektrike është në ndërrvarësi me Ligjin për energjinë dhe Ligjin për Rregullatorin e Energjisë. Është me rëndësi të theksohet se ky projektligj shfuqizon dhe zëvendëson Ligjin për energjinë elektrike, numër 2004/10.

Marrë në përgjithësi, ligji përmban një teknikë juridike të mirë, një gjuhë të mirë juridike dhe shumë të qartë.

Ligjin e përkrah në shqyrtim të parë, ndërsa vërejtjet eventuale do t'i paraqes në komisionin përkatës, ku jam edhe anëtarë e Komisionit. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Adem Hajdaraj.

ADEM HAJDARAJ: Faleminderit, zotëri kryetar!

I përshëndes deputetët dhe ministren!

Unë mendoj se ligji, pas gjithë këtyre që u thanë deri më tani edhe që u trajtuan e që janë trajtuar edhe në të kaluarën, mendoj se duhet të tumiret në këtë lexim, do me thënë të shkojë. Është një ligj i mirë jo vetëm sa i përket formulimeve të judikaturës, që janë këtu, të anës të drejtësisë, por edhe në anën gjuhësore, megjithatë ne e shohim se përsëriten disa gabime gjuhësore, që e rëndojnë ligjin, e që në leximin tjetër do të duhej të përmirësoheshin.

Ndër to, unë po përmend këto raste: termi “konsumatori i kualifikuar”, besoj në faqen 8, që përdoret, nuk duhet të përdoret kështu i “kualifikuar”, sepse konsumatori as nuk kryen farë shkolle, as diçka, të themi, nuk jep farë provimi për t’u kualifikuar, por do të ishte më e drejtë të quhej “konsumatori bazik” ose “konsumatori që i plotëson disa kriteret” për tregti. Po ashtu, edhe termi “konsumator fundor” më duket se është prapë termi “fundor” i papërshtatshëm dhe do të ishte mirë të jetë: “konsumatori për nevojat e veta” jo “fundor”, as i “fundit”. Përsëri këtu, në këtë togfjalësh “konsumatori fundor”, fjala “fundor” nuk e ka vendin, besoj.

Desha të them, se më duket nuk është e tepërt të thuhet, jo vetëm për këtë ligj, por edhe për ligjet tjera, diku përdoret Kosova, diku Republika e Kosovës, diku harrohen disa gjëra. Do me thënë, duhet të përdoret në formë të njëjtë, të thuhet ose Republika e Kosovës ose vendi ynë, mund të thuhet, nëse s’do ta përsërisësh njëqind herë – Republika e Kosovës.

Tjetër, si pikë tjetër, nuk ka mundësi të pagesës së faturave, është një shprehje është aty, faqe 14, jo “nuk ka mundësi të pagesës së faturave”, por “nuk ka mundësi t’i paguaj faturat” e jo “të pagesës së faturave”. Edhe kjo është përkthim nga serbokroatishtja, nëse e krahasoni, faqe 14.

Tjetër, “prodhuesi i energjisë elektrike ka për obligim”, po i them tri-katër fjali këtu, ku trajtat e shkurta të përemrave përdoren pa kurrfarë përputhjeje, përshtatshmërie gjuhësore, njëjësi në vend të shumës dhe ky është ligj që duhet të lexohet, duhet të publikohet. Për shembull, thuhet kështu: “Prodhuesi i energjisë elektrike ka për obligim t’i përmbahet të gjitha kushteve”. Qysh “t’i përmbahet të gjitha kushteve”, “t’u përmbahet të gjitha kushteve”, atyre u përmbahet, jo t’i përmbahet atij. E dyta, “t’i përmbahet rregullave përkatëse”, prapë shumës, njëjësi në vend të shumës – “t’u përmbahet”. “T’i përmbahet të gjitha obligimeve”, duhet “t’u përmbahet të gjitha obligimeve”, atyre t’u përmbahet, jo t’i përmbahet. A është ashtu?

Mandej, “obligimeve prodhuese mund t’i shes kategorive tjera”, jo mund t’i shesë kategorive tjera, por ”mund t’ua shesë kategorive tjera”. Ky është ligj, duhet pak a shumë të jetë në përputhje me standardin e sotëm. Në faqen 20, do me thënë, është kjo. Mendoj se ka edhe disa formulime të mangëta, të cilat duhet të plotësohen, zonja ministre. Të riformulohet paragrafi 1, e posaçërisht paragrafi 2. Qe si thotë ky paragraf: “Niveli i rezervave të lëndëve djegëse dhe të kapaciteteve prodhues për rezervat speciale”, duhet jo “për rezervat speciale”, por “të rezervave speciale”, do me thënë, kapaciteteve duhet, e jo një njëjës. Mandej, “duhet të mbajnë prodhuesit e emergjencës elektrike”, jo duhet të mbajnë, por “duhet t’i mbajnë”, sepse kjo është plotësisht në kundërshtim me normën letrare.

Ja edhe një formulim këtu, thotë: “Masat përmes të cilave sigurohen informatat e përditshme mbi të gjitha tarifat dhe pagesat e përmbajtjes së aplikueshme”, çka? Këtu nuk është plotësuar fjalia, është e mangët dhe ky nen këtu, 1.4, duhet të plotësohet. Po ashtu, duhet të plotësohet dhe riformulohet edhe paragrafi 2: “Niveli i rezervave të lëndës djegëse dhe të kapaciteteve prodhuese për rezervat speciale, duhet “të rezervave speciale”, e tjera që janë në kundërshtim me formulimin e fjalisë. Duhet të jetë neni preciz edhe alineja duhet të jetë precize, jo çka do të futësh aty, se edhe gjuha është ligj, më në fund. Unë kam thënë disa herë, po e përsëris, ndoshta bëhem i tepërt, sa më e pastër dhe e mirë të jetë gjuha, aq më i pasur dhe më i mirë është ligji. Gjuha të ngrehë lartë, gjuha të rrëzon për dhe. Pa gjuhë nuk ka as ligj të mirë.

“Operatori i sistemit të bartjes mban në pronë dhe është përgjegjës”, duhet “që e ka në pronësi”, jo “që e mban në pronë”. Do me thënë, edhe ky formulim duhet të jetë. Por, çka t’i bësh ligjit, se ka edhe gabime, për shembull, lidhja “do të del” thotë, do të thotë “ai do të shkon”. Merreni me mend, deputetë, “do të shkon” në lidhoren, veta e tretë, “ai do të shkojë”, “ai do të dalë”, “ai do të punojë”. Ne po i mësojmë studentët, atje. Ju faleminderit, zotëri kryetar!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Ju faleminderit!

Unë, atë që e thashë në pikën 3, po mendoj për Ligjin për administratën shtetërore, veç po ma fuqizon kjo pikë tash, sepse ju, i nderuar, nuk ishit këtu prezent. Disa e kanë keqkuptuar Qeverinë dhe shtetin, nuk e kuptojnë që Qeveria është shteti, dhe ja rast konkret i asaj që shteti është Qeveria. Një ligj që me 29 janar e kemi kthyer dhe votat kanë qenë 29:29, na sjell këtu, është disponimi i kryeministrit apo i Qeverisë dhe është sjellë këtu dhe ne tash i hamë fjalët tona. Nuk thuhet kotë se politikën s’bën ta udhëheqin politikanët. Unë e kam transkriptin këtu në dorë dhe e kam këtë ligj dhe të gjitha ato vërejtjet të disa deputetëve të asaj seance, që i kanë dhënë, nuk kanë ndryshuar fare. Tash shtrohet pyetja, çka është ndryshuar, pos fjalimit të zonjës ministre. Zonja

ministre, kësaj radhe nuk e filloi, e filloi me atë refrenin në emër të Ministrisë e tjera, e tjera, por nuk tha Ligji në fuqi për sektorin e energjisë, e ndër to edhe Ligji për..., Qëllimi, mos ta lexoj krejt se është identik, edhe fjalimin e ka pasur zonja ministre të njëjtë. E kam transkriptin më 29, e kam transkriptin edhe të grupeve parlamentare, të cilat e patën refuzuar dhe tash e pranojnë. Do me thënë, këtu është ai farë integriteti që folëm dhe këtu vihet në pah Ligji për administratën shtetërore, para çka kemi shtet sot këtu në Kosovë.

Me të vërtetë është marre të na dëgjojë dikush dhe shqyr që është jashtë orarit të transmetimit dhe do të apeloja, që t'i thoni RTK-së mos ta transmetojnë këtë në publik se është marrja e dheut, është gazi i dynjasë çka jemi kah flasim.

KRYETARI: Mediat janë të pavarura dhe nuk përzihem aty. Fjalën e ka deputeti Naim Rrustemi.

NAIM RRUSTEMI: Ju faleminderit! Po e vazhdoj aty ku e la Dritoni, se me të vërtetë këto janë veprime kundër Rregullores të Punës së Kuvendit, sepse deputeti duhet të veprojë me integritet. E integritet, do të thotë, ato çka e thua, ta mbash. Në rast se atë çka e thua, nuk e mban, atëherë mungon integriteti. Me fjalë të tjera, e thyen Rregulloren e Punës së Kuvendit, një. Dhe, e dyta, me profesorin Adem, ju faleminderit, por është shumë e vërtetë që rregullës gramatikore, marrëdhënia mes kryefjalës dhe foljes në të gjitha ligjet që i sjell Qeveria, nuk është në rregull. Me rregullat e gjuhës shqipe, kryefjala dhe folja duhet të jenë në marrëveshje, do me thënë nuk duhet të përzihen dhe atëherë i kishim tejkaluar problemet që i ceku profesori Adem, profesori i gjuhës, me dhjetëra herë, edhe disa herë tjera. Kjo ishte nga njëra anë, kurse nga ana tjetër, nëse veç është vendosur të kalojë ky ligj, unë kisha pasur qejf që neni 34 i këtij ligji, ku flitet për importin dhe eksportin e energjisë, që thotë se: “përveç në rastet e përcaktuara në pjesët e tjera të këtij ligji, importi dhe eksporti i energjisë mund të kryhet apo rregullohet nga ndërmarrjet që kanë licencë të lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji”. Unë kisha pasur qejf këtë të hiqet krejt, edhe ashtu deri tash nuk është respektuar. Unë e lexova një raport, të dielën, në një prej revistave që e kishin bërë një gazetari hulumtuese, që GEN-i i Beogradit, kemi importuar prej tij rrymë, prej kompanisë të palicencuar. Nëse veç ne nuk e respektojmë ligjin, ta heqim, është më lehtë edhe për neve, është ma lehtë edhe për allesh-verishe dhe makinacione financiare dhe, qe besa, pse mos të përdoren disa lidhje tonat të moçme me Beogradin dhe të blejmë rrymën prej tyre....

(Ndërhyrje e Driton Talit: më lirë e kanë ata).

.... ndoshta edhe kanë më lirë, kështu që për të mos e pasur nenin pengesë, e heqim nenin krejt, ashtu e kështu ligji nuk po vepron. Nëse kishim thënë që drejtësia sundon në Kosovë, ata që e kanë importuar rrymën prej kompanive të palicencuara, sot ishte dashur të paraqiten para gjykatës, sepse nuk lejohet me ligj. Meqenëse, qenka pengesë dhe qenka pengesë serioze, atëherë po e heqim nenin krejt, mos e qitni as në këtë ligj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Mirë, atëherë ju të pavarurit na i bini lidhjet me Beogradin. Vazhdojmë, Bujar Dugolli e ka fjalën.

BUJAR DUGOLLI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Unë do të jem i shkurtër. U tha këtu nga disa deputetë që është i qartë ky projektligj në aspektin gjuhësor, terminologjik, juridik. Mua më pëlqeu fjalimi i deputeti Adem Hajdari, kur në aspektin gjuhësor paraqiti shumë vërejtje, të cilat qëndrojnë dhe unë konsideroj që ky projektligj është shumë i komplikuar edhe në aspektin gjuhësor, edhe në aspektin e terminologjisë juridike, prandaj do t'i duhet shumë komisionit funksional të sqarojë, sepse aq shumë janë të gjatë nenet, pa presje, pa pikë, sa që do të shkaktojë një konfuzitet në zbatueshmërinë e tij. Prandaj, duhet të kihet kujdes, sepse kur bëhet fjalë për kyqjen e operatorëve privat në sektorin e energjisë, në rast se do të jetë ky konfuzitet i këtyre ligjeve, atëherë interpretimi i tyre do të bëhet në favor të atyre që ndoshta në aspektin ndërkombëtar edhe i sponsorizojnë këto ligje.

Unë do të lusja që në komision të kihet parasysh specifikimi i konsumatorëve, siç është bërë në këtë ligj, do me thënë, konsumatorët të jenë një dhe të mos bëhen dallimet e tyre, sepse në bazë të ligjit për mbrojtjen e konsumatorit, çdo konsumator është i barabartë dhe nuk duhet bërë dallime.

Tek neni 30, - Pezullimi dhe ndërprerja e përkohshme e furnizimit të energjisë elektrike, këtu jemi dëshmitarë që shpesh është thënë – me lejen e Rregullatorit, shpesh – pa leje të Rregullatorit, është keqpërdor dhe janë dëmtuar konsumatorët e ndërgjegjshëm, të përgjegjshëm në raport me shërbimet dhe politika e aplikuar duhet të sanksionohet me këtë ligj, që nuk duhet të ketë ndalje kolektive, por duhet të ketë furnizim të rregullt dhe nuk duhet të ketë ndalje kolektive dhe të dëmtohen konsumatorët e përgjegjshëm në raport me ata të papërgjegjshmit. Furnizuesit e energjisë elektrike dhe organet kompetente duhet të gjejnë masa të tjera që për konsumatorët e papërgjegjshëm të aplikojnë ndëshkime apo procese gjyqësore. Unë mendoj se tek ndërprerjet e furnizimit me energji elektrike duhet të qartësohet qartë, qoftë me një nen shtesë që nuk duhet të aplikohen praktikat qysh janë aplikuar deri më tash, qoftë me sistemin A,B,C apo me sistemet tjera që mund të jenë të ngjashëm.

Përndryshe, ky është një ligj i rëndësishëm, ka pasur një bazueshmëri edhe më herët. Sido që të jetë, mendoj që në procedurën e mëtutjeshme në komisionin funksional mund të përmirësohet dhe shumë terminologji të paqarta të rregullohen. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Diskutuesi i fundit për sot është deputeti Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Ju faleminderit, zotëri kryetar!

Unë, lidhur me Projektligjin për energjinë elektrike, si deputet, jo në emër të Grupit, kam debatuar, kam marrë pjesë në debatin e parë dhe qysh atëherë, jo veç për shkak të rëndësisë së madhe që ka pasur paketa e projektligjeve në sektorin e energjisë, po ky projektligj, bashkë me dy projektligjet e tjera, e kam dhënë mendimin parimor se është dashur të votohet, të procedohet dhe të punohet, të shikohet të ndërtohet ashtu që të jetë në pajtim me këtë paketë të strategjisë ligjore që e ka ofruar Ministria dhe Qeveria.

Unë, edhe tani e lexova edhe një herë këtë projektligj dhe mund të konstatoj se nuk ka asnjë ndryshim nga Projektligji i parë që është ofruar më herët. Por, unë do të votoj sërish në parim, pra sa i përket këtij projektligji, sepse kam thënë edhe herën e parë që i plotëson ato kondita që i duhen një projektligji.

Sa i përket mandatit dhe detyrave tjera, që si anëtar i komisionit funksional që jam për energjetikë, ku bie ky projektligj të shqyrtohet, të procedohet, të plotësohet ose të debatohet brenda tij, unë mendoj se nuk na ka mbetur shumë punë. Absolutisht, unë e

ndaj mendimin që tha aga haxhi, se ky projektligj është loçkë. Dhe, për hatër të agës haxhi, unë e aprovoj edhe një herë në parim, po them, bile s'e kisha lodhur komisionin për arsye se kemi pasur, kur është loçkë, unë po ia bashkëngjes këtë pjesës tjetër se ky projektligj nuk mund të jetë jashtë Strategjisë për energjinë. Unë nuk e kam votuar strategjinë atë ditë. Tre muaj ditë komisioni funksional ka debatuar për strategjinë dhe ky me qenë tani, sërish pra po ndodh që të jetë atje ku nuk i kemi mbrojtur interesat – strategjinë energjetike, që ka të bëjë me “Kosovën B” mendoj, edhe një herë po them, që komisionit nuk i ka mbetur shumë punë, por drejtpërdrejt shkojmë në leximin e dytë, që do ta votoj edhe atëherë. Faleminderit!

KRYETARI: Kërkoj nga regjia që t'i bie ziles, se nuk e kemi numrin e mjaftueshëm për të votuar.

Të nderuar deputetë,

Vërtet, nuk dua të flas shumë, por me këtë, do të thotë, vetëm katër deputetë që shkuan me leje, të tjerët nuk janë lajmëruar dhe janë pa leje. Do të thotë, kjo duhet të dihet. E dyta, është gjynah pas ngritjes së pagave të deputetëve, deputetët ta marrin shtesën pa pasur prezencën në seanca dhe në komisione parlamentare. Po ju them sinqerisht, është gjynah dhe kjo çështje duhet të sanksionohet me Rregullore. Shtesa merret vetëm për ata që janë prezent, qoftë në komisione, qoftë në seancë. Nuk është prezent në punën e komisioneve, nuk është prezent në seancë, mendoj që është turp dhe vetë deputeti mos të deklarohet dhe mos ta marrë pjesën që s'i takon, sepse në rend të parë, tash ne nuk mund të votojmë për shkakun se nuk kemi numër të mjaftueshëm të deputetëve.

(Ndërhyrje)

Është lehtë të na tregojë regjia. Ju lutem, deputetët le t'i largojnë kartelat që janë vendosur. Elektronika më njofton – në sallë janë 73 deputetë, tash u hoqën 2, janë 70. Ju lutem, hiqni kartelat dhe elektronika e jep numrin e saktë.

(Ndërhyrje)

Jo, prezentë tash janë me kartela 55 deputetë. Kush janë pa kartela? 3 deputetë pa kartelë dhe bëjnë 58, 55 plus 3 bëjnë 58. Ju lutem, hiqni kartelat dhe ristartoni me to. E, tash i kemi 59 kartela, 3 janë pa kartela, pra janë 62 dhe mund të shkojmë në votim. Ju lutem, këtu janë 59 kartela dhe nëse edhe 2 deputetë.... janë 3, atëherë gjithsej janë 62 deputetë.

(Ndërhyrje)

Po, i kanë numëruar. Edhe një herë i numërojmë, sa të doni, por ta saktësojmë.

Të nderuar deputetë,

Nga numërimi fizik, prezentë janë 62 deputetë. Atëherë, së pari votojmë për miratimin, në parim, të Projektligjit për grevat.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

“Për” pa kartela janë 3. Faleminderit! “Kundër”? Nuk ka.

Konstatohet se me 39 vota “për”, 14 “kundër”, 6 abstenime, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për grevat.

Në bazë të Rregullores së Punës, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si komision funksional,
- Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
- Komisionin për Buxhet dhe Financa,
- Komisionin për Komunitete dhe
- Komisionin për Integrime Evropiane.

Komisionet duhet që brenda 2 muajve, nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

Votojmë për pikën e shtatë të rendit të ditës: – Shqyrtimi i parë i Projektligjit për energjinë elektrike.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

“Për” pa kartela? 3 vota. “Kundër”? Nuk ka. Faleminderit!

Konstatohet se me 47 vota “për”, 10 “kundër” dhe 4 abstenime, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për energjinë elektrike.

Në bazë të Rregullores së Punës, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, si komision funksional.
- Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
- Komisionin për Buxhet dhe Financa,
- Komisionin për Komunitete,
- Komisionin për Integrime Evropiane.

Komisionet duhet që në afatin brenda 2 muajsh Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

Dhe, nëse pajtoheni dhe besoj se pajtoheni, pikat tjera të rendit të ditës i vazhdojmë nesër, në orën 10. A jeni dakord? Faleminderit!

E premte, më 16 prill 2010, ora 10:00

Seancën drejton: kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Në sallë kemi 63 deputetë, andaj mund ta vazhdojmë seancën.

Konstatohet se tani në sallë janë 64 deputetë.

Po ju njoftoj se ora është 10:22 minuta.

Pika e tetë e rendit të ditës.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shërbimet postare

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për shërbimet postare dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion apo raportuesin e komisionit që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime. Nuk ka nevojë. Atëherë, vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara nga komisioni funksional, sipas radhës së paraqitjes në raport.

Amendamenti 1.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 55 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 58 vota “për”, 1 “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 2.

Amendamenti 3.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 54 vota “për”, 2 “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 3.

Amendamenti 4.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 56 vota “për”, 1 “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 57 vota “për”, 1 “kundër” dhe një abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 58 vota “për”, 1 “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 6.

Amendamenti 7.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 55 vota “për”, 1 “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 7.

Amendamenti 8.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 53 vota “për”, 1 “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 8.

Amendamenti 9.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 58 vota “për”, 1 “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 9.

Amendamenti 10.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 58 vota “për”, 1 “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 10.

Në sall kemi 65 deputetë.

Amendamenti 11.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 60 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 55 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 12.

Amendamenti 13.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 59 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 13.

Amendamenti 14.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 57 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 14.

Amendamenti 15.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 53 vota “për”, 1 “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 15.

Amendamenti 16.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 57 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 16.

Amendamenti 17.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 58 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 17.

Amendamenti 18.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 57 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 18.

Amendamenti 19.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 58 vota “për”, 1 “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 19.

Amendamenti 20.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 55 vota “për”, 2 “kundër” dhe 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 20.

Amendamenti 21.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 56 vota “për”, 1 “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 21.

Amendamenti 22.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 54 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 22.

Dhe i fundit është Amendamenti 23.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 57 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 23.

Tani është radha për ta votuar ligjin në tërësi.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votimin e ligjit në tërësi.

Votojmë tash:

Prezenca është me 68 deputetë në sallë.

Konstatoj se me 62 vota “për”, 1 “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për shërbimet postare.

Vazhdojmë pikën e radhës.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Mërgatën e Kosovës

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për Mërgatën e Kosovës dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Kryetari i komisionit, nuk ka çka të thotë.

Atëherë, vazhdojmë procedurën e votimit.

Amendamenti 1.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 60 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 1.

Amendamenti 2.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 54 vota “për”, 1 “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 2.

Amendamenti 3.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 53 vota “për”, 1 “kundër” dhe 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 3.

Amendamenti 4

Votojmë, tash.

Konstatohet se me 53 vota “për”, 1 “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 4.

Amendamenti 5

Votojmë tash:

Konstatohet se me 51 vota “për”, 1 “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 5.

Amendamenti 6

Votojmë tash:

Konstatohet se me 55 vota “për”, 1 “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 6.

Amendamenti 7

Votojmë tash:

Konstatohet se me 54 vota “për”, 0 “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 7.

Amendamenti 8

Votojmë, tash.

Me 53 vota “për”, 1 “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 8.

Amendamenti 9

Votojmë tash:

Konstatohet se me 54 vota “për”, 3 “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 9.

Amendamenti 10, i fundit.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 57 vota “për”, 1 “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 10.

Tani është radha për ta votuar Ligjin në tërësi. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Prezenca është e pandryshuar, 68 deputetë.

Konstatohet se me 59 “vota”, 1 “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi Projektligjin për Mërgatën e Kosovës. Për një votë plus, minus, nuk është ndryshim i madh.

Pika e dhjetë e rendit të ditës:

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar

Në sallë janë 69 deputetë.

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe postimin e Ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij, pa ndryshme.

Para se të procedojmë me votimin e Projektligjit, ftoj kryetarin e komisionit funksional, nëse e do fjalën. Gani Koci e ka kërkuar fjalën.

GANI KOCI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Propozimi për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi tatimin mbi vlerën e shtuar ka qenë i Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe si projektligj Kuvendit iu ka dorëzuar më 25 shkurt të vitit 2010. Dhe, meqë ka qenë propozim vetëm, si të them, për ta shtyrë afatin e zbatshmërisë së këtij ligji nga 1 janari në 1 korrik, Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk e ka parë të arsyeshme më të bëjë amendamente, prandaj duhet të miratohet si i tillë çfarë është paraqitur në fillim në seancat e kaluara të Kuvendit.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Atëherë, shkojmë në votim. Votojmë Ligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Konstatohet se me 54 vota “për”, 7 “kundër”, 5 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar.

Në sallë është shtuar numri i deputetëve, tani janë diku rreth 70.

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin me amendamentet e propozuara. Vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

(Reagim nga salla)

Kush e kërkon fjalën? Fjalën e ka Ibrahim Gashi.

IBRAHIM GASHI: Ju faleminderit, kryetar!

Desha vetëm një sqarim të shkurtër, se Komisioni e ka dhënë kontributin e vet bashkë me komisionet përcjellëse. Ligji ka 7 amendamente, 4 amendamente janë të propozuara prej deputetit Riza Smaka, prej të cilave komisioni e ka akceptuar njërin, do të thotë dhe 3 amendamente janë të komisionit. Vetëm këtë sqarim, tash është, do me thënë, në vullnetin e deputetëve që të votojnë apo të mos votojnë për të gjitha amendamentet. Të gjitha janë vendosur edhe janë sqaruar se cilat janë të komisionit, cilat janë të deputetit Smaka. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju amendamentet i keni përpara. Amendamenti i parë është i deputetit Riza Smaka, me përkrahjen e komisionit funksional.

Amendamenti 1

Votojmë tash:

Konstatohet se me 59 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 1

Amendamenti 2 është i komisionit funksional.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 56 vota “për”, 2 “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamenti 2.

Amendamenti 3, është i deputetit Riza Smaka, pa përkrahjen e komisionit funksional.

Votojmë tash:

(duartrokitje)

Me 28 vota “për”, 23 “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 3 i deputetit Riza Smaka.

Amendamenti 4.

Prapë është i deputetit Riza Smaka, pa përkrahjen e komisionit funksional.

Votojmë tash:

Me 29 vota “për”, 25 “kundër”, 6 “abstenime”, Kuvendi miratoi amendamentin 4, të deputetit Smaka.

Amendamenti 5, i komisionit funksional.

Votojmë tash:

Me 49 vota “për”, 8 “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 5.

Amendamenti 6, i deputetit Riza Smaka, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Votojmë tash:

Me 27 vota “për”, 29 “kundër”, 3 abstenime, amendamenti 6 nuk miratohet.

Amendamenti 7, i komisionit funksional.

Votojmë tash:

Me 59 vota “për”, 4 “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miraton amendamentin 7.

Tani të përgatitemi për ta votuar Ligjin në tërësi.

Votojmë tash:

Në sallë janë 73 deputetë.

Konstatohet se me 56 vota “për”, 4 “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare.

Vazhdojmë pikën e radhës, pika e dymbëdhjetë:

12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e drejtorit dhe të zëvendës-drejtorit të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Mbeturina

Komisioni funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e drejtorit dhe të zëvendës-drejtorit të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Mbeturina dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Propozim-vendimi i Qeverisë dhe raporti me rekomandimet e Komisionit funksional iu është shpërndarë deputetëve.

Përfaqësuesi i Qeverisë, nuk është këtu. Fjalën e ka, atëherë, kryetari i Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor, Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor e ka shqyrtuar propozimin pasi që propozimi i Qeverisë nuk kishte kaluar një herë në seancë plenare. Dhe, pasi që i njëjti propozim kishte ardhur prapë në komisionin tonë funksional, për hir të kolegjalitetit dhe të dinjitetit të punës së komisionit ne ia kemi lënë këtë çështje ta shqyrtojë prapë seanca, sepse nuk kemi edhe kompetenca ligjore që të hyjmë në vlerësime të CV-ive. Ne jemi komision funksional, jemi trup funksional i Kuvendit, seanca një herë e ka thënë fjalën e vet dhe ne kemi rekomanduar që prapë seanca plenare, si institucion valid që merr vendime, ta thotë prapë fjalën e vet. Andaj, rekomandimet tona janë që seanca plenare të vendosë lidhur me këto dy propozime të Qeverisë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! A ka nevojë për fjalë të shefave të grupeve parlamentare? Mirë, fjalën e ka kërkuar shefi i Grupit Parlamentar të AKR-ës, deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, kryetar!

Po e shoh se ka disponim për t'i kaluar gjërat ashtu pa debat dhe nuk është hera e parë që Kuvendi vepron kështu dhe nuk është hera e parë që Kuvendi po bie në pozitë jo të mirë.

Është një praktikë që Kuvendi kur kthen diçka prapa, më e njëjta çështje nuk sillet dhe ne tash i kemi po të njëjtat emra të cilët ky Kuvend para një viti përafërsisht i ka kthyer prapa.

Unë nuk do të hy në çështjet individuale të njerëzve nëse i plotësojnë kriteret ose jo të parapara me ligj, sepse këtë çështje do të duhej ta bëjë vetë Komisioni i cili, për fat të keq, nuk e ka kryer detyrën ashtu siç e ka, sepse është lehtë të thuhet që komisioni nuk ka kompetenca, por shihet që ky Kuvend jo rrallëherë po sjell vendime të cilat janë në kundërshtim me ligjet dhe në kundërshtim me Rregulloren.

Është një praktikë, edhe në vendet tjera, që do të duhej të jetë edhe te ne, që në diçka që e kthen Kuvendi prapa, më e njëjta nuk mund t'i sillet këtij Kuvendi. Edhe dje u tha këtu që shpeshherë po votohen.

Kolegë, ju jeni shumicë, shumica parlamentare dhe mund të vendosni emra dhe mund të zgjidhni njerëz edhe në kundërshtim me ligjin, por dikush duhet ta bartë përgjegjësinë. Nëse ju kështu mendoni që të rehatoni njerëz të partive politike duke i vendosur në agjenci të pavarura, atëherë kryetar, unë kam një propozim që në ligj të mos jetë Kuvendi ai i cili e bën përzgjedhjen në fund, se ashtu-kështu Qeveria po vendos, së paku le t'i vendos Qeveria e që ne mos të biem në pozita kështu të palakueshme.

Nëse vjet i ka kthyer ky Kuvend këta dy njerëz, se nuk i plotësojnë kushtet ligjore, atëherë si ka mundësi që pas një viti po të njëjtit njerëz t'i plotësojnë kushtet ligjore për diçka të tillë.

(Reagime)

Jo, thjeshtë. Nëse kështu doni ta bëni qesharak Kuvendin, ne bëhemi, nuk është problem, por nuk është dinjitoze për Kuvendin të bie në këtë gjendje. Faleminderit!

(Ndërhyrje – sugjerime – propozime)

KRYETARI: Po, unë vendosi për ta qitur në votim ose jo, dijeni këtë. Realisht, Qeveria ka mund edhe t'i kthejë, po nëse Kuvendi në një moment i ka kthyer, por propozimet kanë qenë mbi bazën e ligjit dhe jo kundër ligjit, të cilën gjë komisioni nuk e thotë dhe komisioni e thotë këtë: "Komisioni konstatoi se kompetencat janë të kufizuara për t'i vlerësuar kandidatët e propozuar".

Unë mendoj që komisioni ka kompetenca të plota për të konstatuar se kandidatët a janë mbi bazë të ligjit apo nuk janë mbi bazë ligjore dhe një konstatim të tillë nuk e kemi.

Atëherë, shkojmë në votim, pa diskutim. Do të thotë, kush është "për"... Ose votojmë tash për propozimin e Qeverisë dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 57 vota "për", 7 "kundër", 6 abstenime, Kuvendi miratoi propozimin e Qeverisë për emërimin e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Mbeturina.

Pika e trembëdhjetë e rendit të ditës:

13. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formimin e Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media

Subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend kanë propozuar anëtarët për Komisionin ad-hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për media.

Mbi këtë bazë, Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare, të mbajtur më 6 prill 2010, ka vendosur që Propozim-vendimi të procedohet për miratim në seancë plenare, i cili u është shpërndarë deputetëve.

Meqë propozimi i anëtarëve të këtij komisioni është bërë nga secila parti politike, e përfaqësuar në Kuvend, konsideroj se nuk ka nevojë për deklaram të serishëm, andaj propozoj ta votojmë dhe votojmë tash:

Me 63 vota "për", 2 "kundër", 3 abstenime, Kuvendi emëroi anëtarët e Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media.

Pika e katërbëdhjetë dhe e fundit e rendit të ditës:

14. Propozimet e Grupit Parlamentar të LDK-së dhe të Grupit Parlamentar të AAK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisione parlamentare

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka propozuar deputetin Arsim Rexhepi për kryetar të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, në vend të ish deputetit Agim Veliu.

Deputeti Adem Hajdaraj, propozohet për anëtar dhe deputeti Naser Osmani propozohet për anëtar në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në vend të deputetit Arsim Rexhepi.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës ka propozuar deputetin Shkumbin Demaliaj për anëtar të Komisionit për Buxhet dhe Financa, në vend të deputetit Haki Shatri.

Deputeti Ahmet Isufi propozohet për anëtar në Komisionin për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, në vend të ish deputetit Rasim Selmanaj, si dhe

Deputeti Ibrahim Selmanaj, për anëtar në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, në vend të deputetit Danush Ademi.

Të nderuar deputetë,

Kërkoj nga ju që me ngritjen e dorës, të deklaroheni për propozimet e grupeve parlamentare. Kush është për?

Konstatoj se Kuvendi miratoi Propozimin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Propozimin e Grupit Parlamentar për Ardhmërinë e Kosovës për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

Dhe, me këtë, konstatoj mbylljen e kësaj seance dhe mirë u pafshim në seancën e radhës!

Përgatiti:

Njësia e transkripteve